

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Botues:

MAKAVEJ Shkup, viti 2021

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Koço Bendo (faqe 12-68)

Blerina Starova Zlatku (faqe 69-92)

Koordinimi i redaksisë së botimit në gjuhën shqipe: Dr. Stefan Pürner, Drejtor i Fushës së Projektit për Europën Juglindore I (Bosnje dhe Hercegovinë, Mal i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbi), dhe Danica Djonova, v.d. Drejtore e Entit për përfaqësimin e RMV-së para GJEDNJ-së.

Bashkëpunimi i redaksisë së botimit në gjuhën shqipe:

Sonya Zayneb Ouertani – menaxher projekti në IRZ-ë dhe Rita Linderoth, Menaxhere e Lartë e Projektit pranë IRZ-së

Përkthimi i këtij Buletini në gjuhën shqipe, si dhe botimi i tij u mundësua nga ana e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar, shoqatë e regjistruar (IRZ).

Buletini i praktikës gjyqësore të
Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

botuar nga
Enti për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut
para GJEDNJ-së

dhe
Fondacioni gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar
Shoqatë e regjistruar (IRZ)

Botimi 1/ 2021, vëllimi i 10-të, viti i t-të, në gjuhën shqipe



Newsletter zur Rechtsprechung des
Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte

Gemeinsam herausgegeben von der Regierungsvertreterin von
Nordmazedonien vor dem EGMR

und der
Deutschen Stiftung für internationale rechtliche
Zusammenarbeit e.V. (IRZ)

Ausgabe 1/2021, 10. Band, 7. Jahrgang in albanischer Sprache

Sehr geehrte Kolleginnen und Kollegen, liebe Leserinnen und Leser,

Sie halten eine neue Ausgabe des bereits im siebten Jahr erscheinenden Newsletters zur Rechtsprechung des Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte (EGMR) in Straßburg in den Händen. Dieser Newsletter ist zur Information von Justizangehörigen, insbesondere Richterinnen und Richtern, Staatsanwältinnen und -anwälten sowie Behördenmitarbeiterinnen und –mitarbeitern in Nordmazedonien gedacht. Deshalb berichtet er vor allem über Urteile des Straßburger Gerichts, die für diese von besonderem Interesse sind, also über Entscheidungen, die gegen Nordmazedonien ergangen sind, oder aber, obwohl sie aus Verfahren gegen andere Staaten stammen, sich auf Rechtsfragen beziehen, die in Nordmazedonien große praktische Bedeutung haben.

Herausgegeben wird dieser Newsletter, der in mazedonischer und albanischer Sprache erscheint, gemeinsam von der Regierungsvertreterin von Nordmazedonien und Direktorin des Büros für die Vertretung Nordmazedoniens vor dem EGMR und der Deutschen Stiftung für internationale rechtliche Zusammenarbeit e.V. (IRZ).

Bei der IRZ handelt es sich um eine seit 1992 bestehende Organisation, die im Auftrag der deutschen Bundesregierung Transformationsstaaten bei den Reformen hin zum Rechtsstaat unterstützt. In der IRZ sind die wichtigsten deutschen Organisationen, die im Bereich des Rechtsstaates und der Justiz tätig sind, zusammengeschlossen. Dazu gehören (in alphabetischer Reihenfolge gemäß ihrer Bezeichnung in deutscher Sprache) der Bund Deutscher Rechtspfleger e.V., der Bund Deutscher Verwaltungsrichter und Verwaltungsrichterinnen, die Bundesnotarkammer, die Bundesrechtsanwaltskammer, der Deutsche Anwaltverein e.V., die Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V., der Deutsche Juristinnenbund e.V., der Deutsche Notarverein e.V., der Deutsche Richterbund e.V. und die Notarkammer Koblenz.

Eine weitere Gruppe von Mitgliedern bilden wirtschaftliche Vereinigungen, wie der Bundesverband der Deutschen Industrie e.V., der Bundesverband deutscher Banken e.V., der Deutsche Industrie- und Handelskammertag e.V., der Gesamtverband der Deutschen Versicherungswirtschaft e.V., der Markenverband e.V., und der Ost-Ausschuss – Osteuropaverein der deutschen Wirtschaft e.V.

Hinzu kommen bedeutende Industrieunternehmen wie die Bayer AG sowie eine Anzahl von Einzelpersonen aus Justiz, Politik und Wissenschaft.

In Nordmazedonien ist die IRZ seit dem Jahr 2000 mit Mitteln des deutschen Auswärtigen Amtes (AA) aus dem deutschen Beitrag zum Stabilitätspakt für Südosteuropa tätig. Darüber hinaus wird die Tätigkeit der IRZ allgemein, aber auch in Südosteuropa, durch

Shumë të nderuar kolege dhe kolegë, të dashura lexuese dhe lexues,

po merrni në dorë botimin e ri të buletinit në vitin e tij të shtatë të publikimit mbi praktikën gjyqësore të Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg. Ky buletin është menduar për informimin e operatoreve de operatorëve të drejtësisë, veçanërisht gjyqtareve dhe gjyqtarëve dhe prokuroreve dhe prokurorëve dhe punonjëseve dhe punonjësve/ve të organeve administrative në Maqedoninë e Veriut. Për këtë arsye ai përmban para së gjithash vendime të Gjykatës së Strasburgut që për ta paraqesin interes të veçantë, pra vendime të cilat janë dhënë kundër Maqedonisë së Veriut ose nga gjykime të tjera kundër shteteve të tjera, por që prekin çështje ligjore të cilat për Maqedoninë e Veriut janë me rëndësi të madhe praktike.

Ky buletin, i cili del në gjuhët maqedonase dhe shqipe, botohet në bashkëpunim me përfaqësuesen e qeverisë maqedonase dhe Drejtorinë e Agjencisë për përfaqësimin e Maqedonisë së Veriut para GJEDNJ-së dhe Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim ligjor ndërkombëtar (IRZ).

IRZ-ja është një organizatë që është themeluar në vitin 1992, e cila, në emër të Qeverisë Federale Gjermane, mbështet shtetet në transformim e sipër në reformat e tyre drejt shtetit të së drejtës. Në IRZ-ë përfaqësohen organizatat gjermane më të rëndësishme të cilat veprojnë në sferën e shtetit të së drejtës dhe drejtësisë. Këtu përfshihen (në renditje alfabetike sipas emërimit në gjuhën gjermane) Lidhja Gjermane e Punonjësve Gjyqësorë (der Bund Deutscher Rechtspfleger e.V.), Lidhja Gjermane e Gjyqtarëve dhe Gjyqtareve për Çështjet Administrative (der Bund Deutscher Verwaltungsrichter und Verwaltungsrichterin), Dhoma Federale e Noterisë (die Bundesnotarkammer), Dhoma Federale e Avokatisë (die Bundesrechtsanwaltskammer), Shoqata Gjermane e Avokatëve (der Deutsche Anwaltverein e.V.), Institucioni gjerman i Arbitrazhit (die Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V.), Lidhja gjermane e Juristëve (der Deutsche Juristinnenbund e.V.), Shoqata Gjermane e Noterëve (der Deutsche Notarverein e.V.), Lidhja Gjermane e Gjyqtarëve (der Deutsche Richterbund e.V.) dhe Dhoma e Noterisë Koblenz (die Notarkammer Koblenz).

Një grup tjetër i anëtarëve përbëhet nga organizimet ekonomike si Shoqata Federale e Industrisë Gjermane (der Bundesverband der Deutschen Industrie e.V.), Shoqata Federale e Bankave Gjermane (der Bundesverband deutscher Banken e.V.), Kongresi i Dhomës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë (der Deutsche Industrie- und Handelskammertag e.V.), Shoqata e Përgjithshme e Ekonomisë Gjermane të Sigurimeve (der Gesamtverband der Deutschen Versicherungswirtschaft e.V.), Shoqata e Markave, Berlin (der Markenverband e.V., Berlin) dhe Komisioni i Lindjes – Shoqata e Europës

eine institutionelle Zuwendung des deutschen Bundesministeriums der Justiz (BMJ) ermöglicht.

Im Rahmen dieser Tätigkeit spielen die Menschenrechte und die Europäisierung des Rechtes eine besondere Rolle. Außer Gesetzgebungsberatung und Unterstützung bei der Aus- und Weiterbildung von Juristinnen und Juristen arbeitet die IRZ auch auf dem besonders nachhaltigen Feld juristischer Publikationen.

Der vorliegende Newsletter wird auch in elektronischer Form vertrieben. So findet sich die mazedonische Fassung auf der Internetseite der IRZ unter <https://www.irz.de/index.php/downloads#publikationen-in-mazedonischer-sprache-публикации-на-македонски-јазик> und die albanische unter <https://www.irz.de/index.php/downloads#publikime-n%C3%AB-gjuh%C3%ABn-shqipe-publikationen-in-albanischer-sprache>. Darüber hinaus werden alle Ausgaben des Newsletters auch auf der Internetseite des Büros für die Vertretung Nordmazedoniens vor dem EGMR unter <http://biroescp.gov.mk> in der Rubrik „Sudska praksa“ (Praktika gjyqësore, Rechtsprechung) zum Herunterladen angeboten. Dort finden sich auch alle anderen Urteile des EGMR gegen Nordmazedonien in mazedonischer Übersetzung.

Durch die elektronische Publikation wird der Newsletter allen Interessierten zugänglich. Die Angehörigen der mazedonischen Justiz erhalten ihn darüber hinaus in Druckform. Die wichtigsten Rechtsprechungen des EGMR sind deshalb mithilfe dieses Newsletters allen Richterinnen und Richtern sowie Staatsanwältinnen und – anwälten in Nordmazedonien zeitnah direkt auf ihren eigenen Schreibtischen zugänglich.

Die Herausgeber des Newsletters haben bewusst verschiedene Verbreitungswege gewählt, um einen möglichst großen Adressatenkreis erreichen zu können. Dies deshalb, da die Rechtsprechung des Straßburger EGMR für die Anwendung des jeweiligen nationalen Rechts von erheblicher Bedeutung ist. Außerdem garantiert sie, dass die gemeinsamen Menschenrechtsstandards der im Europarat zusammengeschlossenen Staaten auch in der Praxis tatsächlich eingehalten werden.

Ein so anspruchsvolles und nachhaltiges Unternehmen wie die bereits jahrelange regelmäßige Herausgabe eines aktuellen Newsletters in zwei Sprachen ist nur durch das Engagement aller Beteiligten, Teamwork und dauerhafte Unterstützung möglich.

Allen voran gilt es dem deutschen Auswärtigen Amt für die finanzielle Unterstützung, ohne die die Publikation, die sie derzeit in Händen halten, nicht entstehen hätte können, zu danken. Ergänzt wird diese Unterstützung aus Berlin durch das Engagement der deutschen Botschaft vor Ort in Skopje, die die Tätigkeit der IRZ aktiv und engagiert begleitet.

Lindore e Ekonomisë Gjermane (der Ost-Ausschuss – Osteuropaverein der deutschen Wirtschaft e.V.).

Këtu përfshihen edhe ndërmarrjet e rëndësishme industriale Bayer AG si dhe një numër personalitetesh nga drejtësia, politika dhe shkenca.

Në Maqedoninë e Veriut IRZ-ja e ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2000 me fondet e Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme nga kontributi gjerman për Paktin e Stabilitetit për Europën Juglindore. Përveç kësaj, aktiviteti i IRZ-së në përgjithësi, por edhe për Europën Juglindore, mundësohet nëpërmjet një kontributi institucional të Ministria Federale e Drejtësisë (MFD).

Në kuadrin e këtij aktiviteti të drejtat e njeriut dhe europianizimi i së drejtës luajnë një rol të veçantë. Përveç këshillimeve në hartimin e legjislationit dhe mbështetjes në trajnimin fillestar dhe të vazhduar të juristëve, IRZ-ja punon veçanërisht në sferën qëndrueshme të publikimeve juridike.

Ky buletin do të botohet edhe në format elektronik. Kështu versioni në maqedonisht gjendet në faqen e internetit të IRZ-së në adresën

<https://www.irz.de/index.php/downloads#publikationen-in-mazedonischer-sprache-публикации-на-македонски-јазик> dhe versioni në shqip në adresën

<https://www.irz.de/index.php/downloads#publikime-n%C3%AB-gjuh%C3%ABn-shqipe-publikationen-in-albanischer-sprache>. Përveç kësaj, të gjitha botimet e buletinit ofrohen për tu shkarkuar edhe në faqen e internetit të Agjencisë për përfaqësimin e Maqedonisë

para GJEDNJ-së tek adresa <http://biroescp.gov.mk> në rubrikën „Sudska praksa” (Praktika gjyqësore). Atje gjenden edhe të gjitha vendimet e tjera të GJEDNJ-së kundër Maqedonisë së Veriut të përkthyer në maqedonisht.

Nëpërmjet botimit elektronik buletini është i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit. Operatorëve të drejtësisë maqedonase ai u jepet edhe në format fizik. Nëpërmjet këtij buletini i vihet në dispozicion çdo gjyqtari dhe prokurori maqedonas praktika më e rëndësishme e GJEDNJ-së në kohë të afërt dhe drejtpërdrejt në tavolinën e tij të punës.

Botuesit e buletinit kanë zgjedhur në mënyrë të ndërgjegjshme disa variante publikimi, për të arritur një rreth sa më të gjerë të interesuarish. Kjo për shkak se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së së Strasburgut është e një rëndësie të veçantë për zbatimin e së drejtës përkatëse të brendshme. Përveç kësaj, ajo garanton që standardet e përbashkëta të të drejtave themelore të shteteve palë në Këshillin e Europës të respektohen faktikisht edhe në praktikë.

Një ndërmarrje e tillë ambicioze dhe e qëndrueshme siç është botimi i rregullt për vite me radhë e një buletini të përditësuar në dy gjuhë është e mundur vetëm

Deshalb gilt Frau Botschafterin Anke Holstein und ihren Mitarbeiterinnen und Mitarbeitern an dieser Stelle ein herzliches Wort des Dankes. Zu danken haben die Herausgeber auch dem deutschen Bundesministerium der Justiz (BMJ), dass die Arbeit der IRZ mit einer institutionellen Zuwendung überhaupt erst ermöglicht.

Besonderen Dank schulden die Herausgeber den Übersetzerinnen und Übersetzern, die sich regelmäßig der nicht leichten Aufgabe stellen, die hier zusammengefassten anspruchsvollen juristischen Texte in die genannten Sprachen zu übertragen.

Desweiteren ist auch den Mitarbeiterinnen und Mitarbeitern, die in den beteiligten Organisationen an der Erstellung dieses Newsletters mitgewirkt haben, zu danken. Das sind bei der IRZ Frau Sonya Zayneb Ouertani und Frau Rita Linderoth, die diese Publikation in Bonn als Projektmanagerin und Senior Projektmanagerin betreut haben und Frau Nata-scha Andreevska-Tomovska, die in Skopje vor Ort für die IRZ die Koordination mit dem Projektpartner, den Übersetzern und dem Verlag übernommen hat.

Zuallerletzt ist noch den Leserinnen und Lesern zu danken, die durch ihr bereits seit Jahren anhaltendes Interesse dazu beigetragen haben, dass dieser Newsletter ein Erfolg wurde. Diese Anerkennung ist uns Ansporn, die Herausgabe dieser Publikation auch in Zukunft in der bisherigen Qualität fortzusetzen.

Bonn/Skopje, im Dezember 2021

Danica Djonova LL.M
*Kommissarische Direktorin des Büros
für die Vertretung Nordmazedoniens
vor dem EGMR*

Rechtsanwalt Dr. Stefan Pürner
*Leiter des Projektbereichs Südosteuropa I
(Bosnien und Herzegowina, Montenegro,
Nordmazedonien und Serbien)*

nëpërmjet angazhimit të të gjithë pjesëmarrësve, punës në ekip dhe mbështetjes së vazhdueshme.

Para së gjithash i duhen shprehur falënderimet Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme për mbështetjen financiare, pa të cilin botimi, të cilin tashme keni në dorë, nuk do të ishte i mundur. Kjo mbështetje nga Berlino plotësohet me angazhimin e ambasadës gjermane në Shkup, e cila ndjek në mënyrë të angazhuar dhe aktivisht aktivitetin e IRZ-së. Për këtë shkak Zonjës Ambasadore Anke Holstein dhe kolegeve dhe kolegëve të sai me këtë rast i shprehim falënderime të përzemërta. Botuesit duhet të falënderojnë gjithashtu edhe Ministria Federale e Drejtësisë (MFD), e cila ka mundësuar punën e IRZ-së nëpërmjet një kontributi institucional.

Një falënderim të veçantë botuesit duhet tu shprehin përkthyesve dhe përkthyesve, të cilët marrin përsipër një punë jo të lehtë për përkthimin në gjuhët përkatëse të këtyre teksteve të vështira juridike të përmbledhura.

Më tej një falënderim u shkon edhe kolegeve dhe kolegëve, të cilët kanë kontribuar në kuadrin e organizatave pjesëmarrësve për përpilimin e këtij buletini. Këto janë në IRZ-ë Zj Sonya Zayneb Ouertani dhe Z Rita Linderoth, të cilat janë kujdesur për këtë botim në Bon si Menaxhere Projekti dhe sie Menaxhere e Lartë Projekti, Zj Natascha Andreevskaja-Tomovska, e cila ka marrë përsipër në Shkup për IRZ- në bashkërendimin me partnerin e projektit, përkthyesit dhe shtëpinë botuese.

Pikë së fundi, një falënderim shkon për lexueset dhe lexuesit të cilët, për vite me radhë nëpërmjet interesit të tyre kanë kontribuar që ky buletin të kthehet në sukses. Kjo mirënjohje është për ne nxitje për nxjerrjen e këtij botimi edhe në të ardhmen me cilësinë e deritanishme.

Bon/Shkup, dhjetor 2021

Danica Djonova LL.M.

*Drejtoresh e Komanduar e Agjencisë
për përfaqësimin e Maqedoninëve e Veriut
para GJEDNJ-së*

Avokat Dr. Stefan Pürner

*Drejtor i Fushës së Projektit
për Europën Juglindore I
(Bosnje dhe Hercegovinë, Mal i Zi,
Maqedonia e Veriut dhe Serbi)*

Përmbajtja

Parathënia e botuesve4-5

I. AKTGJYKIMET E FUNDIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

M.K. dhe të Tjerë kundër Polonisë – 40503/17, 42902/17 dhe 43643/17,
Vendimi i datës 23.7.2020 [Seksioni I] 12

Muhammad dhe Muhammad kundër Romanisë (garanci procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve) [DHM] – 80982/12,
Vendimi i datës 15.10.2020 [DHM] 16

Akbay dhe të Tjerë kundër Gjermanisë – 37273/15, 40495/15 dhe 40913/15,
Vendimi i datës 15.10.2020 [Seksioni V] 23

Ćwik kundër Polonisë – 31454/10, Vendimi i datës 5.11.2020 (Seksioni I) 28

Sabalić kundër Kroacisë – 50231/13, Vendimi i datës 14.1.2021 (Seksioni I) 30

X dhe të Tjerë kundër Bullgarisë [DHM] – 22457/16,
Vendim i datës 2.2.2021 [DHM] 33

Jurčić kundër Kroacisë – 54711/15, Vendimi i datës 4.2.2021 (Seksioni I) 39

Vavříčka dhe të Tjerë kundër Republikës Çeke [DHM] – 47621/15,
3867/15, 73094/15 et al., Vendimi i datës 8.4.2021 [DHM] 43

Terheş kundër Romanisë (dec.) – 49933/20,
Vendimi i datës 13.4.2021 (Seksioni IV) 48

Qendra för rättvisa kundër Suedisë [DHM] – 35252/08,
Vendimi i datës 25.5.2021 [DHM] 50

Kurt kundër Austrisë [DHM] – 62903/15, Vendimi i datës 15.6.2021 [DHM] 60

II. AKTGJYKIME TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Boshkoski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut – 71034/13,
Aktgjykimi nga data 4 qershor, 2020 69

<i>J.M. dhe A.T. kundër Maqedonisë së Veriut</i> – 9783/13, Aktgjykim nga data 22 tetor 2020	71
<i>X dhe Y kundër Maqedonisë së Veriut</i> – 173/17, Aktgjykim nga data 5 nëntor 2020	74
<i>Janevski kundër Maqedonisë së Veriut</i> – 30259/15, Aktgjykim nga data 19 nëntor 2020	78
<i>Trandafilovski kundër Maqedonisë së Veriut</i> – 59119/15, Aktgjykim nga data 17 dhjetor 2020	81
<i>Stojmenoviq dhe Millosheviq kundër Maqedonisë së Veriut</i> – 59842/14, Aktgjykim nga data 25 mars viti 2021	83
<i>Transkop SHA Manastir kundër Maqedonisë së Veriut</i> – 48057/12, Aktgjykim nga data 1 prill 2021	85
<i>Prodanov kundër Maqedonisë së Veriut</i> – 73087/12, Aktgjykim nga data 10 qershor 2021	87
<i>Stoimenovikj dhe Miloshevikj kundër Maqedonisë së Veriut</i> – 59842/14, Vendimi i datës 25.3.2021 (Seksioni V)	90

I. AKTGJYKIMET E FUNDIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 3

Neni 3, Dëbimi

Refuzimi i pranimit të kërkesave për azil nga rojet kufitare dhe kalimi pa vendim gjyqësor në një vend të tretë, me rrezikun e rikthimit dhe të keqtrajtimit në vendin e origjinës: *shkelje*

Neni 4 i Protokollit Nr. 4

Ndalimi i dëbimit kolektiv të të huajve

Refuzimi i pranimit të kërkesave për azil nga rojet kufitare dhe kalimi pa vendim gjyqësor në një vend të tretë, me rrezikun e rikthimit dhe të keqtrajtimit në vendin e origjinës: *shkelje*

M.K. dhe të Tjerë kundër Polonisë – 40503/17, 42902/17 dhe 43643/17, Vendimi i datës 23.7.2020 [Seksioni I]

Faktet – Kërkuesit janë shtetas rusë me origjinë çeçene. Në vitin 2017 ata u paraqitën disa herë në pikat e kontrollit kufitar (Terespol dhe Czeremca-Polowce) në kufirin polak – bjellorus. Ata pretendojnë që të gjitha herët ata dëshironin të paraqisnin kërkesa për azil, por kjo mundësi u refuzua nga rojet kufitare, të cilët u refuzuan hyrjen dhe i transferuan ata në Bjellorusi, megjithëse kërkuesit kishin pretenduar që ata në Bjellorusi nuk do të kishin mundësinë e një procedure të përshtatshme azili dhe do të haseshin me torturë ose forma të tjera të trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues, nëse ktheheshin në Federatën Ruse (Çeçeni). Sipas protokollit të mbajtur nga rojet kufitare, kërkuesit nuk kishin shprehur dëshirë të paraqisnin kërkesa për azil, ndërsa raporte të shumta të institucioneve të brendshme për të drejtat e njeriut, OJQ-ëve dhe medias tregonin që rojet kufitare rregullisht refuzonin të pranonin kërkesa për azil. Në lidhje me kërkesat, Gjykata vuri në dukje masat e përkohshme sipas Rregullit 39 të Rregullave të Gjykatës. Megjithatë, kërkuesit u kthyen në Bjellorusi. Pas kësaj kërkuesit mbërritën

në pikat e kontrollit kufitar edhe në raste të mëvonshme, por përsëri u refuzuan. Në lidhje me disa kërkesë, kërkesat e tyre për azil eventualisht u pranuan nga autoritetet polake dhe u vendosën në një qendër pritjeje.

Ligji – Neni 3 i Konventës: Në përcaktimin nëse kërkesit kishin shprehur apo jo dëshirën për të kërkuar azil kur u paraqitën në pikat e kontrollit kufitar, Gjykata i jep më shumë rëndësi versionit të kërkesve të ngjarjeve në kufi që ishin vërtetuar nga dëshmitarë të tjerë. Raportet nga institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut kishin treguar ekzistencën e një praktike sistemike të paraqitjes së gabuar të deklaramëve të bëra nga azilkërkesit në protokollet zyrtare të hartuara nga rojet kufitare në pikat e kontrollit midis Polonisë dhe Bjellorusisë. Për më tepër, parregullsitë në procedurën në lidhje me pyetjen e të huajve që mbërrinin në kufirin Poloni-Bjellorusi në kohën përkatëse, përfshirë mungesën e një hetimi të duhur mbi arsyet për të cilat ata kërkuar hyrjen në Poloni, ishin konfirmuar nga vendimet e Gjykatës së Lartë Administrative. Ato gjithashtu ishin vërtetuar nga një numër dokumentesh të paraqitura prej tyre në Gjykatë, veçanërisht nga kopjet e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare të kryera nga kërkesit në kufi, përpjekjet e tyre të shumta për të kaluar kufirin dhe përfaqësimi i tyre nga avokatët polakë dhe bjellorusë. Në çdo rast, autoritetet kishin qenë të vetëdijshme për frikën e kërkesve për keqtrajtim pas kthimit, pasi kërkesat për azil u ishin bërë të ditura atyre me mjete elektronike nga përfaqësuesit e tyre, si dhe nga Gjykata kur ajo iu referua masave të përkohshme sipas Rregullit 39. Prandaj, Gjykata nuk mund të pranonte argumentin e Qeverisë se kërkesit nuk kishin paraqitur asnjë provë që ata kishin qenë nën rrezikun e nënshtrimit ndaj keqtrajtit.

Kërkesit normalisht mund të pretendonin se nuk kishte asnjë garanci që kërkesat e tyre për azil do të shqyrtoheshin seriozisht nga autoritetet bjelloruse dhe se kthimi i tyre në Çeçeni mund të shkelte Nenin 3. Vlerësimi i këtyre pretendimeve duhej të ishte kryer nga autoritetet polake. Për më tepër, ata ishin nën detyrimin e garantimit të sigurisë së kërkesve, veçanërisht duke i lejuar ata të qëndronin brenda juridiksionit polak deri në kohën kur pretendimet e tyre të ishin shqyrtuar siç duhet nga një autoritet vendor kompetent. Objekti i këtij detyrimi nuk kishte qenë i varur nga fakti nëse kërkesit kishin me vete dokumente që i autorizonin ata të kalonin kufirin polak ose nëse ishin pranuar ligjërisht në territorin polak për arsye të tjera.

Qeveria e paditur kishte argumentuar se duke refuzuar hyrjen e kërkuesve në Poloni, ajo kishte vepruar në pajtim me detyrimet ligjore të Bashkimit Europian. Sidoqoftë, e drejta e BE-së kishte përqafuar qartë parimin e *mos-rikthimit*, të garantuar nga Konventa e Gjenevës, dhe gjithashtu e kishte zbatuar atë për personat që u ishin nënshtruar kontrolleve kufitare para se të pranoheshin në territorin e njërit prej Shteteve Anëtare. Rrjedhimisht, masa e kundërshtuar e marrë nga autoritetet polake del jashtë objektit të detyrimeve të rrepta ligjore ndërkombëtare të Polonisë.

Në tërësi, kërkuesit nuk kishin përfituar nga garancitë efektive që do t'i mbronin ata nga ekspozimi ndaj një rreziku real të nënshtrimit ndaj trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës, si dhe torturës. Mungesa e procedurave në të cilat mund të rishikoheshin kërkesat e kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare përbënte shkelje të Nenit 3. Për më tepër, duke pasur parasysh situatën në shtetin fqinj, autoritetet polake, duke mos i lejuar kërkuesit të qëndronin në territorin polak në pritje të shqyrtimit të kërkesave të tyre, i kishin ekspozuar me vetëdije ata ndaj një rreziku serioz të *rikthimit pasues* dhe trajtimit të ndaluar nga Neni 3.

Përfundimi: shkelje (unanimisht).

Neni 4 i Protokollit Nr. 4: Nëse ndalimi i dëbimit kolektiv të të huajve i shprehur në Nenin 4 të Protokollit Nr. 4 do të konsiderohej i zbatueshëm në lidhje me veprimet e një Shteti, efekti i të cilit do të kishte qenë pengimi i emigrantëve në arritjen e kufijve të atij Shteti, atëherë do të ishte edhe më e dukshme se ishte aplikuar në një situatë në të cilën të huajt ishin paraqitur në një kufi tokësor dhe ishin kthyer nga atje në vendin fqinj.

Gjatë procedurës në kufi, deklaratimet e kërkuesve në lidhje me vullnetin e tyre për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare ishin shpërfillur dhe se, edhe pse vendimet individuale ishin dhënë në lidhje me secilin kërkues, ata nuk pasqyronin siç duhet arsyet e dhëna nga kërkuesit për të justifikuar frikën e tyre nga persekutimi. Dhe disa prej kërkuesve nuk ishin lejuar të konsultoheshin me avokatët dhe u ishte mohuar aksesit tek ata edhe kur avokatët e tyre kishin qenë në pikën e kontrollit kufitar dhe kishin kërkuar që të lejoheshin të takoheshin me klientët e tyre.

Kërkuesit ishin përpjekur të përdorin procedurën e pranimit të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare që duhej tu ofrohej atyre sipas ligjit të brendshëm. Ata ishin përpjekur të kalonin një kufi në mënyrë ligjore, duke përdorur një

pikë kontrolli zyrtare dhe duke iu nënshtruar kontrolleve kufitare siç kërkohet nga ligji përkatës. Prandaj, fakti që shteti kishte refuzuar të konsideronte argumentet e tyre në lidhje me justifikimin e kërkesave të tyre për mbrojtje ndërkombëtare nuk mund t'i atribuohet sjelljes së tyre.

Për më tepër, raportet e pavarura në lidhje me situatën në pikat e kontrollit kishin treguar se rastet e kërkesve përbënin një shembull të një politike më të gjerë shtetërore të refuzimit të hyrjes për të huajt që vinin nga Bjellorusia, pavarësisht nëse ata kishin qenë qartazi emigrantë ekonomikë ose kishin shprehur frikën e persekutimit në vendet e tyre të origjinës. Ato raporte kishin vënë në dukje një praktikë të qëndrueshme të: mbajtjes së intervistave shumë të shkurtra, gjatë të cilave deklarimet e të huajve në lidhje me justifikimin e kërimit të mbrojtjes ndërkombëtare ishin shpërfillur; theksin e kishin vënë në argumentet që i kishin lejuar ata të kategorizoheshin si emigrantë ekonomikë; dhe paraqitjen e gabuar të deklarimeve të bëra nga të huajt në protokolle zyrtare shumë të shkurtra, të cilat kishin përbërë bazën e vetme për dhënien e vendimeve të refuzimit të hyrjes dhe kthimin e tyre në Bjellorusi, edhe në rast se të huajt në fjalë e kishin bërë të qartë se synonin të aplikonin për mbrojtje ndërkombëtare në Poloni. Këto përfundime ishin mbështetur edhe nga deklarata të autoriteteve të caktuara të referuara nga kërkuesit.

Vendimet që refuzonin hyrjen në Poloni të dhëna në rastet e kërkesve kishin përbërë një dëbim kolektiv të të huajve.

Përfundimi: shkelje (unanimisht).

Gjykata gjithashtu vendosi, njëzëri, se kishte patur një shkelje të Nenit 13 të marrë në lidhje me Nenin 3 të Konventës dhe Nenit 4 të Protokollit Nr. 4, për shkak të mungesës së një mjete juridik me efekt automatik pezullues, dhe se Shteti i paditur nuk i kishte përmbushur detyrimet e tij sipas Nenit 34 të Konventës, ndërsa ai ishte në përputhje me masat e përkohshme të treguara nga Gjykata sipas Rregullit 39 të Rregullave të Gjykatës vetëm me vonesë të konsiderueshme, ose aspak.

Neni 41: 34 000 EUR kërkuesit individualisht dhe të dy familjeve kërkuese në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu *Hirsi Jamaa dhe të Tjerë kundër Italisë* [DHM], 27765/09, 23 shkurt 2012, [Shënim Informativ 149](#); *Ilias and Ahmed kundër Hungarisë*

[DHM], 47287/15, 21 nëntor 2019, [Shënim Informativ 234](#); *N.D. dhe N.T. kundër Spanjës* [DHM], 8675/15 dhe 8697/15, 13 shkurt 2020, [Shënim Informativ 237](#); dhe Përmbledhje Informative mbi [Dëbimin kolektiv të të huajve](#))

Neni 1 i Protokollit Nr. 7

Garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve

Dëbimi për shkaqe të sigurisë kombëtare i vendosur mbi bazën e informacionit të klasifikuar që nuk u tregohet kërkuësve, pa garanci të mjaftueshme balancuese: *shkelje*

Muhammad dhe Muhammad kundër Romanisë (garanci procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve) [DHM] – 80982/12, Vendimi i datës 15.10.2020 [DHM]

Fakte – Kërkuësit, shtetas pakistanezë me qëndrim në Rumani me viza studentore, u dëbuan për arsye sigurie kombëtare. Vendimi përkatës u bazua në dokumente të klasifikuara. Kërkuësit nuk kishin qasje në to dhe atyre as nuk iu dha ndonjë informacion specifik në lidhje me faktet dhe shkaqet në bazë të këtij vendimi.

Ligji – Neni 1 i Protokollit Nr. 7

Parime të përgjithshme

(a) Nëse dhe në çfarë mase të drejtat e pretenduara nga kërkuësit ishin të mbrojtura nga Neni 1 i Protokollit Nr. 7

Neni 1 § 1 i Protokollit Nr 7 kërkon në parim, së pari, që të huajt në fjalë të informohen për elementet faktike përkatëse, të cilat i kanë shtyrë autoritetet kompetente të brendshme të konsiderojnë se ata përfaqësojnë një kërcënim për sigurinë kombëtare dhe, së dyti, që atyre tu ofrohet qasje në përmbajtjen e dokumenteve dhe informacionit në dosjen e çështjes në të cilën këta autoritete u mbështetën kur vendosën për dëbimin e tyre. Qasja në fjalë duhet të sigurohet mundësisht me shkrim dhe në çdo rast në një mënyrë që lejon një mbrojtje efektive, pa paragjykuar mundësinë e vendosjes së kufizimeve të justifikuara rregullisht për një informacion të tillë, nëse është e nevojshme.

(b) Kufizimet e lejuara mbi ato të drejta (më poshtë – të drejtat procedurale të të huajve)

Pavarësisht rëndësisë së konsideratave kundër terrorizmit, çdo kufizim i të drejtave në fjalë nuk duhet të mohojë mbrojtjen procedurale të garantuar nga Neni 1 i Protokollit Nr. 7 duke dëmtuar thelbin e masave mbrojtëse të përfshira në këtë dispozitë. Edhe në rastin e kufizimeve, të huajt duhet t'i ofrohet një mundësi efektive për të paraqitur arsye kundër dëbimit të tij dhe të mbrohet nga çdo arbitraritet.

(c) Kriteret që duhen marrë parasysh në përcaktimin e përputhshmërisë së kufizimit të këtyre të drejtave me Nenin 1 të Protokollit Nr. 7

Praktika gjyqësore në zbatim të Neneve 5 dhe 6 siguroi tregues të dobishëm të metodologjisë që duhet ndjekur në vlerësimin e kufizimeve të të drejtave të garantuara nga Neni 1 i Protokollit nr. 7, edhe pse shtrirja e masave mbrojtëse procedurale sipas kësaj dispozite të fundit nuk duhet të jetë domosdoshmërisht e njëjta.

Së pari, duhet të konstatohet nëse kufizimet e të drejtave procedurale të të huajve janë janë konstatuar të justifikuara rregullisht nga autoriteti kompetent i pavarur në dritën e rrethanave të veçanta të çështjes. Në këtë rast, Gjykata do të shqyrtojë nëse vështirësitë që rrjedhin nga këto kufizime për të huajt në fjalë janë kompensuar mjaftueshëm nga faktorët balancues, veçanërisht nga garancitë procedurale, të tilla që të garantojnë thelbin e të drejtave përkatëse. Pra, vetëm ato kufizime të cilat, në rrethanat e secilit rast, janë të justifikuara siç duhet dhe të balancuara mjaftueshëm janë të lejueshme në kontekstin e Neni 1 të Protokollit Nr. 7. Në shqyrtimin e saj, Gjykata ka parasysh rrethanat e një rasti të caktuar, duke marrë parasysh procedimin në tërësi.

(i) Nëse kufizimi i “të drejtave procedurale” të të huajt ishte rregullisht i justifikuar

Ndërsa mund të ketë shkaqe të justifikuara siç duhet, të tilla si nevoja për të mbrojtur sigurinë kombëtare, që të vendosen kufizime, vlerësimi i brendshëm i domosdoshmërisë së një kufizimi të tillë duhet të shoqërohet nga masa mbrojtëse ndaj arbitraritetit. Kërkesat për këtë qëllim përfshijnë nevojën që vendimi që imponon kufizime të tilla të arsyetohet siç duhet

dhe, veçanërisht në rast se ato arsye nuk i bëhen të ditura personit në fjalë, një procedurë që lejon që këto arsye të shqyrtohen rregullisht.

Kriteri i parë në këtë drejtim është pyetja nëse një autoritet i pavarur kombëtar (gjyqësor apo jo) ka shqyrtuar nevojën për kufizime të të drejtave procedurale të të huajve. Rëndësi i kushtohet kuadrin të kompetencave të atij autoriteti, dhe veçanërisht nëse ka të drejtë të rishikojë nevojën për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të klasifikuar.

Gjykata pastaj duhet të shqyrtojë kompetencat që i janë veshur atij autoriteti, në varësi të gjetjeve të tij në një rast të caktuar lidhur me nevojën e kufizimit të të drejtave procedurale të një të huaji. Kur autoriteti konstaton se siguria kombëtare nuk justifikon kufizimin e kundërshtuar, duhet të përcaktohet nëse ai ka të drejtë të kërkojë organin kompetent për çështjet e sigurisë kombëtare rishikimin e klasifikimit të dokumenteve, ose nëse ai ishte në gjendje t'i deklasifikonte ato, në mënyrë që ato të transmetohen të huajit, ose të paktën në mënyrë që ky i fundit të vihet në dijeni për përmbajtjen e tyre. Në të kundërt, nëse kufizimi i kundërshtuar konstatohet i justifikuar nga mbrojtja e sigurisë kombëtare, duhet të përcaktohet nëse, për të arritur në këtë përfundim, autoriteti identifikoi siç duhet interesat përkatës dhe i peshoi ato kundrejt njëri -tjetrit.

Sidoqoftë, nëse autoritetet kombëtare nuk arrijnë të shqyrtojnë – ose e shqyrtojnë dhe arsyetojnë në masë të pamjaftueshme – nevojën për kufizime të të drejtave procedurale të të huajve, kjo nuk është në vetvete e mjaftueshme për të gjetur një shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 7. Gjithashtu duhet të konstatohet nëse janë zbatuar masa balancuese në rastin në fjalë dhe, nëse po, nëse ato janë të mjaftueshme për zbutjen e kufizimeve të të drejtave procedurale të të huajve, në mënyrë që të ruajnë thelbin e këtyre të drejtave. Sa më pak i rreptë shqyrtimi në nivelin e brendshëm, aq më i rreptë do të jetë shqyrtimi i faktorëve të balancues nga Gjykata. Më saktësisht, një ekzaminim tepër i përciptë do të kërkojë zbatimin e faktorëve të shtuar të balancues.

Gjykata gjithashtu ka lëvruar dy parime udhëzuese për vlerësimin e saj: së pari, sa më shumë i kufizuar të jetë informacioni i disponueshëm për të huajt, aq më të rëndësishme do të jenë masat mbrojtëse; së dyti, kur rrethanat e një rasti zbulojnë pasoja veçanërisht të konsiderueshme për

situatën e të huajve, garancitë balancuese duhet të forcohen në përputhje me rrethanat.

(ii) Nëse kufizimet e “të drejtave procedurale” ishin kompensuar mjaftueshëm nga faktorët balancues

Duke mos pasur një konsensus europian për llojet ose shtrirjen e faktorëve të tillë, Shteteve duhet t’u jepet një marzh i caktuar vlerësimi në këtë drejtim. Duhet të merret parasysh një listë jo-shteruese e faktorëve:

(1) Rëndësia e informacionit që i bëhet i ditur të huajit në lidhje me shkaqet e dëbimit të tij dhe qasja e siguruar në përmbajtjen e dokumenteve mbështetëse

Duhet të përcaktohet nëse autoritetet e brendshme, në masën e përshtatshme për ruajtjen e konfidencialitetit dhe kryerjes së duhur të hetimeve, e kanë informuar të huajin në fjalë, gjatë procedimit, mbi thelbin e akuzave kundër tij ose saj. Një çështje tjetër e rëndësishme është nëse i takon një autoriteti gjyqësor ose një autoriteti tjetër të pavarur të përcaktojë, në një rast të caktuar, pas shqyrtimit të të gjitha provave të klasifikuara, se cilat informacione faktike mund t’i bëhen të ditura të huajit në fjalë pa rrezikuar sigurinë kombëtare, me kusht që të zbulohet në një fazë të procedimit kur i huaji të jetë akoma në gjendje që ta kundërshtojë atë informacion në mënyrë të efektshme.

(2) Bërja e ditur të huajit të informacionit në lidhje me zhvillimin e procedimit dhe mekanizmat e brendshëm të vendosur për të balancuar kufizimin e të drejtave të tij ose të saj

Duhet të konstatohet nëse autoritetet e brendshme i kanë dhënë informacionin e nevojshëm të huajit, të paktën në fazat kryesore të procedimit. Një informacion i tillë do të ishte veçanërisht i dobishëm nëse të huajt nuk përfaqësohen nga një avokat dhe kur mungesa e informacionit përkatës mund të rezultojë në dështimin e tyre për ushtrimin e të drejtave që u ofrohen atyre sipas ligjit të brendshëm. Kjo do të jetë edhe më e rëndësishme në rastet kur rregullat e procedurës së brendshme imponojnë një përshpejtim të caktuar në shqyrtimin e çështjes.

(3) Nëse i huaji ishte i përfaqësuar

Së pari, ligji i brendshëm duhet të ofrojë një mundësi efektive të përfaqësimit. Mundësia që një i huaj të përfaqësohet nga një avokat, apo

edhe nga një avokat i specializuar i cili ka autorizimet përkatëse për të hyrë në dokumentet e klasifikuara në dosjen e çështjes, të cilat nuk janë të aksesueshme për të huajin, përbën një faktor të rëndësishëm balancues. Së dyti, Gjykata do të marrë parasysh nëse ishte e mundur në praktikë që i huaji të kishte qasje efektive në një përfaqësim të tillë gjatë procedimit në fjalë. Së treti, të drejtat që gëzon përfaqësuesi i të huajit në një çështje të caktuar është një garanci tjetër domethënëse: për shembull, në cilën masë i është dhënë përfaqësuesit qasja në dokumentet në dosjen e çështjes, përfshirë ato të klasifikuara, dhe nëse, pas sigurimit të qasjes në materialin e klasifikuar, është kufizuar apo jo komunikimi i përfaqësuesit me të huajin.

(4) Nëse në procedim ishte përfshirë një autoritet i pavarur

Aspektet e mëposhtme mund të merren parasysh, edhe pse pajtueshmëria me Nenin 1 të Protokollit Nr. 7 nuk kërkon domosdoshmërisht që të gjitha këtyre pyetjeve duhet tu jepet përgjigje në mënyrë kumulative në mënyrë pozitive:

- Nëse një ose më shumë autoritete të pavarura, qofshin administrative ose gjyqësore, ishin të përfshira në procedim, ose në miratimin drejtpërdrejt të masës së dëbimit ose në shqyrtimin e ligjshmërisë së saj, apo edhe themelin e saj; dhe nëse ku autoritet është gjykatë, çështja e nivelit të saj në hierarkinë e sistemit juridik të brendshëm. Në lidhje me këtë, shqyrtimi gjyqësor i masës së dëbimit do të ketë në parim një efekt më të madh balancues sesa një formë administrative e shqyrtimit;
- Nëse kërkuesi ishte në gjendje të kundërshtonte, në mënyrë efektive dhe para një autoriteti të pavarur, pretendimet kundër tij;
- Nëse autoriteti i pavarur kishte kompetencën për të shqyrtuar në mënyrë efektive shkaqet në bazë të kërkesës ose vendimit të dëbimit, sipas rastit, dhe provat mbështetëse të paraqitura, dhe nëse po, nëse e ka ushtruar siç duhet atë kompetencë në rastin në fjalë; në veçanti, nëse ai autoritet kishte qasje në tërësinë e dosjes të përpiluar nga organi përkatës i sigurisë kombëtare, përfshirë dokumentet e klasifikuara dhe nëse kishte kompetencën për të verifikuar vërtetësinë e dokumenteve në dosje, së bashku me besueshmërinë dhe vërtetësinë e informacionit të klasifikuar të dhënë në mbështetje të aplikimit ose vendimit të dëbimit, sipas rastit. Në lidhje me këtë, nuk mund të merret e mirëqenë që shkaqet e sigurisë shtetërore të referuara nga organi kompetent i sigurisë kombëtare ekzistojnë dhe janë të vlefshme:

autoriteti i pavarur duhet të jetë në gjendje të verifikojë faktet në dritën e provave të paraqitura;

- Nëse autoriteti i pavarur i caktuar për të rishikuar një vendim dëbimi kishte kompetencën për të anuluar ose ndryshuar atë vendim, nëse, në dritën e dosjes, konstatonte se referimi i sigurisë kombëtare ishte pa asnjë bazë faktike të arsyeshme dhe të përshtatshme;

- Nëse domosdoshmëria e dëbimit ishte mjaftueshëm e besueshme në dritën e rrethanave të çështjes dhe arsytimit të dhënë nga autoriteti i pavarur për të justifikuar vendimin e tij, dhe nëse natyra dhe shkalla e shqyrtimit të aplikuar nga autoriteti kombëtar del, edhe jo formalisht, nga arsytimi i vendimit të tyre.

Zbatimi i këtyre parimeve në rastin konkret

Kishte një kufizim të konsiderueshëm të së drejtës së kërkuesve për t'u informuar për elementet faktike të paraqitura në mbështetje të dëbimit të tyre dhe për përmbajtjen e dokumenteve përkatëse. Sidoqoftë, gjykatat e brendshme nuk kishin kryer ndonjë shqyrtim të nevojës për një kufizim të tillë, dhe as nuk kishin sqaruar arsyet faktike të sigurisë kombëtare në fjalë, pasi ligji i brendshëm nuk i lejonte ata të shqyrtonin kryesisht çështje të tilla. Fakti që një deklaratë për shtyp e botuar nga Shërbimi Informativ Rumun përmbante informacione faktike më të hollësishme se ato që iu dhanë kërkuesve gjatë procedimit të mëparshëm, ishte në kontradiktë me nevojën e pretenduar për t'i privuar ata nga informacioni specifik. Rrjedhimisht, Gjykata duhej të ushtronte një kontroll të rreptë në lidhje me faktorët balancues të vendosur. Kërkuesit kishin marrë vetëm informacione shumë të përgjithshme në lidhje me specifikimet ligjore të akuzave kundër tyre, ndërsa asnjë prej veprimeve të tyre specifike, të cilat dyshoheshin se kishin rrezikuar sigurinë kombëtare, nuk dilte nga dosja. Një renditje e thjeshtë e numrit të dispozitave ligjore të referuara nuk mund të mjaftojë, madje as një minimum, për të përbërë informacion të përshtatshëm në lidhje me akuzat. Për më tepër, një deklaratë për shtyp nuk mund të jetë një mjet i përshtatshëm për të siguruar informacion me një specifikë dhe saktësi të tillë që të ishte përshtatur me tiparet e posaçme të mosmarrëveshjes dhe kuadrit të të drejtave procedurale të palëve. Për më tepër, kërkuesve nuk iu ishte dhënë asnjë informacion në lidhje me fazat kryesore të procedimit ose në lidhje me mundësinë e qasjes në dokumentet e klasifikuara në dosje

përmes një avokati të specializuar. Meqenëse avokatët e tyre nuk kishin autorizim të hynin në dokumentet e klasifikuara, vetëm prania e tyre para gjykatës së brendshme, pa asnjë mundësi për të konstatuar akuzat kundër klientëve të tyre, nuk kishte qenë në gjendje të siguronte mbrojtjen efektive të këtyre të fundit. Së fundmi, nuk ishte e qartë nëse gjykatat e brendshme kishin pasur në të vërtetë të gjithë informacionin e klasifikuar apo kishin verifikuar besueshmërinë dhe vërtetësinë e fakteve themelore: natyra dhe shkalla e shqyrtimit të tyre nuk dilnin, as edhe jo-formalisht, nga arsyetimi i vendimeve të tyre. Kështu, vetëm fakti që vendimi i dëbimit ishte marrë nga autoritete gjyqësore të pavarura në një nivel të lartë, pa qenë e mundur të vërtetohej se ata kishin ushtruar realisht kompetencat e dhëna atyre sipas ligjit rumun, nuk mjaftonte për të balancuar kufizimet që kërkuesit kishin pësuar në ushtrimin e të drejtave të tyre procedurale.

Si përmbledhje dhe duke pasur parasysh procedimin në tërësi, si dhe marzhin e dhënë të vlerësimit, kufizimet në procedimin e brendshëm nuk ishin balancuar në masë të tillë që të ruanin thelbin e të drejtave sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 7.

Përfundim: shkelje (katërmbëdhjetë vota me tre).

Neni 41: 10,000 EUR secilit kërkues në lidhje me dëmin jo-financiar. Pretendimi për dëmin financiar rrëzohet.

(Shih gjithashtu *Schatschaschwili kundër Gjermanisë [DHM]*, 9154/10, 15 dhjetor 2015, [Shënim Informativ 191](#); *Ibrahim dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar [DHM]*, 50541/08 dhe 3 të tjerë, 13 shtator 2016, [Shënim Informativ 199](#); *Regner kundër Republikës Çeke [DHM]*, 35289/11, 19 shtator 2017, [Shënim Informativ 210](#); *Ljatifi kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, 19017/16, 17 May 2018, [Shënim Informativ 218](#))

Neni 6

Neni 6, Çështje penale, Neni 6-1, Gjykimi i drejtë

Mospërrjashtimi i provave të lidhura me nxitjen drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë nga policia për kryerjen e veprave penale me lëndë narkotike shkelje

Neni 34

Viktima

I afërm i të dënuarit i cili ka interes moral në shkeljen e mundshme të Nenit 6 me nxitjen e policisë: *Kundërshtimi paraprak rrëzohet*

Akbay dhe të Tjerë kundër Gjermanisë – 37273/15, 40495/15 dhe 40913/15, Vendimi i datës 15.10.2020 [Seksioni V]

Fakte – Burri i kërkueses së parë, N.A., së bashku me kërkuesit e dytë dhe të tretë, ishin dënuar për vepra penale me lëndë narkotike në kuadrin e një operacioni të importimit të drogës. Gjykatat e brendshme konstatuan se N.A. ishte nxitur të kryente veprën penale nga policia dhe se kërkuesi i dytë, por jo i tretë, ishte nxitur në mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Prandaj, dënimet e N.A.-së dhe kërkuesit të dytë ishin ulur ndjeshëm. Dënimi i dhënë ndaj kërkuesit të tretë përgjithësisht ishte zbutur.

Ligji – Neni 34:

Viktima e drejtpërdrejtë e shkeljeve të Nenit 6 të Konventës të pretenduara nga kërkuesja e parë ishte burri i saj, N.A. Ky i fundit kishte vdekur para se të paraqitej kërkesa nga kërkuesja e parë. Prandaj, Gjykata duhej të shqyrtonte nëse kërkuesja e parë legjitimohej si rast i veçantë në bazë të faktit se veprimet e autoriteteve, të cilat pretendoheshin të ishin në shkelje të Konventës, kishin pasur një efekt të drejtpërdrejtë në të drejtat e saj, pasi ajo mund të tregonte një interes moral ose material, i cili i mundësonte asaj të paraqiste kërkesë.

(a) *Interesi moral*

Një shkelje e mundshme e Nenit 6 bazuar në nxitjen e paligjshme drejt një vepre penale, e cila përndryshe nuk do të ishte kryer, ngrinte çështje që shkonin përtej mangësive thjesht procedurale, duke rezultuar në konstatimin që procedimi në fjalë nuk kishte qenë i drejtë. Duke pasur parasysh se konstatimi i nxitjes duhet të rezultojë në përrjashtimin e të gjitha provave të marra në këtë mënyrë ose të pasojave të ngjashme, përfundimi i Gjykatës, se për këtë shkak kishte pasur një shkelje të Nenit 6, do t'i mundësonte personit në fjalë të kundërshtonte në themel, në nivelin e brendshëm, vlefshmërinë e vetë dënimit i cili ishte bazuar në prova të tilla.

Në këto rrethana, kërkuesja e parë mund të ketë një interes legjitim për të kërkuar, me anë të procedimit në fjalë, përfundimisht shfuqizimin e dënimit

të N.A.-së, të shpallur në bazë të provave të tilla. N.A.-ja ishte një i afërm i ngushtë i kërkueses së parë, i cili ishte dënuar për një vepër të rëndë në lidhje me lëndët narkotike dhe kishte vdekur menjëherë më vonë, pak para se të paraqitej kërkesa konkrete. Prandaj, kërkuesja e parë mund të konsiderohet se ka një interes të caktuar moral për qëllimet e Nenit 34 të Konventës.

(b) Interesi material

Në lidhje me një kërkesë për kompensim të mundshëm sipas Nenit 41 të Konventës në rast të konstatimit të shkeljes së Nenit 6 në procedimin kundër N.A.-së, mund të nxirret nga praktika gjyqësore e Gjykatës se efekti i nevojshëm i drejtpërdrejtë në të drejtat pasurore të një kërkuesi me masën e kundërshtuar duhet të ketë të bëjë me të drejtat pasurore ekzistuese në nivel kombëtar. Nga ana tjetër, një pretendim i mundshëm kompensimi sipas Nenit 41, i cili në radhë të parë kërkon konstatimin e shkeljes së të drejtave të kërkuesit, ishte i pamjaftueshëm për ta bërë kërkuesin e një viktimë të mundshme të një shkeljeje të Nenit 6 § 1; ajo lind vetëm pasi të ketë pasur një shkelje të Nenit 6 § 1. Prandaj, një kërkesë për kompensim të mundshëm sipas Nenit 41 nuk mund të konsiderohet se përbën një interes lëndor që do të kishte lejuar kërkuesen e parë të paraqiste kërkesën në emër të saj.

(c) Çështje me interes të përgjithshëm që i takon 'respektimit të të drejtave të njeriut'

Çështja në fakt ngriti pyetjen veçanërisht, për një nxitje e cila ishte njohur nga gjykatat vendase dhe për pasojat që do të nxirreshin nga një konstatim i nxitjes në mënyrë që të jenë në pajtim me Nenin 6 siç interpretohet, veçanërisht, në çështjen *Furcht kundër Gjermanisë* ([54648/09](#), 23 tetor 2014). Prandaj, çështja kryesore e ngritur nga rasti i paraqitur nga kërkuesja e parë i tejkalonte interesat e saj në atë që kishte të bënte me sistemin juridik dhe praktikën e shtetit të paditur.

Në përmbledhje, duke marrë parasysh interesin moral të kërkuesit dhe praninë e një çështjeje me interes të përgjithshëm që ka të bëjë me "respektimin e të drejtave të njeriut", Gjykata, duke bërë një vlerësim të përgjithshëm, konsideroi se kishte pasur arsye të jashtëzakonshme që kërkonin njohjen e statusit të viktimës së kërkueses së parë.

Përfundim: Kundërshtimi paraprak rrëzohet (unanimisht)

Neni 6, par 1:

(a) Testi lëndor i nxitjes

Gjykatat e brendshme kishin pranuar se si N.A.-ja ashtu edhe kërkuesi i dytë, por jo kërkuesi i tretë, ishin nxitur nga policia.

Ndërsa N.A.-ja kishte qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me agjentin e fshehtë të policisë dhe informatorin që vepronte sipas udhëzimeve të policisë, kërkuesit e dytë dhe të tretë nuk kishin patur ndonjë kontakt të drejtpërdrejtë me ta.

Një person mund të konsiderohet i futur në kurth, nëse nuk është drejtpërdrejt në kontakt me oficerët e policisë që punojnë në fshehtësi, por duhet të jete përfshirë në veprën penale nga një bashkëpunëtor i cili është nxitur drejtpërdrejt për të kryer një vepër penale nga policia. Gjykata mori parasysh, në këtë drejtim, nëse ishte e parashikueshme për policinë që personi i nxitur drejtpërdrejt për të kryer veprën kishte të ngjarë të kontaktonte persona të tjerë për të marrë pjesë në vepër, nëse aktivitetet e atij personi ishin përcaktuar gjithashtu nga sjellja e oficerëve të policisë dhe nëse personat e përfshirë u konsideroheshin si bashkëpunëtorë në veprën penale nga gjykatat vendase.

N.A.-ja paraprakisht nuk kishte asnjë kontakt që do ti mundësonte atij të merrte dhe trafikonte drogë. Mund të ketë qenë vetëm kanali i sigurt i importimit, duke përbërë një nxitje të konsiderueshme për trafikimin e drogës dhe importimin e një sasive të madhe droge, dhe i kontrolluar plotësisht nga autoritetet, gjë që i kishte mundësuar N.A.-së dhe bashkëpunëtorëve të tij të organizonin importimin e drogës me personat ai kishte njohur rastësisht.

Kërkuesit e dytë dhe të tretë ishin rekrutuar nga N.A.-ja për të zbatuar operacionin. Kërkuesi i dytë nuk ishte përfshirë asnjëherë në çështjet e lidhura me drogën, dhe kërkuesi i tretë, i dënuar kohët e fundit për trafik droge, nuk ishte përfshirë me N.A.-në kur policia kishte filluar operacionin.

Ishte e parashikueshme për policinë që N.A.-ja do të kontaktonte persona të tjerë, dhe veçanërisht personat që e vinin në kontakt me furnizuesit e drogës, për të marrë pjesë në veprën penale. Kërkuesi i dytë dhe i tretë kishin vendosur të kontribuonin në importimin e drogës për N.A.-në pikërisht për shkak të kanalit në dukje të sigurt të krijuar nga policia, dhe të përshkruar nga N.A.-ja.

Kërkuesi i dytë u dënua për ndihmën dhe nxitjen e drejtpërdrejtë të veprës me lëndë narkotike të N.A.-së. Prandaj aktivitetet e tij duhej të konsideroheshin të përcaktuara nga sigurimi i kanalit të importit nga policia.

Vepra penale e N.A.-së dhe e kërkuesit të dytë nuk do të ishte kryer pa ndikimin e autoriteteve. Pra, ata ishin nxitur, brenda kuptimit autonom të konceptit, siç përcaktohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës sipas Nenit 6 § 1, nga policia për të kryer veprën penale me lëndë narkotike, për të cilën më pas u dënuan.

Kërkuesi i tretë ishte dënuar pasi kishte rënë dakord të mernte lëndët narkotike në një apartament, pasi ato ishin importuar përmes portit, ishin nxjerrë nga porti me ndihmën e punëtorit të portit dhe ishin dërguar në banesë, dhe të transportonte lëndët narkotike në Berlin. Përveç importimit përmes portit, policia nuk kishte ndikuar dhe as nuk ishte përfshirë në ndonjë mënyrë tjetër në këto aktivitete të mëvonshme të transportit. Ndërsa kërkuesi i tretë u shpall fajtor për zotërim të paligjshëm të lëndëve narkotike që i ishin besuar nga N.A.-ja dhe për ndihmën dhe nxitjen e trafikut të lëndëve narkotike të N.A.-së, pjesëmarrja dhe aktivitetet e tij nuk mund të konsiderohen si të përcaktuara nga sjellja e policia, e cila as nuk kishte ushtruar presion mbi të. Për këtë shkak, përdorimi i mëvonshëm, në procedimin penal në ngarkim të kërkuesit të tretë, i provave të marra me anë të masës së fshehtë, nuk ngrii ndonjë çështje sipas Nenit 6 § 1 në lidhje me të.

(a) Testi procedural i nxitjes

Lidhur me N.A.-në dhe kërkuesin e dytë, Gjykata Rajonale nuk e kishte ndërprerë gjykimin dhe as nuk kishte përjashtuar ndonjë provë pas rënies në kurth. Ajo vetëm u kishte ulur dënimet në mënyrë të konsiderueshme dhe të matshme.

Gjykata ishte e mendimit që në çështjen *Furcht kundër Gjermanisë* të gjitha provat e marra si rezultat i nxitjes së policisë duhet të përjashtohen, ose të zbatohet një procedurë me pasoja të ngjashme.

Gjykata Rajonale kishte përdorur provat e marra drejtpërdrejt si rezultat i nxitjes, përkatësisht dëshminë e agentit të fshehtë dhe oficerëve mbikëqyrës të policisë të informatorit të policisë dhe procesverbalin e raportit të informatorit. Megjithëse Qeveria parashtroi se kjo provë ishte

përdorur përfundimisht për të dënuar N.A.-në dhe kërkuesin e dytë vetëm për aq sa nuk kishte qenë në kundërshtim me dëshmitë e tyre, u duk se të dy ata nuk kishin pasur asnjë mundësi tjetër për të zbuluar shtrirjen e vërtetë të nxitjes, por vetëm duke pranuar fillimisht veprën penale.

Meqenëse kishte një lidhje të ngushtë midis dëshmive që vepra penale ishte kryer dhe nxitjes që kishte çuar në kryerjen e kësaj vepre, Gjykata Rajonale duhej të kishte përjashtuar jo vetëm dëshminë e agjentit të fshehtë dhe të oficerëve mbikëqyrës të policisë dhe procesverbalin e raportit të informatorit, por edhe dëshminë e N.A.-së dhe kërkuesit të dytë, ose duhej të kishte zbatuar një procedurë me pasoja të ngjashme. Pas ankimit, mosnxjerrja e përfundimeve të nevojshme nga nxitja nga gjykata më e ulët ishte përsëritur nga Gjykata e Lartë Federale. Ndërsa të dyja këto gjykata i kishin dhënë vendimet e tyre para vendimit në çështjen *Furcht kundër Gjermanisë*, vendimi i Gjykatës Federale Kushtetuese ishte dhënë pas disa muajsh. Gjykata Federale Kushtetuese e kishte trajtuar gjerësisht praktikën gjyqësore të Gjykatës, përfshirë çështjen *Furcht kundër Gjermanisë*, dhe ishte përpjekur të nxirrte mësim për gjykatat më të ulëta nga vendimi i fundit për të ardhmen. Megjithatë, duke pranuar se provat kundër kërkuesit të dytë që rezultuan nga nxitja nuk ishin përjashtuar plotësisht, ajo ishte përpjekur të dallonte çështjen e N.A.-së dhe kërkuesit të dytë nga çështja *Furcht kundër Gjermanisë*, për të cilin Gjykata nuk mund të shihte asnjë arsye.

N.A.-ja dhe kërkuesi i dytë mund të pretendojnë ende se janë viktimë të shkeljes së Nenit 6 § 1, pasi gjykatat e brendshme nuk kishin nxjerrë përfundimet e nevojshme nga konstatimi i tyre se ishin nxitur për të kryer një vepër penale.

Përfundim: shkelje në lidhje me kërkuesin e parë dhe të dytë, asnjë shkelje në lidhje me kërkuesin e tretë (njëzëri).

Neni 41: 18 000 Euro kërkuesit të dytë në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu *Furcht kundër Gjermanisë*, [54648/09](#), 23 tetor 2014)

Neni 6

Neni 6, Çështje penale, Neni 6-1, Gjykimi i drejtë

Pranimi i provave të marra nëpërmjet keqtrajtimit të një pale të tretë nga individë privatë, pa përfshirjen ose pëlqimin e aktorëve shtetërorë: *shkelje*

Çwik kundër Polonisë – 31454/10 Vendimi i datës 5.11.2020 (Seksioni I)

Faktet – Gjatë gjykimit të kërkuarit për vepra penale në lidhje me lënët narkotike, u pranuan prova të cilat ishin marrë si rezultat i keqtrajtimit të shkaktuar ndaj një pale të tretë (K.G.) nga persona privatë.

Ligji – Neni 6 § 1: Gjykata tashmë ishte shprehur në një sërë rastesh që pranimi i deklarimeve, të marra si rezultat i torturës ose një keqtrajtimi tjetër në shkelje të Nenit 3, si prova në procedimet penale i bën këto procedime në tërësi të padrejta. Një element i përbashkët e të gjitha këtyre rasteve kishte qenë përfshirja e agentëve të Shtetit në marrjen e deklarimeve të kundërshtuara nga të akuzuarit ose nga një palë e tretë.

Pyetja para Gjykatës, e cila nuk ishte ngritur më parë, ishte nëse rregulli i lartpërmendur mund të ishte i zbatueshëm për rastin në të cilin informacioni i ishte marrë një pale të tretë si rezultat i keqtrajtimit të shkaktuar nga individë privatë, edhe kur nuk kishte pasur dëshmi të përfshirjes ose pëlqimit të aktorëve shtetërorë.

(a) Nëse informacioni i marrë K.G.-së kundër vullnetit të tij konsiderohej si rezultat i keqtrajtimit të ndaluar nga Neni 3

Nuk ishte e nevojshme të përcaktohej nëse trajtimi të cilit i ishte nënshtruar K.G.-ja mund të cilësohet si torturë sipas kuptimit të Nenit 3. Materiali që ishte në dispozicion të Gjykatës, veçanërisht vendimi i gjykatës së themelit, nuk linte asnjë dyshim se trajtimi i shkaktuar K.G.-së kishte arritur pragun e nevojshëm të ashpërsisë për të qenë brenda fushës së zbatimit të Nenit 3 të Konventës. Prandaj, informacioni i nxjerrë prej K.G.-së ishte marrë si rezultat i keqtrajtimit të shkaktuar nga individë privatë dhe detyrimi pozitiv i Shtetit që lind sipas Nenit 3 ishte i zbatueshëm për këtë keqtrajtim.

(b) Ankesa sipas Nenit 6 § 1

Gjykata e Apelit nuk e kishte trajtuar argumentin e kërkuarit të ngritur në thelb sipas Nenit 3 se regjistrimi i kundërshtuar ishte marrë si rezultat i

keqtrajtimin të pësuar në duart e individëve privatë dhe çështjen lidhur me mosbesueshmërinë e provave të tilla.

Përdorimi në procedimet penale i provave të marra si rezultat i trajtimit të një personi në shkelje të Nenit 3 – pavarësisht nëse ai trajtim klasifikohet si torturë, trajtim çnjerëzor ose poshtëruës – e kishte bërë procedimin në tërësi automatikisht të padrejtë, në shkelje të Nenit 6. Kjo ishte pavarësisht nga vlera provuese e provës dhe pavarësisht nëse përdorimi i tyre kishte qenë vendimtar në sigurimin e dënimit të të pandehurit.

Parimi i lartpërmendur ishte po aq i zbatueshëm për pranimin e provave të marra një pale të tretë si rezultat i keqtrajtimin të parashikuar nga Neni 3 kur një keqtrajtim i tillë ishte shkaktuar nga persona privatë, pavarësisht nga klasifikimi i atij trajtimi.

Gjykata e Apelit kishte pranuar përdorimin si provë të informacionit të marrë K.G.-së që ishte marrë në kundërshtim me ndalimin absolut të keqtrajtimin të garantuar në Nenin 3. Duke vepruar kështu, Gjykata e Apelit nuk kishte marrë parasysh implikimet e vendimit të saj nga pikëpamja e të drejtës së kërkuesit për një gjykim të drejtë sipas Nenit 6 § 1 të Konventës. Gjykata e Lartë kishte hedhur poshtë ankimin për ligjshmëri të kërkuesit si qartazi të pabazuar dhe nuk kishte dhënë asnjë arsye për vendimin e saj. Rrjedhimisht, procedimi ishte bërë në tërësi i padrejtë.

Përfundimi: shkelje (pesë vota me dy).

Neni 41: 8,000 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar. Pretendimi për dëmin financiar rrëzohet.

(Shih gjithashtu *H.L.R. kundër Francës* [DHM], [24573/94](#), 29 prill 1997, *Jalloh kundër Gjermanisë* [DHM], 54810/00, 11 korrik 2006, [Shënim Informativ 88](#); *Gäfgen kundër Gjermanisë*, 22978/05, 1 qershor 2010, [Shënim Informativ 131](#); *Othman (Abu Qatada) kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 8139/09, 17 janar 2012, [Shënim Informativ 148](#); *J.K. dhe të Tjerë kundër Suedisë* [DHM], 59166/12, 23 gusht 2016, [Shënim Informativ 199](#); [Udhëzim për Nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut – E drejta për gjykim të drejtë \(aspekti penal\)](#))

Neni 14

Diskriminimi

Dënimi për kundërvajtje dhe gjoba 40 Euro për sulm të dhunshëm homofobik, pa hetuar motivet e urrejtjes, dhe ndërprerja e mëvonshme të procedimit penal bazuar në *ne bis in idem*: shkelje

Sabalić kundër Kroacisë – 50231/13 Vendimi i datës 14.1.2021 (Seksioni I)

Fakte – Kërkesja u sulmua fizikisht nga një individ privat (M.M.) pasi i bëri të ditur atij orientimin e saj seksual. Ajo mori lëndime të lehta fizike nga incidenti. Policia më pas pati sukses me fillimin e procedurave për kundërvajtjeve penale kundër M.M.-së për shkelje të qetësisë dhe rendit publik. Ai u gjobit me rreth 40 Euro. Pas vënies në dijeni se policia nuk kishte filluar një hetim penal kundër M.M.-së, kërkesja paraqiti një kallëzim penal në Zyrën e Prokurorit të Shtetit. Ai u refuzua, me arsyetimin se M.M.-ja ishte ndjekur penalisht për kundërvajtje dhe se ndjekja sërish e tij penalisht do të binte ndesh me parimin *ne bis in idem*.

Ligji – Neni 14 (në lidhje me Nenin 3):

(a) *Objekti*

Gjykata konstatoi se mënyra më e përshtatshme për të vazhduar me pretendimet e kërkueses – që dhuna ndaj saj kishte ngjyrimet homofobike të cilat nuk ishin trajtuar siç duhet nga autoritetet – ishte t’ia nënshtronte ato një ekzaminimi të njëkohshëm sipas Nenit 3 të marrë në lidhje me Nenin 14.

(b) *Përgjigja e autoriteteve të brendshme*

Sistemi ligjor i brendshëm kishte parashikuar mekanizma të së drejtës penale që mbronin individët nga dhuna e motivuar nga urrejtja. Sidoqoftë, Gjykata nuk kishte nevojë të shqyrtonte atë kuadër më tej, pasi ankesa e kërkueses ishte më tepër e një natyre procedurale.

Policia kishte reaguar menjëherë në vendin e ngjarjes dhe bëri gjetjet fillestare, të cilat përmbanin tregues *prima facie* të dhunës të motivuar ose të paktën të ndikuar nga orientimi seksual i kërkueses. Këto gjetje nuk ishin vënë kurrë në dyshim gjatë procedimit në nivelin e brendshëm. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, kjo kishte kërkuar një zbatim efektiv të mekanizmave penalë vendas të përshtatshëm për të sqaruar motivin e mundshëm të urrejtjes me ngjyrimet homofobike pas incidentit

të dhunshëm dhe për të identifikuar, dhe, sipas rastit, dhënë ndëshkimin e duhur personave përgjegjës. Sipas procedimit të brendshëm, policisë i kërkohej të paraqiste një kallëzim penal në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, e cila kishte qenë kompetente për të kryer hetime të mëtejshme zyrtare mbi indiciet e krimit të dhunshëm të urrejtjes, edhe në rastet e lëndimeve të vogla trupore. Lëndimet e rënda trupore të mbetura në tentativë dhe sjelljet e dhunshme, dhe aktet e shkeljes diskriminuese të të drejtave të njeriut kërkonin një hetim dhe ndjekje penale kryesisht edhe pa elementin e krimit të urrejtjes. Në bazë të këtyre dispozitave, Zyra e Prokurorit të Shtetit kishte filluar një hetim zyrtar para një gjyqtari hetues. Prandaj nuk kishte asnjë dyshim se, edhe në aspektin e së drejtës së brendshme, policia kishte për detyrë të raportonte çështjen në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, gjë që, megjithatë, ata nuk e kishin kishin bërë.

Në vend të kësaj, policia kishte nisur procedimin për kundërvajtje duke akuzuar M.M.-në për shkelje të qetësisë dhe rendit publik. Kjo nuk e kishte adresuar në asnjë mënyrë elementin e krimit të urrejtjes ndaj sulmit fizik, dhe M.M.-ja nuk ishte akuzuar apo dënuar për ndonjë akuzë në lidhje me dhunën e motivuar nga diskriminimi. Për më tepër, ai ishte dënuar me një gjobë qesharake prej afërsisht 40 Euro. Gjykata nuk mund të anashkalojë faktin se dënimi ishte dukshëm joproporcional me peshën e keqtrajtimit të pësuar nga kërkuesja. Ky përfundim u konfirmua duke e krahasuar atë me sanksionet e parashikuara për veprat e klasifikuara më pas nga Zyra e Prokurorit të Shtetit – të cilat i nënshtroheshin dënimit me burgim.

Në përgjithësi, reagimi i autoriteteve të brendshme përmes procedimeve për kundërvajtje nuk kishte qenë në gjendje të demonstronte angazhimin e Konventës nga Shteti për të siguruar që keqtrajtimi homofobik të mos injorohej nga autoritetet përkatëse dhe të siguronte mbrojtje efektive kundër akteve të keqtrajtimit të motivuara nga orientimi seksual i kërkueses. Mundësia e vetme për këto procedime mund të konsiderohet më tepër si një reagim që ndjell një ndjenjë mosndëshkimi për aktet e krimit të dhunshëm të urrejtjes, sesa si një mekanizëm procedural që tregon se akte të tilla nuk mund të tolerohen në asnjë mënyrë.

(c) *Parimi ne bis in idem (Neni 4 § 2 i Protokollit Nr. 7)*

Zyra e Prokurorit të Shtetit dhe gjykatat penale kishin konstatuar, në bazë të interpretimit të tyre të praktikës gjyqësore *Sergey Zolotukhin* dhe *Maresti*,

se dënimi përfundimtar i M.M.-së në procedimin për kundërvajtje penale kishte krijuar një pengesë formale për ndjekjen e tij penale për krimin e dhunshëm të urrejtjes në bazë të parimit *ne bis in idem*. Qeveria kishte parashtruar se, duke qenë se ishte e nevojshme të sigurohej pajtueshmëria me parimin, autoritetet vendase kishin një arsye të justifikuar për moszbatimin e mekanizmit efektiv të së drejtës penale.

Megjithatë, autoritetet e brendshme e kishin krijuar vetë situatën në të cilën, duke filluar në mënyrë të panevojshme procedimin joefektiv të kundërvajtjeve penale, kishin minuar mundësinë për të vënë në praktikë dispozitat dhe kërkesat përkatëse të ligjit penal të brendshëm.

Si mos-hetimi i motiveve të urrejtjes pas një sulmi të dhunshëm, ashtu edhe mos marrja parasysh e motiveve të tilla në përcaktimin e dënimit për krimet e dhunshme të urrejtjes, kishin sjellë “defekte themelore” në procedimin sipas Nenit 4 § 2 të Protokollit Nr. 7. Autoritetet e brendshme nuk kishin arritur të korrigjonin situatën e kundërshtuar, megjithëse nuk mund të thuhet se kishte pasur pengesa *de jure* për ta bërë këtë. Veçanërisht, ata nuk kishin arritur t’i ofronin të pandehurit trajtimin e duhur, për shembull, duke pushuar ose shfuqizuar elementët e papërshtatshëm të procedimit dhe shuar efektet e tij, dhe duke rishqyrtuar çështjen.

(d) Në përgjithësi

Duke filluar procedimin joefektiv të kundërvajtjeve penale dhe, si rezultat, duke ndërprerë gabimisht procedimin penal për shkaqe formale, autoritetet e brendshme nuk kishin përbushur në mënyrën e duhur dhe efektive detyrimet e tyre procedurale sipas Konventës në lidhje me sulmin e dhunshëm kundër kërkueses të motivuar nga orientimi i saj seksual. Një sjellje e tillë e autoriteteve ishte në kundërshtim me detyrën e tyre për të luftuar pandëshkueshmërinë në lidhje me krimet e urrejtjes, të cilat janë veçanërisht shkatërruese të të drejtave themelore.

Përfundimi: shkelje (unanimisht).

Neni 41: 10,000 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu *Sergey Zolotukhin kundër Ruisë* [DHM], 14939/03, 10 shkurt 2009, [Shënim Informativ 116](#); *Maresti kundër Kroacisë*, [55759/07](#), 25 qershor 2009)

Neni 3

Hetimi efektiv

Mospërdorimi i të gjitha masave të arsyeshme hetimore dhe i bashkëpunimit ndërkombëtar gjatë shqyrtimit të abuzimit seksual në një jetimore të pretenduar pas birësimit të fëmijëve jashtë vendit: *shkelje*

X dhe të Tjerë kundër Bullgarisë [DHM] – 22457/16, Vendim i datës 2.2.2021 [DHM]

Fakte – Kërkuesit, të cilët kanë lindur në Bullgari, janë tre vëllezër e motra. Në qershor 2012, përkatësisht 12, 10 dhe 9 vjeç, ata u adoptuan nga një çift italian. Kërkuesit më pas u treguan prindërve të tyre birësues në lidhje me abuzimin seksual gjatë vendosjes së tyre në një jetimore në Bullgari.

Si drejtpërdrejt ashtu edhe përmes një shoqate të linjës së ndihmës, prindërit paraqitën ankesa për abuzimin tek autoritetet italiane, d.m.th., përmes Komisionit Italian për Birësimin Ndërvendor (“CAI”) dhe zyrës së prokurorit publik të Milanos. Këto autoritete ua përcollën ankesat autoriteteve bullgare. Prindërit e kërkuesit kontaktuan gjithashtu një gazetar investigativ italian, i cili publikoi një artikull që pretendonte abuzim seksual në shkallë të gjerë të fëmijëve në jetimore, gjë që mori vëmendjen e mediave në Bullgari. Pas këtyre veprimeve, në Bullgari filluan tre hetime të veçanta, paraprake në lidhje me pretendimet e raportuara. Të tre u ndërprejnë për mungesë provash se ishte kryer një vepër penale, vendim i cili u la në fuqi nga gjykatat e brendshme më të larta.

Me vendimin e datës 17 janar 2019 (shih [Përmbledhje Ligjore](#)), një Dhomë e Gjykatës u shpreh, unanimisht, që nuk ka patur shkelje të Nenit 3 (aspekti lëndor dhe procedural) dhe 8 të Konventës. Çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuesve.

Ligji – Neni 3: Gjykata i konsideroi ankesat në fjalë më të përshtatshme për t’u shqyrtuar vetëm sipas Nenit 3.

(a) Detyrimet pozitive për të vendosur kuadrin e duhur legjislativ dhe rregullator (aspekti lëndor)

Ekzistenca në Shtetin e paditur e legjislacionit penal që synon parandalimin dhe ndëshkimin e abuzimit seksual të fëmijëve nuk ishte vënë në pikëpyetje nga kërkuesit, dhe dispozitat përkatëse të Kodit Penal Bullgar dukeshin

të përshtatshme për të mbuluar veprimet e ankimuara në rastin konkret. Shtetet gjithashtu kishin një detyrë të shtuar të mbrojtjes ndaj fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror dhe të vendosur në kujdesin e një institucioni publik, dhe të cilët ishin për këtë arsye në një situatë veçanërisht të cenueshme. Në lidhje me këtë, Shteti i paditur kishte pohuar se ishin krijuar një numër mekanizmesh për parandalimin dhe zbulimin e keqtrajtimit nëpër jetimore. Megjithëse kërkuesit kundërshtuan ekzistencën faktike dhe efektivitetin e disa prej këtyre masave dhe mekanizmave, nuk kishte informacion të mjaftueshëm për ta vërtetuar këtë. As nuk ishte vërtetuar se kishte pasur një çështje sistemike në lidhje me abuzimin seksual të fëmijëve të vegjël në objektet rezidenciale, të tillë që të kërkonte masa më të rrepta nga ana e autoriteteve.

(b) Detyrimi pozitiv për të marrë masa parandaluese operationale (aspekti lëndor)

Kërkuesit kishin qenë në një situatë veçanërisht të cenueshme dhe ishin vënë vetëm nën kujdesin e autoriteteve publike. Në ato rrethana, detyrimi për të marrë masa parandaluese operationale kur autoritetet kishin, ose duhej të kishin, njohuri për rrezikun që një fëmijë mund t'i nënshtrohej keqtrajtimit, ishte i shtuar në rastin konkret dhe kërkonte që ato të ushtronin vigjilencë të veçantë.

Hetimet e brendshme nuk kishin konstatuar se ishte vërtetuar që anëtarët e personelit të jetimoreve apo ndonjë autoriteti tjetër kishin qenë në dijeni të abuzimit të pretenduar. Në këto rrethana dhe në mungesë të provave që mbështesin pohimin se kërkuesi i parë i kishte raportuar abuzimin drejtorit të jetimores, Gjykata nuk kishte informacion të mjaftueshëm për të konstatuar që autoritetet bullgare e kishin ditur, ose duhej ta dinin, rrezikun real dhe të menjëhershëm që kërkuesit i nënshtroheshin keqtrajtimit, të tillë që të shkaktonte detyrimin e marrjes së masave parandaluese operationale për ti mbrojtur nga një rrezik i tillë.

Përfundim: nuk ka shkelje (njëzëri)

(c) Detyrimi procedural për kryerjen e një hetimi të efektshëm

Në rastet që përfshijnë potencialisht abuzimin seksual të fëmijëve, detyrimi procedural sipas Nenit 3 për të kryer një hetim efektiv duhej të interpretohej në dritën e detyrimeve që rrjedhin nga instrumentet e tjera

ndërkombëtare të zbatueshme, dhe më konkretisht [Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual](#) (“Konventa Lanzarote”; shih veçanërisht Nenet 12-14 dhe 30-38).

Detyrimi i autoriteteve për të kryer një hetim të hollësishëm u shkaktua sapo ata morën akuza të arsyeshme për abuzimin seksual. Ky detyrim nuk mund të kufizohet në reagimin ndaj çdo kërkesë të bërë nga viktimat ose lënien e kësaj në iniciativën e viktimës për të marrë përgjegjësinë për çdo procedurë hetimore. Që në shkurt 2013, autoritetet bullgare kishin marrë informacion më të detajuar nga zyra e prokurorit publik në Milano në lidhje me pretendimet e kërkuarve. Ky informacion kishte treguar se psikologët e kërkuarve i kishin konsideruar pretendimet e tyre të besueshme dhe se një numër organesh italiane i kishin konsideruar ato serioze në masën e mjaftueshme për të autorizuar një hetim. Prandaj, autoritetet bullgare ishin përballur me pretendime të arsyeshme që shkaktonin detyrimin procedural sipas Nenit 3.

Autoritetet bullgare kishin ndërmarrë një numër hapash hetimorë. Prandaj, Gjykata duhej të shqyrtonte nëse hetimet kishin qenë efektive në masën e mjaftueshme. Nuk kishte asnjë arsye për të vënë në dyshim gatishmërinë dhe shpejtësinë me të cilën kishin vepruar autoritetet bullgare, as pavarësinë e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve (“ASMF”), e cila kishte kryer një numër të këtyre hapave.

Megjithëse prindërit e kërkuarve nuk kishin kërkuar të përfshiheshin në hetim, ishte për të ardhur keq që autoritetet bullgare nuk kishin provuar t’i kontaktonin për t’u siguruar atyre informacionin dhe mbështetjen e nevojshme në kohën e duhur. Në këtë mënyrë ata ishin penguar të merrnin pjesë aktive në procedimet e ndryshme, dhe ata nuk kishin qenë në gjendje të paraqisnin asnjë ankim deri shumë kohë pasi kishin përfunduar hetimet (shih në lidhje me këtë Nenin 31 § 1 (a), (c) dhe (d) të Konventës Lanzarote).

Lidhur me plotësinë e hetimit: ekspertët nga autoritetet përkatëse dhe policia kishin kryer kontrole në vend, kishin konsultuar dosjet, përfshirë dosjet mjekësore të kërkuarve dhe fëmijëve të tjerë që kishin jetuar në jetimore gjatë periudhës në fjalë, dhe kishin intervistuar anëtarë të ndryshëm të personelit, profesionistë dhe individë që mund të kenë qenë autorët e dyshuar. Intervista ishin kryer edhe me fëmijët që jetonin në jetimore, duke përfshirë disa nga fëmijët e përmendur nga kërkuarët: megjithëse këto nuk

ishin përshtatur gjithmonë me moshën dhe nivelin e pjekurisë së fëmijëve, dhe nuk ishin regjistruar me video (shih në lidhje me këtë Nenin 35 §§ 1 dhe 2 të Konventës Lanzarote). Njëri nga fëmijët duhej të intervistohesh për herë të dytë nga policia.

Më tej, autoritetet me sa duket kishin neglizhuar të ndiqnin disa pista hetimi të cilat mund të kishin rezultuar të rëndësishme, dhe të merrnin masa të caktuara hetimore:

1) Bashkëpunimi ndërkombëtar

Nëse autoritetet bullgare do të kishin dyshime në lidhje me besueshmërinë e pretendimeve të kërkuësve, ata mund të kishin provuar të sqaronin faktet duke kërkuar të intervistonin kërkuësit dhe prindërit e tyre. Si profesionistë që kishin dëgjuar deklaratat e fëmijëve, psikologët e ndryshëm që kishin folur me kërkuësit në Itali do të kishin qenë gjithashtu në gjendje të kishin dhënë informacion të rëndësishëm. Ndonëse mund të mos ishte e këshillueshme që autoritetet bullgare të intervistonin kërkuësit – duke pasur parasysh rrezikun e përkeqësimit të ndonjë traume dhe rreziqet e joefikasitetit të shoqëruar me kalimin e kohës dhe ndikimin e provave nga memoria e mëvonshme ose ndikimet e jashtme – autoritetet duhej të kishin vlerësuar nevojën e kërkimit të intervistave të tilla. Të udhëhequr nga parimet e përcaktuara në instrumentet ndërkombëtare, autoritetet mund të kishin marrë masa për të ndihmuar dhe mbështetur kërkuësit në cilësinë e tyre të dyfishtë si viktimat dhe dëshmitarë dhe mund të kishin udhëtuar në Itali në kuadrin e ndihmës juridike reciproke ose tu kishin kërkuar autoriteteve italiane të intervistonin përsëri kërkuësit. Siç pasqyrohet në Konventën Lanzarote dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës (*Güzelyurtlu dhe të Tjerë kundër Qipros dhe Turqisë* [DHM], [36925/07](#), 29 janar 2019), në rastet transnacionale, detyrimi procedural për të hetuar mund të sjellë një detyrim për të kërkuar bashkëpunimin e Shteteve të tjera me qëllim të hetimit dhe ndjekjes penale. Në rastin konkret, megjithëse prokurori publik italian kishte refuzuar juridiksionin me arsyetimin se kishte një lidhje të pamjaftueshme juridiksionale me Italinë në lidhje me faktet, do të kishte qenë e mundur që kërkuësit të intervistoheshin nën mekanizmat e bashkëpunimit gjyqësor ekzistues veçanërisht brenda Bashkimi Europian. Edhe nëse ata nuk do të kishin kërkuar të intervistonin drejtpërdrejt kërkuësit, autoritetet bullgare të paktën mund të kishin kërkuar nga homologët e tyre italianë regjistrimet video të dëshmive të kërkuësit – të cilat ishin marrë nga psikologët dhe

përmes një interviste me prokurorin publik italian për të miturit – me qëllim të vlerësimit të besueshmërisë së tyre.

Po ashtu, duke pasur parasysh mungesën e certifikatave mjekësore, autoritetet bullgare, përsëri në kuadrin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, mund të kishin kërkuar që ata t'i nënshtroheshin një ekzaminimi mjekësor.

ii) Hetimi i abuzimit të fëmijëve dhe nga fëmijë të tjerë

Dëshmitë e kërkuarve dhe provat përkatëse kishin gjithashtu informacione në lidhje me fëmijët e tjerë që dyshohej se ishin viktimat të abuzimit, dhe fëmijët që pretendoheshin se kishin kryer abuzime, disa prej të cilëve përbënin keqtrajtim. Prandaj autoritetet kishin për detyrë ti ndriçonin ato fakte të pretenduara. Megjithatë, autoritetet nuk ishin përpjekur të intervistonin fëmijët e identifikuar nga kërkuarët që kishin lënë ndërkohë jetimoren.

iii) Masa të tjera hetimore

Duke pasur parasysh natyrën dhe seriozitetin e abuzimit të pretenduar, duhej të ishin konsideruar masat hetimore të një natyre më të fshehtë, të tilla si mbikëqyrja e perimetrit të jetimoreve, përgjimi i telefonit ose përgjimi i mesazheve telefonike dhe elektronike, si dhe përdorimi i agjentëve të fshehtë. Masa të tilla ishin parashikuar në Konventën Lanzarote dhe janë përdorur gjerësisht gjatë hetimeve të tilla në Europë. Ndërsa garancitë e përfshira në Nenin 8 (respektimi i privatësisë) mund të vendosin në mënyrë legjitime kufizime në objektin e masave hetimore, masa të tilla dukeshin të përshtatshme dhe proporcionale në rastin konkret, duke pasur parasysh pretendimet e kërkuarve për përfshirjen e një rrjeti të organizuar dhe faktin që mund të gjendeshin individë të identifikueshëm. Masat e këtij lloji mund të ishin zbatuar në mënyrë progresive, duke filluar me ato që kishin ndikimin më të vogël në jetën private të individëve.

Ndërsa vuri në dukje se Konventa Lanzarote inkurajonte përdorimin e linjave të dedikuara të ndihmës si një mjet për të raportuar abuzimin, Gjykata shprehu keqardhje për mungesën e përgjigjes së ASMF-së, pas e-mailit të babait të kërkuarve dhe raportit të Qendrës Nadja (një fondacion bullgar i specializuar për mbrojtjen e fëmijëve) në Nëntor 2012. Ata kishin mundësinë që, brenda një kuadri që garantonte anonimitetin ndaj viktimave të mundshme, të kërkonin nga Qendra të gjitha detajet e nevojshme, të cilat

do të kishin bërë të mundur identifikimin e jetimores në fjalë dhe kryerjen e masave të fshehta hetimore edhe më herët.

Më tej, megjithë pretendimet se një fotograf kishte prodhuar imazhe, hetuesit nuk e kishin konsideruar të kontrollonin studion e tij dhe të sekuestronin sendet në të cilat mund të ishin ruajtur. Në përgjithësi, sekuestrimi i sendeve mediatike të përdorura nga individë të tjerë përkatës mund të bënte të mundur, nëse nuk do të jepte prova për abuzimin e pretenduar nga kërkuesit, i cili kishte ndodhur disa muaj më parë, të paktën marrjen e provave në lidhje me abuzime të ngjashme me fëmijët.

iv) Në tërësi

Duke kryer hetimet, autoritetet bullgare iu ishin përgjigjur zyrtarisht kërkesave të autoriteteve italiane dhe, indirekt, atyre të prindërve të kërkuesve. Sidoqoftë, autoritetet hetimore – të cilat, veçanërisht, nuk kishin përdorur mekanizmat e disponueshme të hetimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar – nuk kishin marrë të gjitha masat e arsyeshme për të hedhur dritë mbi faktet dhe nuk kishin ndërmarrë një analizë të plotë dhe të kujdesshme të provave para tyre. Në vend të kësaj, ata i kishin kufizuar përpjekjet e tyre hetimore në pyetjen e njerëzve të pranishëm në jetimore ose në afërsi, dhe e kishin mbyllur çështjen vetëm në bazë të asaj metode hetimore. Në të vërtetë, arsyet e dhëna për vendimet e autoriteteve për mbylljen e hetimeve duket se tregojnë se, në vend që të sqaroheshin të gjitha faktet përkatëse, autoritetet hetuese kishin kërkuar të vërtetonin se pretendimet e kërkuesve kishin qenë të rreme.

Gjykata gjithashtu vuri në dukje dhe e konsideroi të papranueshme që Presidenti i ASMF-së të kishte dhënë një deklaratë televizive, edhe para konstatimeve të inspektimit të parë të autoritetit, në të cilën ai kishte akuzuar prindërit e kërkuesve për shpifje, manipulim dhe prindërim të papërshtatshëm, dhe se një grupi i deputetëve që vizituan jetimoren kishte miratuar një qëndrim të ngjashëm. Deklarata të tilla në mënyrë të pashmangshme kishin minuar objektivitetin – dhe rrjedhimisht besueshmërinë – e hetimeve të kryera nga ASMF-ja dhe të vetë institucionit.

Në tërësi, mosveprimet e vëzhguara ishin serioze në masë të mjaftueshme për të konsideruar që hetimi nuk kishte qenë efektiv për qëllimet e Nenit 3, të interpretuar në dritën e instrumenteve të tjerë ndërkombëtarë të zbatueshëm dhe në veçanti të Konventës Lanzarote.

Përfundim: shkelje (nëntë vota me tetë).

Neni 41: 12,000 EUR secili në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu *O’Keefe kundër Irlandës* [DHM], 35810/09, 28 janar 2014, [Përmbledhje Ligjore](#))

Neni 14

Diskriminimi

Diskriminim i pajustificuar, i drejtpërdrejtë bazuar në seks duke refuzuar përfitimet e lidhura me punësimin për gratë shtatzëna që iu nënshtruan fekondimit *in vitro* pak para punësimit: shkelje

Jurčić kundër Kroacisë – 54711/15 Vendimi i datës 4.2.2021 (Seksioni I)

Fakte – Kërkesja lidhi një kontratë pune dhjetë ditë pasi i ishte nënshtruar fekondimit *in vitro* (IVF). Kur ajo më pas mori raport mjekësor, për shkak të komplikimeve të lidhura me shtatzëninë, autoriteti përkatës vendos rishqyrtoi statusin e saj të sigurimit shëndetësor. Ai arriti në përfundimin se, duke nënshkruar kontratën menjëherë pas IVF-së, kërkesja kishte kërkuar vetëm të merrte avantazhe ekonomike në lidhje me statusin e punësimit dhe se punësimi i saj në këtë mënyrë ishte fiktiv. Kërkesa e saj për t’u regjistruar si punonjëse e siguruar, së bashku me kërkesën e saj për kompensim të pagës për shkak të lejes me raport mjekësor, për pasojë u refuzua. Ajo bëri ankim por nuk pati sukses.

Ligji – Neni 14 në lidhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1:

(a) Nëse ka pasur një ndryshim në trajtim

Kërkesues i ishte refuzuar statusi i punonjëses së siguruar dhe përfitimi i lidhur me punësimin, për shkak të punësimit të deklaruar fiktiv për shkak të shtatzënisë së saj. Një vendim i tillë mund të merret vetëm në lidhje me gratë. Prandaj, ky përbënte një ndryshim në trajtimin për shkak të seksit.

(b) Nëse ndryshimi në trajtim ishte i justifikuar

Qeveria kishte argumentuar se vendimi për të anuluar statusin e sigurimit të kërkesues kishte ndjekur qëllimin legjitim të mbrojtjes së burimeve publike nga përdorimi mashtrues dhe të stabilitetit të përgjithshëm të sistemit të

kujdesit shëndetësor. Gjykata theksoi se shtatzënia e një gruaje si e tillë nuk mund të konsiderohet sjellje mashtruese dhe se detyrimet financiare të vendosura ndaj Shtetit gjatë shtatzënisë së një gruaje në vetvete nuk mund të përbënin arsye të mjaftueshme për të justifikuar ndryshimin në trajtim në bazë të seksit.

Edhe duke prezumuar që Gjykata ishte përgjithësisht e predispozuar për të pranuar qëllimin e mbrojtjes së fondeve publike si legjitime, duhej të përcaktohej nëse masa e kundërshtuar kishte qenë e nevojshme për ta arritur atë, duke marrë parasysh marzhin e ngushtë të vlerësimit të ofruar Shteteve në rastet kur diferenca në trajtim bazohej në seks.

Pikërisht për faktin se kërkuësja kishte hyrë në një punë të re kaq pak kohë para se të kërkonte përfitimin në lidhje me punësimin, autoriteti administrativ përkatës kishte filluar rishikimin e statusit të sigurimit shëndetësor të kërkuëses, nën dyshimin se kontrata e saj e punës ishte lidhur vetëm që ajo të ishte në gjendje të kërkonte atë përfitim. Sipas legjislacionit në fuqi, autoritetet përkatëse kishin të drejtë të verifikonin nëse faktet në të cilat një individ kishte bazuar statusin e tij të sigurimit shëndetësor ishin ende të vlefshme. Sidoqoftë, një rishikim i tillë në praktikë kishte në shënjestër shpesh gratë shtatzëna dhe gratë që kishin lidhur një kontratë pune në një fazë të avancuar të shtatzënisë së tyre ose me anëtarët e ngushtë të familjes ishin vënë automatikisht në kategorinë e punonjësve “të dyshimtë”, punësimi i të cilëve meritonte verifikim. Një qasje e tillë ishte në përgjithësi problematike.

Në rastin konkret, autoritetet kishin arritur në përfundimin se kërkuësja ishte e papërshtatshme për të punuar në datën e lidhjes së kontratës së saj sepse mjeku i saj i kishte rekomanduar asaj pushim, pas IVF-së së saj dhjetë ditë më parë. Veçanërisht, ata ishin mbështetur në faktin se kërkuësja mendohej të punonte në selinë e punëdhënësit, e vendosur larg vendbanimit të saj, dhe se udhëtimi në gjendjen e saj mund të pakësonte shanset e saj për një rezultat të favorshëm të fekondimit. Në parim, edhe aty ku disponibiliteti i një punonjësi ishte një parakusht për përmbushjen e duhur të një kontrate pune, mbrojtja që u jepet grave gjatë shtatzënisë nuk mund të varet nga fakti nëse prania e saj në punë gjatë lejes së lindjes ishte thelbësore për zhvillimin normal të aktivitetit të punëdhënësit të saj, ose me faktin se ajo pengohet përkohësisht në kryerja e punës për të cilën ajo ishte punësuar. Për më tepër, prezantimi i masave për mbrojtjen e lehonisë ishte thelbësore

për të garantuar parimin e trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në punësim.

Duke arritur në përfundimin se, për shkak të IVF-së, kërkuesja ishte e paaftë nga ana mjekësore për të filluar punësimin në fjalë, autoritetet vendase kishin lënë të kuptohej se ajo nuk duhej ta bënte këtë derisa të ishte konfirmuar shtatzënia. Ky përfundim ishte në kundërshtim të drejtpërdrejtë me të drejtën e brendshme dhe ndërkombëtare. Kjo sillte gjithashtu si pasojë dekurajimin e kërkueses në kërkimin e punës për shkak të shtatzënisë së saj të mundshme.

Sa më sipër ishte e mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ankuesja ishte diskriminuar në bazë të seksit. Sidoqoftë, Gjykata e gjeti të nevojshme të vinte në dukje disa faktorë shtesë, të cilët e kishin përkeqësuar dallimin në trajtim:

- Kërkuesja kishte paguar rregullisht kontribute në skemën e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor gjatë katërmbëdhjetë viteve të përvojës së saj të mëparshme të punës. Kështu nuk mund të argumentohet se ajo nuk kishte dhënë kontribute në fondin e sigurimeve;

- Kur nisi punësimin e saj, kërkuesja nuk kishte asnjë mënyrë për të ditur nëse procedura IVF-ë kishte qenë e suksesshme ose nëse do të rezultonte në shtatzani. Për më tepër, ajo nuk mund ta kishte ditur që shtatzania e saj e ardhshme, sipas rastit, do të rezultonte në komplikacione të cilat do të kërkonin që asaj t'i jepej pushim me raport mjekësor për një periudhë të zgjatur kohe;

- Gjatë shqyrtimit të çështjes së kërkueses, autoritetet nuk kishin arritur të jepnin ndonjë shpjegim se si ajo mund të kishte lidhur me vetëdije një kontratë pune mashtruese, pa e ditur nëse do të mbetej me të vërtetë shtatzënë, veçanërisht duke pasur parasysh se nuk kishte qenë nën ndonjë detyrim ligjor për të raportuar faktin që ajo i ishte nënshtruar procedurës IVF-ë ose se mund të ishte shtatzanë gjatë lidhjes së kontratës. Ligji i brendshëm e ndalon punëdhënësin të kërkojë çdo informacion në lidhje me shtatzëninë e një gruaje. Në të vërtetë, pyetja e një gruaje për shtatzëninë e saj të mundshme ose planifikimi i saj, ose detyrimi i saj për të raportuar një fakt të tillë në momentin e rekrutimit, gjithashtu do të ishte një diskriminim i drejtpërdrejtë në bazë të seksit;

- Autoritetet kishin e arritur përfundimin e tyre në rastin e kërkueses pa vlerësuar nëse ajo kishte marrë faktikisht detyrat e saj përsipër dhe nëse

kishte filluar të kryente detyrat e saj të punës për punëdhënësin; as nuk kishin kërkuar të vërtetonin nëse procedura IVF-ë që ajo kishte kryer e kishte bërë të nevojshme mungesën e saj nga puna për arsye shëndetësore. Gjithashtu nuk kishte asnjë fakt që tregonte se gratë që nënshtroheshin procedurës IVF-ë në përgjithësi nuk do të ishin në gjendje të punonin gjatë trajtimit të tyre të fertilitetit ose shtatzënisë;

- Së fundi, Gjykata shprehu shqetësimin për ngjyrimet e përfundimit të autoriteteve të brendshme, të cilat kishin lënë të kuptohej se gratë nuk duhet të punojnë ose të kërkojnë punë gjatë shtatzënisë ose eventualitetit të saj. Stereotipizimi gjinor të atij lloji përbën një pengesë serioze për arritjen e barazisë reale lëndore gjinore, e cila ishte një nga qëllimet kryesore të Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës. Konsiderata të tilla jo vetëm që ishin konstatuar se shkelnin ligjin e brendshëm, por gjithashtu ishin në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të barazisë gjinore.

(c) Në përgjithësi

Refuzimi për të punësuar ose njohur një përfitim të lidhur me punësimin e një gruaje shtatzënë për shkak të shtatzënisë së saj përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të seksit, i cili nuk mund të justifikohet nga interesat financiare të Shtetit. Gjykata gjithashtu vuri në dukje një qasje të ngjashme në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian dhe në standardet e tjera përkatëse ndërkombëtare. Prandaj, diferenca në trajtimin të cilit i ishte nënshtuar kërkuesja, si grua që kishte mbetur shtatzënë përmes IVF-së, nuk ishte justifikuar objektivisht apo e nevojshme.

Përfundim: shkelje (njëzëri)

Neni 41: 15,000 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu *Napotnik kundër Rumanisë*, 33139/13, 20 tetor 2020, [Përmbledhje Ligjore](#))

Neni 8

Neni 8-1, Respektimi i jetës private

Gjobë ndaj prindërve dhe përjashtim i fëmijëve nga parashkollori për shkak të refuzimit të përmbushjes së detyrës së vaksinimit të fëmijëve sipas ligjit: nuk ka shkelje

Vavrička dhe të Tjerë kundër Republikës Çeke [DHM] – 47621/15, 3867/15, 73094/15 et al., Vendimi i datës 8.4.2021 [DHM]

Fakte – Kjo çështje e cila e ka origjinën në gjashtë kërkesa, ka të bëjë me detyrimin ligjor për të vaksinuar fëmijët kundër sëmundjeve të njohura mirë nga shkencat mjekësore dhe pasojat për kërkuesit për shkak të mos përmbyshjes së tij. Kërkesa e parë u paraqit nga një prind në emër të tij, duke u ankuar për faktin se ai ishte gjobitur për mos vaksinimin e duhur të fëmijëve të moshës shkollë. Kërkesat e tjera u paraqitën nga prindërit në emër të fëmijëve të tyre nën moshë pasi atyre nuk u ishte dhënë leja për t'i regjistruar në kopshte ose çerdhe.

Ligji – Neni 8: Sipas praktikës gjyqësore të vendosur nga Gjykata, vaksinimi i detyrueshëm, si një ndërhyrje mjekësore e pavullnetshme, ishte një ndërhyrje në të drejtën e respektimit të jetës private. Edhe pse asnjë nga vaksinimet e kontestuara nuk ishte kryer, detyrimi i vaksinimit dhe pasojat e drejtpërdrejta të mosrespektimit të tij gjithashtu përbënin një ndërhyrje të tillë. Ndërhyrja kishte qenë e ligjshme dhe ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes së shëndetit dhe të drejtave të të tjerëve. Në vlerësimin nëse ndërhyrja në të drejtat e kërkuesve kishte qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike, Gjykata shqyrtoi faktorët e mëposhtëm:

(a) *Marzhi i vlerësimit të Shtetit* – U konstatua se ishte i gjerë për shkaqet e mëposhtme:

- asnjë vaksinim nuk ishte administruar kundër vullnetit të kërkuesve, as nuk mund të ishte, pasi pajtueshmëria nuk mund të imponohej me forcë sipas ligjit përkatës të brendshëm.

- ekzistonte një konsensus i përgjithshëm midis Palëve Kontraktuese, i mbështetur fuqimisht nga organet e specializuara ndërkombëtare, se vaksinimi ishte një nga ndërhyrjet shëndetësore më të suksesshme dhe me kosto efektive dhe se çdo shtet duhet të synonte arritjen e nivelit më të lartë të mundshëm të vaksinimit.

- megjithatë, nuk kishte konsensus mbi një model të vetëm të vaksinimit të fëmijëve, por një gamë politikash, duke filluar nga ato të bazuara tërësisht në rekomandime, vazhduar me ato që e bënë të detyrueshëm një ose më shumë vaksinime, deri tek ato që e bënë sigurimin e vaksinimit të plotë të fëmijëve detyrim ligjor. Qasja më rregulluese e Republikës Çeke ishte ndarë

nga tre nga Qeveritë ndërhyrëse dhe ishte ndjekur kohët e fundit nga disa Shtete të tjera Anëtare për shkak të një rënie të vaksinimit vullnetar dhe një rënie që rezultoi në imunitetin e tufës.

- natyra e ndjeshme e detyrimit të vaksinimit në fëmijëri nuk ishte e kufizuar në këndvështrimin e atyre që nuk ishin dakord me këtë detyrë, por gjithashtu përfshinte vlerën e solidaritetit social, qëllimi i detyrimit ishte të mbronte shëndetin e të gjithë anëtarëve të shoqërisë, veçanërisht atyre që ishin veçanërisht të prekshëm në lidhje me sëmundje të caktuara dhe në emër të të cilëve pjesës tjetër të popullsisë iu kërkua të merrte një rrezik minimal në formën e vaksinimit.

- siç u tha më herët, çështjet e politikave të kujdesit shëndetësor përfshiheshin në marzhin e vlerësimit të autoriteteve të brendshme të cilët ishin më në gjendje për të vlerësuar përparësitë dhe nevojat sociale.

Çështja që do të përcaktohej nuk ishte nëse mund të ishte miratuar një politikë e ndryshme, më pak urdhëruese, si në disa Shtete të tjera Europiane. Përkundrazi, në gjetjen e balancës së posaçme që ata kishin arritur, autoritetet çeke kishin mbetur brenda kufirit të tyre të gjerë të vlerësimit në këtë fushë.

(b) Nevoja sociale e ngutshme dhe arsyet përkatëse dhe të mjaftueshme – Një qasje e detyrueshme ndaj vaksinimit përfaqësonte reagimin e autoriteteve ndaj nevojës urgjente sociale për të mbrojtur shëndetin individual dhe publik nga sëmundjet në fjalë dhe për tu mbrojtur nga çdo prirje rënëse e shkallës së vaksinimit të fëmijëve. Ajo ishte mbështetur në arsye të rëndësishme dhe të mjaftueshme. Përveç arsyes së rëndësishme të shëndetit publik, konsensusit të përgjithshëm midis Shteteve dhe të dhënave përkatëse të ekspertëve, Gjykata gjithashtu kishte parasysh çështjen e interesit më të lartë të fëmijëve. Sipas praktikës së mirë-vendosur të Gjykatës, në të gjitha vendimet në lidhje me fëmijët interesi i tyre më i lartë ishte i një rëndësie përcaktuese; kjo pasqyronte konsensusin e gjerë të shprehur veçanërisht në Nenin 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve. Nga kjo rezultoi se kishte një detyrim ndaj Shteteve që të vendosnin interesin më të lartë të fëmijës, dhe gjithashtu ato të fëmijëve si grup, në qendër të të gjitha vendimeve që ndikojnë në shëndetin dhe zhvillimin e tyre. Kur vjen fjala për imunizimin, objektivi duhet të jetë që çdo fëmijë të mbrohet nga sëmundjet e rënda; kjo u arrit, në shumicën e madhe të rasteve, nga fëmijët që morën gamën

e plotë të vaksinimeve gjatë viteve të tyre të hershme. Ata, të cilëve një trajtim i tillë nuk mund tu jepej, ishin të mbrojtur në mënyrë indirekte nga sëmundjet ngjitëse për sa kohë që niveli i kërkuar i mbulimit të vaksinimit mbahej në komunitetin e tyre, d.m.th., mbrojtja e tyre vinte nga imuniteti i tufës. Kështu, kur një politikë e vaksinimit vullnetar nuk konsiderohej e mjaftueshme për të arritur dhe ruajtur imunitetin e tufës, ose një imunitet i tillë nuk ishte i vlefshëm për shkak të natyrës së sëmundjes, një politikë e detyrueshme e vaksinimit mund të futet në mënyrë të arsyeshme për të arritur një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje nga sëmundje të rënda. Bazuar në konsiderata të tilla, politika shëndetësore e Shtetit të paditur ishte në përputhje me interesin më të lartë të fëmijëve.

(c) *Proporcionaliteti* – Në radhë të parë, Gjykata shqyrtoi tiparet përkatëse të sistemit të brendshëm:

- detyrimi i vaksinimit kishte të bënte me dhjetë sëmundje ndaj të cilave vaksinimi u konsiderua efektiv dhe i sigurt nga komuniteti shkencor.

- megjithëse e detyrueshme, detyrimi i vaksinimit nuk ishte absolut dhe lejoi përjashtime, në bazë të një kundër-indikacioni të përhershëm ose në bazë të ndërgjegjes. Në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, rrethanat e secilit rast konkret duhej të vlerësoheshin në mënyrë rigoroze. Megjithatë, asnjë nga kërkuesit nuk ishte mbështetur në ndonjë përjashtim.

- përmbushja e detyrimit të vaksinimit nuk mund të vendoset drejtpërdrejt, por, si me masat e ndërmarra në Shtetet ndërhyrëse, detyrimi u zbatua në mënyrë indirekte përmes aplikimit të sanksioneve. Në Republikën Çeke, sanksioni ishte relativisht i moderuar, i përbërë nga një gjobë administrative e njëhershme. Në rastin e kërkuesit të parë, shumica ishte afër nivelit minimal përkatës dhe nuk mund të konsiderohej si tepër e ashpër ose e rëndë. Sa i përket kërkuesve fëmijë, mospranimi i tyre në parashkollor synonte të mbronte shëndetin e fëmijëve të vegjël dhe kështu ishte në thelb i një natyre mbrojtëse dhe jo ndëshkuese.

- garancitë procedurale ishin parashikuar në ligjin e brendshëm dhe kërkuesit kishin qenë në gjendje të përdornin mjetet juridike administrative dhe gjyqësore.

- qasja legislative e zbatuar bëri të mundur që autoritetet të reagojnë me fleksibilitet ndaj situatës epidemiologjike dhe ndaj zhvillimeve në shkencën mjekësore dhe farmakologji.

- asnjë problem nuk ishte vënë në dukje në lidhje me integritetin e procesit të hartimit të politikave ose transparencën e sistemit të brendshëm.

- në lidhje me sigurinë, duke pranuar një rrezik shumë të rrallë, por padyshim shumë serioz për shëndetin e një individi, Gjykata përsëriti rëndësinë e masave paraprake të nevojshme para vaksinimit, përfshirë monitorimin e sigurisë së vaksinave në përdorim dhe kontrollimin e kundër-indikacioneve të mundshme në çdo rast konkret. Në secilin nga këto aspekte, nuk kishte asnjë arsye për të vënë në dyshim përshtatshmërinë e sistemit të brendshëm. Për më tepër, u lejua një hapësirë në lidhje me zgjedhjen e vaksinës dhe orarin e vaksinimit.

- megjithëse si një propozim i përgjithshëm, disponibiliteti i kompensimit në rast të dëmtimit të shëndetit të shkaktuar nga vaksinimi ishte i rëndësishëm për vlerësimin e përgjithshëm të një sistemi të vaksinimit të detyrueshëm, kësaj çështjeje nuk mund t'i jepet ndonjë rëndësi vendimtare në kontekstin e këtyre kërkesave, pasi asnjë vaksinë nuk ishte administruar. Për më tepër, kërkuesit nuk e kishin ngritur këtë çështje në procedimet e brendshme dhe për shumicën e tyre, faktet kishin ndodhur në një kohë kur kompensimi ishte i disponueshëm sipas ligjit të brendshëm.

Së dyti, Gjykata vazhdoi të merrte parasysh intensitetin e ndërhyrjes së kundërshtuar në gëzimin e të drejtës së kërkuesve për respektimin e jetës private:

- përsa i përket kërkuesit të parë, gjoba administrative e vendosur ndaj tij nuk kishte qenë e tepërt në rrethanat përkatëse dhe nuk kishte pasur pasoja në arsimimin e fëmijëve të tij.

- sa u përket kërkuesve të tjerë, përjashtimi i tyre nga parashkollori nënkuptonte humbjen e një mundësie të rëndësishme për të zhvilluar personalitetet e tyre dhe për të filluar përfitim të aftësive shoqërore dhe të nxënimit në një mjedis formues dhe pedagogjik. Sidoqoftë, kjo kishte qenë pasojë e drejtpërdrejtë e zgjedhjes së prindërve të tyre për të mos respektuar detyrimin e vaksinimit, qëllimi i të cilit ishte të mbronin shëndetin, veçanërisht në atë grupmoshë. Për më tepër, mundësia e

ndjekjes së parashkollorit nga fëmijët që nuk mund të vaksinoheshin për arsye mjekësore varej nga një shkallë shumë e lartë e vaksinimit tek fëmijët e tjerë kundër sëmundjeve ngjitëse. Prandaj nuk mund të konsiderohet si joproportionale për një Shtet që të kërkojë nga ata për të cilët vaksinimi përfaqësonte një rrezik të pakët shëndetësor të pranonin këtë masë mbrojtëse të praktikuar në mënyrë universale, si një detyrim ligjor dhe në emër të solidaritetit shoqëror, për hir të numrit të vogël të fëmijëve të pamundur, të cilët nuk ishin në gjendje të përfitonin nga vaksinimi. Kështu, i takonte në mënyrë të vlefshme dhe legjitime legjislativit çek të bënte këtë zgjedhje, e cila ishte plotësisht në përputhje me arsyetimin e mbrojtjes së shëndetit të popullatës. Disponibiliteti teorik i mjeteve më pak ndërhyrës për të arritur këtë qëllim, siç sugjerohet nga kërkuesit, nuk e zbeh këtë gjetje. Për më tepër, kërkuesit nuk ishin privuar nga të gjitha mundësitë e zhvillimit personal, social dhe intelektual, edhe nëse me përpjekje dhe shpenzime shtesë nga ana e prindërve të tyre, dhe pasojat ishin të kufizuara në kohë pasi pranimi i tyre i mëvonshëm në shkollën fillore nuk ishte prekur nga statusi i tyre i vaksinimit.

Si përfundim, masat e ankimuar nga kërkuesit, të vlerësuara në kontekstin e sistemit të brendshëm, qëndronin në një lidhje të arsyeshme të proporcionalitetit me synimet legjitime të ndjekura nga Shteti i paditur, i cili nuk e kishte tejkaluar marzhin e tij të vlerësimit, nëpërmjet detyrimit për vaksinim. Prandaj, ato mund të konsiderohen si “të nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Përfundim: nuk ka shkelje (gjashtëmbëdhjetë vota me një).

Gjykata gjithashtu, me shumicë, e shpalli të papranueshme ankesën e kërkuesve sipas Nenit 9 si *ratione materiae* të papajtueshme me këtë dispozitë. Në veçanti, ata nuk kishin vërtetuar se opinioni i tyre kritik mbi vaksinimin ishte i një besueshmërie, serioziteti, kohezioni dhe rëndësie të mjaftueshme në mënyrë që të përbënte një bindje ose besim që përfitonte garancitë e Nenit 9.

(Shih gjithashtu *Baytüre dhe të Tjerë kundër Turqisë* (dec.), 3270/09, 12 mars 2013, [Përmbledhje Ligjore](#); *Hristozov dhe të Tjerë kundër Bullgarisë*, 47039/11 dhe 358/12, 13 nëntor 2012, [Përmbledhje Ligjore](#); *Solomakhin kundër Ukrainës*, 24429/03, 15 mars 2012; *Boffa dhe të Tjerë kundër San Marinos*, 26536/95, Vendim i Komisionit i datës 15 janar 1998; *Shoqata e*

Prindërve kundër Mbretërisë së Bashkuar, 7154/75, Vendim i Komisionit i datës 12 korrik 1978)

Neni 5

Neni 5-1, Heqja e lirisë

Ndalim garkullimi i përgjithshëm 52-ditor i vendosur nga autoritetet për të trajtuar pandeminë COVID-19: Neni 5 i pazbatueshëm; i papranueshëm

Terheç kundër Romanisë (dec.)- 49933/20 Vendimi i datës 13.4.2021 (Seksioni IV)

Fakte – Më 11 Mars 2020 Organizata Botërore e Shëndetësisë deklaroi se bota po përballlej me një pandemi të shkaktuar nga COVID-19.

Prandaj, më 16 mars 2020 Presidenti rumun vendosi një gjendje të jashtëzakonshme që përfshin kufizime në lirinë e lëvizjes. Nuk lejohej asnjë lëvizje jashtë shtetësisë, përveç në një numër të caktuar rrethanash të listuara në mënyrë shteruese dhe me paraqitjen e një dokumenti që dëshmon arsye të vlefshme për largimin nga shtëpia. Personat që shkelnin rregullat mund të gjobiteshin.

Gjendja e jashtëzakonshme përfundoi më 14 maj 2020 në mesnatë.

Ligji – Neni 5 § 1: Kërkuesi, në procedimin para Gjykatës, nuk u mbështet në Nenin 2 të Protokollit Nr. 4, duke kërkuar në vend të kësaj të demonstrojë se shtetrrëthimi i përgjithshëm përbënte një privim të lirisë dhe jo thjesht një kufizim të së drejtës për lirinë e lëvizjes.

Masa për të cilën u ankua ishte vendosur në një gjendje të jashtëzakonshme, me qëllim izolimin dhe ngujimin e të gjithë popullsisë për shkak të një situatë të shëndetit publik, të cilën autoritetet kompetente të brendshme e kishin konsideruar si serioze dhe urgjente. Sipas ligjit rumun, gjendja e jashtëzakonshme ishte një regjim i posaçëm juridik i cili mundësonte marrjen e një sërë masash të jashtëzakonshme duke devijuar nga rendi kushtetues i vendosur. Ajo shpallej në rast rreziku të afërt ose faktik, për një periudhë të caktuar, dhe i lejonte Shtetit të merrte masa që kufizonin ushtrimin e disa lirive themelore. Presidenti rumun kishte shpallur gjendjen e jashtëzakonshme pas konsultimit me organet kompetente dhe për shkak të “kontekstit të jashtëzakonshëm dhe të paparashikueshëm” të krijuar nga

zhvillimi i situatës ndërkombëtare në lidhje me epideminë: koronavirusi SARS-CoV-2 po përhapej në të gjithë botën dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë e kishte shpallur zyrtarisht atë si një pandemi. Nëse autoritetet nuk do të kishin marrë masa të jashtëzakonshme si një çështje urgjente për të frenuar përhapjen e virusit në popullatë, mungesa e veprimit të tyre do të kishte pasojë shumë serioze, kryesisht në të drejtën e jetës dhe, së dyti, në të drejtën e shëndetit. Prandaj, prezantimi gradual nga shteti rumun i masave emergjente, duke përfshirë shtetrrëthimin, kishte për qëllim zbutjen e ndikimit ekonomik dhe social të epidemisë dhe mbrojtjen e së drejtës së jetës.

Sipas mendimit të Gjykatës, pandemia COVID-19 mund të kishte pasojë shumë serioze jo vetëm për shëndetin, por edhe për shoqërinë, ekonominë, funksionimin e shtetit dhe jetën në përgjithësi, dhe për këtë arsye situata duhet të karakterizohet si një kontekst i jashtëzakonshëm dhe i paparashikueshëm”.

Masa e kundërshtuar kishte mbetur në fuqi për pesëdhjetë e dy ditë. Ishte një masë e përgjithshme e imponuar mbi të gjithë popullsinë përmes legjislacionit të miratuar nga autoritetet e ndryshme në Rumani. Si rezultat i zbatimit të masës, kërkuesi ishte i detyruar të qëndronte në shtëpi, duke u lejuar të dilte vetëm për një nga arsyet e parashikuara shprehimisht në legjislacion, dhe me formularin përkatës të përjashtimit.

Kështu, kërkuesi kishte qenë i lirë të largohej nga shtëpia e tij për arsye të ndryshme dhe mund të shkonte në vende të ndryshme, në çdo kohë të ditës që e kërkonte situata. Ai nuk i ishte nënshtruar mbikëqyrjes individuale nga autoritetet dhe nuk pretendoi se ishte detyruar të jetonte në një hapësirë të ngushtë, as nuk ishte privuar nga të gjitha kontaktet shoqërore. Për pasojë, duke pasur parasysh shkallën e intensitetit të saj, masa në fjalë nuk mund të barazohet me arrest shtëpie.

Për më tepër, kërkuesi nuk kishte shpjeguar në terma konkretë se si kishte ndikuar masa tek ai. Ai nuk pretendoi se rrethanat e tij nuk mbulohehin nga asnjë prej arsyeve të daljes nga shtëpia të parashikuara nga legjislacioni dhe se ai ishte ngujuar brenda për gjithë kohëzgjatjen e gjendjes së jashtëzakonshme. Në përgjithësi, ai nuk kishte dhënë ndonjë informacion specifik që përshkruante përvojën e tij personale të shtetrrëthimit.

Duke pasur parasysh të gjitha këto konsiderata, niveli i intensitetit të kufizimeve në lirinë e lëvizjes së kërkuesit nuk kishte qenë i tillë që bllokimi i përgjithshëm i urdhëruar nga autoritetet të konsiderohej si një heqje lirie. Në përputhje me rrethanat, nuk mund të thuhet se kërkuesit i ishte hequr liria sipas kuptimit të Nenit 5 § 1.

Së fundmi, Rumania kishte shpallur synimin e saj për të devijuar sipas Nenit 15 të Konventës nga detyrimet që rrjedhin nga Neni 2 i Protokollit Nr 4 që garantojnë lirinë e lëvizjes, një e drejtë të cilën kërkuesi nuk e kishte ngritur para Gjykatës. Në çdo rast, duke qenë se Neni 5 § 1 nuk ishte i zbatueshëm në rastin konkret, nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej vlefshmëria e shmangies të njoftuar Këshillit të Evropës nga Rumania.

Neni 8

Neni 8-1, Respektimi i jetës private

Pajtueshmëria e regjimit të vëzhgimit sekret me Konventën, duke përfshirë përgjimin në masë të komunikimeve dhe shkëmbimin e informacioneve sekrete: *shkelje*

[Kjo përmbledhje mbulon gjithashtu edhe vendimin në çështjen Big Brother Watch dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 58170/13, 25 maj 2021]

Qendra för rättvisa kundär Suedisä [DHM] – 35252/08, Vendimi i datës 25.5.2021 [DHM]

Fakte – Në *Big Brother Watch and Others*, kërkuesit, persona juridikë dhe fizikë, u ankuan për objektin dhe shtrirjen e programeve të mbikëqyrjes elektronike të operuara nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Në një vendim të datës 13 shtator 2018 (shih [Shënimin Informativ 221](#)), Dhoma konstatoi se regjimi i përgjimit në masë sipas Nenit 8 (4) të Aktit për Rregullimin e Kompetencave Hetimore (ARKH) dhe regjimi për marrjen e të dhënave nga ofruesit e shërbimeve të komunikimit sipas Kapitullit II të ARKH-së kishin shkelur Nenet 8 dhe 10. Ajo nuk gjeti shkelje të Nenit 8 në lidhje me regjimin e shkëmbimit të informacioneve sekrete.

Në *Centrum För Rättvisa*, kërkuesi, një organizatë joqeveritare, konsideron se ekziston rreziku që komunikimet e saj përmes telefonave celularë dhe brezit të gjerë celular të jenë përgjuar ose do të përgjohen dhe shqyrtohen nga

vëzhgimi i fshehtë i sinjaleve. Në Suedi, Institucioni i Mbrojtjes Kombëtare i Radios (“FRA”) është i autorizuar të kryejë vëzhgim të fshehtë sinjalesh përmes përgjimit në masë të komunikimeve. Në një vendim të datës 19 qershor 2018 (shih [Shënimin Informativ 219](#)), një Dhomë e Gjykatës, unanimisht, nuk gjeti shkelje të Neni 8.

Çështjet iu referuan Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuësve.

Ligji – Përgjimi në masë i komunikimeve

Neni 8: (i) Ndërrhyrje: Neni 8 zbatohet në secilën fazë të procesit të përgjimit në masë dhe shkalla e ndërhyrjes në të drejtat e privatësisë u rrit ndërsa procesi kaloi nëpër faza të ndryshme, veçanërisht: 1) përgjimi dhe ruajtja fillestare e komunikimeve dhe të dhënave të lidhura me komunikimet; 2) aplikimi i përzgjedhësve të veçantë për komunikimet e ruajtura/të dhënat e lidhura me komunikimin; 3) ekzaminimi i komunikimeve të zgjedhura/të dhënave të lidhura me komunikimin nga analistët; dhe 4) mbajtja pasuese e të dhënave dhe përdorimi i “produktit përfundimtar”, përfshirë ndarjen e të dhënave me palët e treta.

(ii) Nëse ka pasur nevojë për të zhvilluar praktikën gjyqësore

Në *Weber dhe Saravia* dhe *Liberty and Others*, Gjykata kishte zbatuar masat mbrojtëse minimale të zhvilluara në praktikën e saj gjyqësore mbi përgjimin e synuar. Megjithatë, parë në dritën e zhvillimeve teknologjike të ndërhyrjeve, shtrirja e veprimtarisë së mbikëqyrjes e marrë në konsideratë në këto raste do të kishte qenë shumë më e ngushtë. Më e rëndësishmja, Gjykata nuk e kishte trajtuar shprehimisht faktin se përgjimi me objekt dhe përgjimi në masë ishin të ndryshëm në një numër aspektesh të rëndësishme. Ndryshe nga përgjimi me objekt, përgjimi në masë në përgjithësi ishte drejtuar në komunikimet ndërkombëtare dhe u përdorej kryesisht për mbledhjen e informacioneve sekrete të huaja dhe identifikimin e kërcënimeve të reja nga aktorë të njohur dhe të panjohur. Kur viheshin “në shënjestër” individë të specifikuar, pajisjet e tyre nuk monitoroheshin; përkundrazi, përzgjedhës të fortë aplikoheshin në komunikimet e përgjuara në masë nga shërbimet e fshehta.

(iii) Testi që aplikohet në regjimet e përgjimit në masë

Ndërsa garancitë e identifikuara tashmë nga Gjykata në fushën e regjimeve të përgjimit me objekt siguronin një kuadër të dobishëm, ato duhej të përshtateshin për të pasqyruar tiparet specifike të një regjimi të përgjimit në

masë, qëllimi i të cilit ishte në parim parandalues, më tepër se për hetimin të një objekti të caktuar ose të një veprë penale të identifikueshme. Për shembull, kërkesa për të përcaktuar qartë në të drejtën e brendshme kategoritë e njerëzve të cilëve mund tu përgjohen komunikimet dhe natyra e veprave penale që mund të shkaktojnë një urdhër të tillë nuk ishte po ashtu e zbatueshme në një regjim të përgjimit në masë; as kërkesa e “dyshimit të arsyeshëm”. Sidoqoftë, ishte e domosdoshme që ligji i brendshëm të përcaktonte me qartësi dhe hollësi të mjaftueshme shkaqet për të cilat përgjimi në masë mund të autorizohet dhe rrethanat në të cilat komunikimet e një individi mund të përgjoheshin. Për më tepër, në kontekstin e përgjimit në masë, rëndësia e mbikëqyrjes dhe rishikimit do të përforcohej, për shkak të rrezikut të qenësishëm të abuzimit dhe nevojës legjitime për fshehtësi. Gjithashtu duheshin marrë parasysh shkallët në rritje të ndërhyrjes në të drejtat e Nenit 8 të individëve ndërsa operacioni i përgjimit në masë kalonte nëpër fazat e identifikuar, që do të thoshte se nevoja për garanci do të ishte më e larta në fund të procesit, ku informacioni për një person të veçantë do të analizohej ose përmbajtja e komunikimeve do të shqyrtohej nga një analist. Prandaj, procesi duhej t’u nënshtrohej “garancive nga fillimi në fund”, që do të thotë se, në nivel të brendshëm, duhej bërë një vlerësim në secilën fazë të procesit të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të masave të marra; se përgjimi në masë duhej t’i nënshtrohej një autorizimi të pavarur në fillim, kur ishin duke u përcaktuar objekti dhe fusha e operacionit; dhe se operacioni duhej t’i nënshtrohej mbikëqyrjes dhe rishikimit të pavarur *ex post facto*. Këto ishin garancitë themelore të cilat do të ishin themeli i çdo ankese sipas Nenit 8 për regjimin e përgjimit në masë.

Gjykata nuk u bind se përftimi i të dhënave mbi komunikimet përkatëse përmes përgjimit në masë ishte domosdoshmërisht më pak ndërhyrës sesa përftimi i përmbajtjes. Prandaj, përgjimi, ruajtja dhe kërkimi i komunikimeve përkatëse duhej të analizoheshin duke iu referuar të njëjtave masa mbrojtëse si ato të zbatueshme për përmbajtjen.

Gjatë kryerjes së një vlerësimi global të funksionimit të regjimit, Gjykata do të fokusohet kryesisht në faktin nëse kuadri ligjor i brendshëm përmbante garanci të mjaftueshme kundër abuzimit dhe nëse procesi u nënshtrohej “garancive nga fillimi në fund”. Duke vepruar kështu, ajo do të kishte parasysh funksionimin aktual të sistemit të përgjimit, duke përfshirë kontrollet dhe balancat mbi ushtrimin e pushtetit, dhe ekzistencën ose mungesën e ndonjë

dëshmie të abuzimit faktik. Në vlerësimin nëse Shteti i paditur kishte vepruar brenda marzhit të tij më të ngushtë të vlerësimit, Gjykata duhej të merrte parasysh një gamë më të gjerë kriteresh sesa gjashtë garancitë *Weber*. Duke trajtuar bashkarisht “në përputhje me ligjin” dhe “domosdoshmërinë”, Gjykata do të shqyrtonte nëse kuadri ligjor i brendshëm përcakton qartë:

1. Arsyet mbi të cilat mund të autorizohet përgjimi në masë;

Në parim, sa më të gjera të ishin shkaqet, aq më e madhe ishte mundësia për abuzim. Sidoqoftë, shkaqet më të ngushta dhe/ose të përcaktuara më ngushtë do të siguronin vetëm një garanci efektive kundër abuzimit, nëse do të kishte garanci të tjera për të siguruar që përgjimi në masë të ishte autorizuar vetëm për një shkak të lejuar dhe se ishte i nevojshëm dhe proporcional për atë qëllim. Çështja e lidhur ngushtë nëse ekzistonin garanci të mjaftueshme për të siguruar që përgjimi ishte i nevojshëm ose i justifikuar ishte, pra, aq e rëndësishme sa shkalla e saktësisë me të cilën ishin përcaktuar shkaqet për të cilat mund të ishte dhënë autorizimi. Rrjedhimisht, sipas pikëpamjes së Gjykatës, një regjim që lejonte caktimin e përgjimit në masë bazuar në shkaqe relativisht të gjera mund të ishte në përputhje me Nenin 8 të Konventës, me kusht që, kur shihej në tërësi, në sistem të ishin krijuar garanci të mjaftueshme kundër abuzimit për ta kompensuar atë dobësi.

2. Rrethanat në të cilat komunikimet e një individi mund të përgjohen;

3. Procedura që duhet ndjekur për dhënien e autorizimit;

Përgjimi në masë duhej të autorizohet nga një organ i pavarur nga ekzekutivi, edhe pse jo domosdoshmërisht një gjyqësor. Ai organ duhej të ishte i informuar si për qëllimin e përgjimit ashtu edhe për operatorët ose rrugët e komunikimit që pritej të përgjoheshin. Kjo do t'u mundësonte atyre të vlerësonin domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e operacionit të përgjimit në masë dhe përzgjedhjen e operatorëve.

Përdorimi i përzgjedhësve – dhe veçanërisht përzgjedhësve të fortë – ishte një nga hapat më të rëndësishëm në procesin e përgjimit në masë, pasi kjo ishte pika në të cilën komunikimet e një individi të caktuar mund të synoheshin nga shërbimet e shërbimeve të fshehta. Gjykata pranoi që përfshirja e të gjithë përzgjedhësve në autorizim mund të mos jetë e realizueshme në praktikë. Sidoqoftë, autorizimi duhej të identifikonte të

paktën llojet ose kategoritë e përzgjedhësve që do të përdreshin. Për më tepër, duhej të ekzistonte garanci të shtuara kur aplikoheshin përzgjedhës të fortë të lidhur me individë të identifikueshëm nga shërbimet e shërbimeve të fshehta. Përdorimi i çdo përzgjedhësi të tillë duhej të justifikohet – në lidhje me parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit – nga shërbimet e shërbimeve të fshehta dhe ky justifikim duhej të regjistrohej në mënyrë të saktë dhe t’i nënshtrohej një procesi të autorizimit të brendshëm paraparak që siguronte verifikim të veçantë dhe objektiv.

4. Procedurat që duhen ndjekur për përzgjedhjen, shqyrtimin dhe përdorimin e materialit të përgjuar;

5. Masat paraprake që duhen marrë kur u komunikohet materiali palëve të tjera;

Transmetimi nga një Shtet Kontraktues Shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare i materialit të marrë me përgjim në masë duhej të kufizohej në materialin e mbledhur dhe ruajtur në përputhje me Konventën dhe duhej t’u nënshtrohej disa garancive specifike shtesë që lidheshin me vetë transferimin: 1) rrethanat në të cilat mund të bëhej një transferim i tillë duhej të përcaktoheshin qartë në ligjin e brendshëm; 2) Shteti transferues duhej të siguronte që Shteti pritës, në trajtimin e të dhënave, të kishte garanci të përshtatshme për të parandaluar abuzimin dhe ndërhyrjen joproporcionale (në veçanti, garantimin e ruajtjes së sigurt dhe kufizimin e deklarimit të mëtejshëm të materialit). Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që Shteti pritës duhej të kishte mbrojtje të krahasueshme me atë të Shtetit transferues, as nuk kërkonte domosdoshmërisht që të jepej një garanci para çdo transferimi; 3) garancitë më të larta do të ishin të nevojshme kur ishte e qartë se ishte duke u transferuar një material që kërkonte konfidencialitet të veçantë – siç është materiali konfidencial gazetaresk; dhe 4) transferimi i materialit tek partnerët e huaj të shërbimeve të fshehta gjithashtu duhej t’i nënshtrohej një kontrolli të pavarur.

6. Kufizimet në kohëzgjatjen e përgjimit, ruajtjen e materialit të përgjuar dhe rrethanat në të cilat ky material duhet të fshihet dhe asgjësohet;

Në *Centrum För Rättvisa*, ndërsa duhej të kishte një justifikim të qartë për kërkesa të veçanta në lidhje me asgjësimin e materialit që përmbante të dhëna personale, gjithashtu duhej të ekzistonte një rregull i përgjithshëm ligjor që rregullonte asgjësimin e materialeve të tjera të marra përmes

përgjimit në masë të komunikimit, ku ruajtja e tij mund të cenonte, për shembull, në të drejtën e respektimit të korrespondencës sipas Nenit 8, përfshirë personat juridikë. Si minimum, duhej të ekzistonte një kërkesë ligjore për të fshirë të dhënat e përgjuara që kishin humbur rëndësinë për qëllime të vëzhgimit të fshehtë të sinjaleve.

7. Procedurat dhe modalitetet për mbikëqyrjen nga një autoritet i pavarur i pajtueshmërisë me garancitë e mësipërme dhe kompetencat e tij për të adresuar mospërputhjen;

Çdo fazë e procesit të përgjimit në masë duhej t'i nënshtrohej gjithashtu një mbikëqyrjeje mjaft të fortë nga një autoritet i pavarur në gjendje për të vlerësuar domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e veprimit që po ndërmerret, duke pasur parasysh nivelin e dhur të ndërhyrjes në të drejtat e parashikuara në Konventë të personave që mund të preken. Për të lehtësuar këtë mbikëqyrje, shërbimet e fshehta duhej të mbanin shënime të hollësishme në secilën fazë të procesit.

8. Procedurat për rishikimin e pavarur *ex post facto* të kësaj pajtueshmërie dhe kompetencat që i janë dhënë organit kompetent në adresimin e rasteve të mospërputhjes.

Një mjet efektiv duhej të ishte në dispozicion për këdo që dyshonte se komunikimet e tij ose të saj ishin përgjuar nga shërbimet e fshehta, ose për të kundërshtuar ligjshmërinë e përgjimit të dyshuar ose pajtueshmërinë e regjimit e përgjimit me Konventën. Ashtu si me regjimet e përgjimit me objekt, një mjet mbrojtjeje i cili nuk varej nga njoftimi i subjektit të përgjimit mund të ishte gjithashtu një mjet efektiv në kontekstin e përgjimit në masë. Në mungesë të një kërkesë për njoftim, ishte e domosdoshme që mjete juridik të ishte para një organi i cili, edhe pse jo domosdoshmërisht gjyqësor, ishte i pavarur nga ekzekutivi dhe siguronte drejtësinë e procedurave, duke ofruar, aq sa të jetë mundur, një proces akuzator. Vendimet e një autoriteti të tillë duhej të ishin të arsyetuara dhe ligjërisht detyruese.

(iii) Vlerësimi i çështjeve në fjalë

Centrum För Rättvisa v. Sweden

Sistemi suedez i përgjimit në masë bazohej në rregulla të hollësishme ligjore, ishte i kufizuar qartë në sferën e zbatimit dhe parashikonte garanci. Arsyet për të cilat përgjimi në masë mund të autorizohet ishin të kufizuara qartë,

rrethanat në të cilat komunikimet mund të përgjoheshin dhe shqyrtoheshin ishin përcaktuar me një qartësi të mjaftueshme, kohëzgjatja e tij rregullohej dhe kontrollohej ligjërisht dhe procedurat për përzgjedhjen, shqyrtimin dhe përdorimin e materialit të përgjuar shoqëroheshin me garanci të përshtatshme ndaj abuzimit. Të njëjtat masa mbrojtëse zbatoheshin njësoj për përmbajtjen e komunikimeve të përgjuara dhe të dhënave të komunikimit. Në mënyrë thelbësore, procedura gjyqësore e para-autorizimit dhe mbikëqyrja e ushtruar nga një organ i pavarur shërbente në parim për të siguruar zbatimin e kërkesave të brendshme ligjore dhe standardet e Konventës në praktikë dhe për të kufizuar rrezikun e pasojave joproporcionale që prekin të drejtat e Nenit 8. Veçanërisht, rëndësi duhej ti kushtohej faktit se në Suedi kufijtë që duhen respektuar në çdo mision përgjimi në masë, si dhe ligjshmëria dhe proporcionaliteti i tij në përgjithësi, ishin objekt i procedimit të para-autorizimit gjyqësor para Gjykatës së Informacioneve Sekrete të Huaja, e cila e zhvilloi seancën në praninë e një përfaqësuesi të mbrojtjes së privatësisë që mbron interesin publik.

Sidoqoftë, Gjykata vërejti tre mangësi në regjimin suedez të përgjimit në masë. Lidhur me të parën nga këto mangësi – mungesa e një rregulli të qartë për asgjësimin e materialit të përgjuar i cili nuk përmbante të dhëna personale – potenciali i tij për të shkaktuar pasoja negative në të drejtat e Nenit 8 ishte i kufizuar nga fakti se ligji suedez parashikonte rregulla të qarta mbi asgjësimin e materialit të përgjimit në një sërë rrethanash dhe, mbi të gjitha, kur përmbante të dhëna personale.

Sidoqoftë, mangësia e dytë – mungesa e një kërkesë ligjore për të marrë parasysh interesat e privatësisë së individëve kur merret vendimi për të transmetuar informacione të fshehta tek partnerët e huaj – potencialisht mund të çojë në pasoja shumë të konsiderueshme negative për individët ose organizatat e prekura. Kjo mund të lejojë kalimin mekanikisht jashtë vendit të informacionit që komprometon seriozisht të drejtat e privatësisë ose të drejtën për respektimin e korrespondencës, edhe nëse vlera e tij si informacion i fshehtë është shumë e ulët. Prandaj, një transmetim i tillë mund të krijojë rreziqe qartë joproporcionale për të drejtat e Nenit 8. Për më tepër, asnjë detyrim ligjërisht detyrues nuk iu imponua FRA-së për të analizuar dhe përcaktuar nëse marrësi i huaj i informacionit të fshehtë ofronte një nivel minimal të pranueshëm garancish.

Së fundi, mangësia e tretë konsistonte në mungesë të një rishikimi efektiv *ex post facto*. Veçanërisht, roli i dyfishtë i Inspektoratit të Informacioneve të Fshehta të Huaja dhe mungesa e një mundësie për anëtarët e publikut për të marrë vendime të arsyetuara në një formë të caktuar në përgjigje të pyetjeve ose ankesave në lidhje me përgjimin në masë të komunikimeve e dobësonin mekanizmin e kontrollit *ex post facto* në një masë që krijonte rreziqe për respektimin e të drejtave themelore të individëve të prekur. Për më tepër, mungesa e një rishikimi efektiv në fazën përfundimtare të përgjimit nuk mund të pajtohej me pikëpamjen e Gjykatës se shkalla e ndërhyrjes në të drejtat e Nenit 8 të individëve u rrit me zhvillimin e procesit.

Mangësitë e mësipërme nuk u kompensuan sa duhet nga garancitë ekzistuese. Prandaj, regjimi suedez i përgjimit në masë tejkaloi kufirin e vlerësimit të lënë për Shtetin e paditur në këtë drejtim dhe, kur u pa në tërësi, nuk përmbante garanci të mjaftueshme “nga fillimi në fund” për të siguruar garanci të përshtatshme dhe efektive kundër arbitraritetit dhe rrezikut të abuzimit.

Përfundim: shkelje (pesëmbëdhjetë vota me dy).

Big Brother Watch dhe të Tjerë:

I parë në tërësi, regjimi, pavarësisht garancive të tij, përfshirë këtu edhe disa të forta, nuk përmbante garanci të mjaftueshme “nga fillimi në fund” për të siguruar garanci të përshtatshme dhe efektive kundër arbitraritetit dhe rrezikut të abuzimit. Në veçanti, u identifikuan mangësitë e mëposhtme themelore në regjim: mungesa e autorizimit të pavarur, mos përfshirja e kategorive të përzgjedhësve në aplikimin për një urdhër, dhe mosnënshtrimi i përzgjedhësve të lidhur me një individ një autorizimi të brendshëm paraprak. Këto dobësi nuk kishin të bënin vetëm me përgjimin e përmbajtjes së komunikimeve, por edhe me përgjimin e të dhënave të lidhura me komunikimin. Ndërsa Komisioneri për Përgjimin e Komunikimeve (“Komisioneri i PK-së”) ofronte një mbikëqyrje të pavarur dhe efektive të regjimit dhe Tribunali i kompetencave Hetimore (“TKH”) ofronte një zgjidhje të fuqishme gjyqësore për këdo që dyshonte se komunikimet e tij ose të saj ishin përgjuar nga shërbimet e shërbimeve të fshehta, këto garanci të rëndësishme nuk ishin të mjaftueshme për të balancuar mangësitë e mësipërme. Përgjimi në masë i regjimit të komunikimeve sipas Nenit 8(4) të Rregullores së Aktit për Kompetencat Hetimore (RAKH) nuk përmbushte

kërkesën e “cilësisë së ligjit” dhe për këtë arsye ishte i papërshtatshëm për të mbajtur “ndërhyrjen” brenda asaj që ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Përfundimi: shkelje (unanimisht).

Neni 10 (Big Brother Watch dhe të Tjerë):

(i) Garancitë e duhura

Nën regjimin e përgjimit në masë, materiali konfidencial i gazetarëve mund të aksesohet me vullnet nga shërbimet e fshehta, përmes përdorimit të qëllimshëm të përzgjedhësve ose termave të kërkimit të lidhur me një gazetar ose organizatë lajmesh. Meqenëse kjo situatë ka shumë të ngjarë të rezultojë në marrjen e sasive të konsiderueshme të materialit konfidencial gazetaresk, ajo mund të minojë mbrojtjen e burimeve në një masë edhe më të madhe se sa një urdhër për të zbuluar një burim; ndërhyrja do të ishte e njëjtë me atë të shkaktuar nga kontrolli në shtëpinë ose vendin e punës së një gazetari. Prandaj, para se shërbimet e fshehta të përdornin përzgjedhës ose terma kërkimi që dihet se janë të lidhura me një gazetar, ose që do ta bënë shumë të mundshëm përzgjedhjen e materialit konfidencial gazetaresk për shqyrtim, përzgjedhësit ose termat e kërkimit duhej të autorizoheshin nga një gjyqtar ose një organ tjetër vendimmarrës i pavarur dhe i paanshëm, i cili ka kompetencën për të përcaktuar nëse ato ishin “të justifikuar nga një kërkesë mbizotëruese e interesit publik” dhe, në veçanti, nëse një masë më pak ndërhyrëse mund të kishte mjaftuar për t’i shërbyer interesit mbizotërues publik.

Materialet konfidenciale të gazetarëve gjithashtu mund të aksesohen pa dashje, si një “kapje rastësore” e operacionit të përgjimit në masë; në një rast të tillë, shkalla e ndërhyrjes në komunikimet dhe/ose burimet gazetareske nuk mund të parashikohet qysh në fillim. Në çështjen *Weber dhe Saravia*, Gjykata pranoi që përgjimi fillestar, pa shqyrtimin e materialit të përgjuar, nuk përbënte një ndërhyrje serioze në Nenin 10 të Konventës. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se, për shkak të zhvillimeve teknologjike, mbikëqyrja e cila nuk u drejtohej drejtpërdrejt individëve kishte aftësinë për të pasur një shtrirje shumë të gjerë, ishte e domosdoshme që ligji i brendshëm të përmbante garanci të forta në lidhje me ruajtjen, ekzaminimin, përdorimin, transmetimin e mëtejshëm dhe asgjësimin e një materiali të tillë konfidencial. Për më tepër, nëse dhe kur u bë e qartë se të dhënat e komunikimit ose të

komunikimit të ndërlidhur përmbanin materiale konfidenciale gazetareske, ruajtja dhe shqyrtimi i tyre i vazhdueshëm nga një analist duhej të ishte i mundur vetëm nëse autorizohej nga një gjyqtar ose një organ tjetër vendimmarrës i pavarur dhe i paanshëm, i pajisur me kompetenca për të përcaktuar nëse ruajtja dhe ekzaminimi i vazhdueshëm ishte “i justifikuar nga një kërkesë mbizotëruese në interesin publik”.

(ii) Zbatimi në faktet e çështjes konkrete

Disa kërkues ishin një organizatë grumbulluese lajmesh dhe një gazetar: regjimi i kundërshtuar, i cili kishte ndërhyrë në të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes, nuk ishte në përputhje me kërkesat e mësipërme. Garancitë shtesë në lidhje me ruajtjen, transmetimin e mëtejshëm dhe asgjësimin e materialit konfidencial gazetaresk nuk adresonin dobësitë e identifikuara nga Gjykata në analizën e saj të regjimit sipas Nenit 8.

Përfundimi: shkelje (unanimisht).

Marrja e informacioneve sekrete nga shërbimet sekrete të huaja (Big Brother Watch and Others)

Neni 8: Kur një Shteti jo-kontraktues i bëhej një kërkesë për material përgjimi, kërkesa duhej të kishte një bazë në ligjin e brendshëm dhe ai ligj duhej të ishte i aksesueshëm për personin në fjalë dhe i parashikueshëm për efektet e tij (shih *Roman Zakharov kundër Rusisë* [DHM]). Ishte gjithashtu e nevojshme që të kishte rregulla të qarta dhe të hollësishme të cilat u japin qytetarëve një indicie të përshtatshme të rrethanave në të cilat autoritetet autorizohen për të bërë një kërkesë të tillë dhe që sigurojnë garanci efektive kundër përdorimit të kësaj kompetence për të anashkaluar ligjin e brendshëm dhe/se detyrimet e Shteteve sipas Konventës. Me marrjen e materialit, Shteti pritës duhej të kishte garanci të përshtatshme për shqyrtimin, përdorimin dhe ruajtjen e tij; për transmetimin e tij të mëtejshëm; dhe për fshirjen dhe asgjësimin e tij. Këto garanci, të krijuara për herë të parë nga Gjykata në praktikën e saj gjyqësore mbi përgjimin e komunikimeve nga Shtetet Kontraktuese, ishin njësoj të zbatueshme për marrjen, nga një Shtet Kontraktues, të materialit të përgjuar të kërkuar nga një shërbim i fshehtë i huaj. Nëse Shtetet nuk e dinin gjithmonë nëse materiali i marrë ishte produkt i përgjimit, atëherë të njëjtat standarde duhet të zbatohen për të gjithë materialin e marrë që mund të jetë produkt i përgjimit. Së fundi, çdo regjim që lejon shërbimet e fshehta të kërkojnë përgjim ose materiali

përgjimi nga Shtetet jo-Kontraktuese, ose për të aksesuar drejtpërdrejt një material të tillë, duhet t'i nënshtrohej një mbikëqyrjeje të pavarur, dhe gjithashtu duhej të kishte mundësi për një rishikim të pavarur *ex-facto*.

Gjykata, duke e kufizuar shqyrtimin e saj në ankesën në lidhje me marrjen e materialit të përgjuar të kërkuar nga Agjencia Kombëtare e Sigurisë së SHBA-ve ("AKS"), ishte e bindur që këto kërkesa ishin përmbushur në rastin konkret dhe se regjimi për kërkimin dhe marrjen e materialit të përgjimit kishte qenë në përputhje me Nenin 8.

Përfundimi: Nuk ka shkelje (dymbëdhjetë vota me pesë).

Gjykata gjithashtu vendosi, dymbëdhjetë vota me pesë, se nuk kishte pasur shkelje të Nenin 10 në lidhje me marrjen e informacioneve të fshehta nga shërbimet e fshehta të huaja, pasi ankesa nuk krijoi asnjë çështje të veçantë përveç asaj që dilte nga Neni 8.

Marrja e të dhënave të komunikimit nga ofruesit e shërbimeve të komunikimit (Big Brother Watch dhe të Tjerët)

Gjykata vendosi, njëzëri, se kishte pasur një shkelje të Neneve 8 dhe 10, pasi funksionimi i regjimit sipas Kapitullit II të ARKH-së nuk kishte qenë "në përputhje me ligjin".

Neni 41 (të dyja rastet): asnjë pretendim i bërë në lidhje me dëmin.

(Shih gjithashtu *Weber dhe Saravia kundër Gjermanisë* (dec.), 54934/00, 29 qershor 2006, [Përmbledhje Ligjore](#); *Liberty dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 58243/00, 1 korrik 2008, [Përmbledhje Ligjore](#); *Roman Zakharov kundër Rusisë* [DHM], 47143/06, 4 dhjetor 2015, [Përmbledhje Ligjore](#))

Neni 2

Neni 2, Detyrime pozitive, Neni 2-1, Jeta

Masat mbrojtëse të përshtatshme në mungesë të një rreziku të vërtetë dhe të dukshëm për vrasjen e fëmijës nga babai i akuzuar për dhunë në familje dhe i përzënë nga shtëpia: nuk ka shkelje

Kurt kundër Austrisë [DHM] – 62903/15, Vendimi i datës 15.6.2021 [DHM]

Faktet – Në qershor 2010, pas një ankese nga kërkuesja në polici për rrahje nga burri i saj ("E."), kundër tij u lëshua një urdhër ndalimi dhe mbrojtjeje

që e detyronte të qëndronte larg banesës së tyre, si dhe nga apartamenti e prindërve të kërkueses dhe zonat përreth për katërmëdhjetë ditë. Duket se ai e respektoi urdhrin. Në janar 2011, E-ja u dënua për shkaktimin e dëmtimit trupor të saj dhe bërjen e kërcënimeve të rrezikshme ndaj të afërmeve të saj. Pas kësaj, kërkuesja nuk raportoi asnjë incident në polici deri më 22 maj 2012, kur ajo paraqiti kërkesën për divorc dhe kallëzoi E.-në në polici për përdhunim, shtrëngim në fyt dhe për kërcënime të rrezikshme ditore në dy muajt e mëparshëm. Ajo gjithashtu deklaroi se ndonjëherë ai i kishte goditur me shpullë dy fëmijët e tyre; kur u intervistuan, djali dhe vajza e tyre e mitur e konfirmuan këtë, si dhe që nëna e tyre ishte rrahur. Në të njëjtën ditë u nxor një urdhër i ri ndalimi dhe mbrojtjeje kundër E.-së, duke e ndaluar atë të kthehej në banesën e tyre, në apartamentin e prindërve të kërkueses dhe zonat përreth. Ai u mor në pyetje dhe çelësat e tij u sekuestruan. Zyra e prokurorit publik gjithashtu filloi procedimin penal në ngarkim të tij. Tre ditë më vonë, ai qëlloi me armë djalin e tyre në shkollë dhe kreu vetëvrasje duke qëlluar veten me armë. Djali më pas vdiq nga plagët e marra. Ankuesja ngriti akuzë në lidhje me përgjegjësinë në detyrë, po pa sukses, duke pretenduar se E-ja duhej të ishte mbajtur në paraburgim.

Në një vendim të datës 4 korrik 2019, një Dhomë e Gjykatës Europiane njëzëri nuk gjeti asnjë shkelje të Nenit 2 në aspektin e tij lëndor. Çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuesve.

Ligji – Neni 2 (*aspekti lëndor*)

Parime të përgjithshme

Detyra për të marrë masa parandaluese operacionale për të mbrojtur një individ, jeta e të cilit ishte në rrezik nga veprimet kriminale të një individi tjetër ([*Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*](#)) ishte një detyrim mjeti, jo rezultati. Kështu, në rrethanat kur autoritetet kompetente i ishin përgjigjur rrezikut të identifikuar duke marrë masat e duhura brenda kompetencave të tyre, fakti që masa të tilla megjithatë nuk mund të arrijnë rezultatin e dëshiruar nuk ishte në vetvete i përshtatshëm të justifikonte konstatimin e një shkeljeje të detyrimit operacional parandalues të Shtetit sipas Nenit 2.

Nga ana tjetër, në këtë kontekst, vlerësimi i natyrës dhe nivelit të rrezikut përbënte një pjesë integrale të detyrës për të marrë masa operacionale parandaluese. Kështu, një shqyrtim i pajtueshmërisë së Shtetit me këtë

detyrim sipas Nenit 2 duhej të përfshinte një analizë të përshtatshmërisë së vlerësimit të rrezikut të kryer nga autoritetet e brendshme dhe përshtatshmërisë së masave parandaluese të marra.

Në kontekstin e dhunës në familje, detyrimet që u takojnë autoriteteve shtetërore mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. Kërkohej një përgjigje e menjëhershme ndaj pretendimeve për dhunë në familje.

2. Autoritetet duhej të përcaktonin nëse ekzistonte një rrezik real dhe i menjëhershëm për jetën e një ose më shumë viktimave të identifikuara të dhunës në familje, duke marrë parasysh kontekstin e veçantë të rasteve të dhunës në familje. Dhuna ndaj fëmijëve që i përkasin familjes së zakonshme, përfshirë dhunën vdekjeprurëse, mund të përdoret nga autorët si forma përfundimtare e ndëshkimit kundër partnerit të tyre.

Autoritetet kishin për detyrë të kryenin një vlerësim autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës të rrezikut. Shprehjet “autonome” dhe “proaktive” i referoheshin kërkesës që autoritetet të mos mbështeten vetëm në perceptimin e viktimës për rrezikun, por ta plotësojnë atë me vlerësimin e tyre, duke mbledhur dhe vlerësuar informacion mbi të gjithë faktorët dhe elementët e rrezikut përkatës të rastit. Për më tepër, përdorimi i listave të kontrollit të standardizuara, të njohura ndërkombëtarisht, të cilat tregojnë faktorë të veçantë rreziku dhe që ishin zhvilluar në bazë të hulumtimit të shëndoshë krimnologjik dhe praktikave më të mira në rastet e dhunës në familje, mund të kontribuojë në “plotësinë” e vlerësimit të rrezikut. Ishte e rëndësishme që autoritetet përkatëse të merrnin trajnime të rregullta dhe ndërgjegjësime, veçanërisht në lidhje me mjetet e vlerësimit të rrezikut, në mënyrë që të kuptonin dinamikën e dhunës në familje. Çdo vlerësim i rrezikut duhej të ishte i përshtatshëm për të identifikuar dhe trajtuar sistematikisht të gjitha viktimat e mundshme – të drejtpërdrejta ose të tërthorta -, duke pasur parasysh mundësinë që rezultati të jetë një nivel i ndryshëm rreziku për secilën prej tyre.

Autoritetet e zbatimit të ligjit duhet të shkëmbejnë informacionin mbi rreziqet dhe të koordinojnë mbështetjen me çdo palë tjetër përkatëse të interesit që ka rënë në kontakt të rregullt me personat në rrezik, përfshirë, në rastin e fëmijëve, me mësuesit. Autoritetet duhet të informojnë viktimën(at) për rezultatin e vlerësimit të rrezikut, dhe, kur është e nevojshme, të japin

këshilla dhe udhëzime për masat mbrojtëse ligjore dhe operacionale në dispozicion. Kështu, ishin me rëndësi disa dokumentime bazë të sjelljes së vlerësimit të rrezikut.

Lidhur me konceptin e “rrezikut të menjëhershëm”, Gjykata tashmë e kishte zbatuar atë në një mënyrë më fleksibile sesa në situatat tradicionale të tipit-*Osman* të bazuar në incidente, duke marrë parasysh trajektoren e përbashkët të përshkallëzimit në rastet e dhunës në familje, edhe nëse koha e saktë dhe vendi i sulmit nuk mund të parashikohej në një rast të caktuar. Sjellja e autorit mund të bëhet më e parashikueshme në situatat e një përshkallëzimi të qartë të një dhune të tillë, me një rritje të frekuencës, intensitetit dhe rrezikut me kalimin e kohës. Gjykata kishte vërejtur në shumë raste të tjera që një autor me precedentë të dhunës në familje paraqiste një rrezik domethënës për dhunë të mëtejshme dhe ndoshta vdekjeprurëse. Këto njohuri të përgjithshme dhe hulumtimi gjithëpërfshirës i disponueshëm në këtë fushë duhej të merreshin parasysh siç duhet nga autoritetet kur ata vlerësuan rrezikun e një përshkallëzimi të mëtejshëm të dhunës, edhe pas lëshimit të një urdhri ndalimi dhe mbrojtjeje. Megjithatë, mbi autoritetet nuk duhet të vendoset një barrë e pamundur ose joproportionale.

3. Nëse rezultati i këtij vlerësimi ishte ekzistenca e një rreziku të tillë, lindte detyrimi i autoriteteve për të marrë masa parandaluese operacionale. Masat e tilla duhej të ishin të përshtatshme dhe proporcionale me nivelin e rrezikut të vlerësuar.

Nëse masat operacionale të mjaftueshme ishin të disponueshme në ligj dhe në praktikë në momentin kritik ishte e lidhur ngushtë me çështjen e përshtatshmërisë së kuadrit ligjor (aspekti i testit-*Osman* “masat brenda sferës së kompetencave të tyre”). Një reagim i duhur parandalues shpesh kërkonte bashkërendimin ndërmjet autoriteteve të shumta, përfshirë shkëmbimin e shpejtë të informacionit. Nëse fëmijët janë përfshirë ose konstatuar të jenë në rrezik, autoritetet për mbrojtjen e fëmijëve duhet të informohen sa më shpejt të jetë e mundur, si dhe shkollat dhe/ose institucionet e tjera të kujdesit për fëmijët. Planet e menaxhimit të rrezikut dhe shërbimet e koordinuara mbështetëse për viktimat rezultuan të vlefshme në praktikë. Programet e trajtimit për autorët ishin të dëshirueshëm.

Zgjedhja e një mase operacionale kërkonte në mënyrë të pashmangshme, si në nivelin e përgjithshëm politik ashtu edhe në atë individual, një peshim

të kujdesshëm të të drejtave konkurruese në fjalë dhe kufizimeve të tjera përkatëse. Nga njëra anë, çdo masë e tillë duhej të ofronte një përgjigje të përshtatshme dhe efektive ndaj rrezikut për jetën siç është identifikuar. Nga ana tjetër, dhe në masën që ata kishin një ndikim tek autori i dyshuar, çdo masë e marrë duhej të mbetej në përputhje me detyrimet e tjera të Shteteve sipas Konventës, duke përfshirë nevojën për të siguruar që policia të ushtronte kompetencat e saj në një mënyrë që të respektonte plotësisht procesin e rregullt dhe garancitë e tjera, përfshirë garancitë e përfshira në Nenin 5 dhe 8. Natyra dhe ashpërsia e rrezikut të vlerësuar do të ishin gjithmonë një faktor i rëndësishëm në lidhje me proporcionalitetin e masave mbrojtëse dhe parandaluese që duhen marrë.

Lidhur me heqjen e lirisë në këtë kontekst, detyrimi pozitiv për të mbrojtur jetën që lind sipas Nenit 2 mund të përfshijë kërkesa të caktuara për kuadrin ligjor të brendshëm në aspektin e mundësimit të marrjes së masave të nevojshme kur kërkohet nga rrethana specifike. Sidoqoftë, në të njëjtën kohë, çdo masë që kërkon heqjen e lirisë duhet të përmbushë kërkesat e ligjit përkatës të brendshëm, si dhe kushtet specifike të përcaktuara në Nenin 5 dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës në lidhje me të.

Zbatimi në çështjen konkrete

(b) *Cilësia e vlerësimit të rrezikut* – Në fillim Gjykata përsëriti se duhej t'i shikonte faktet në mënyrë rigorozë ashtu siç ishin të njohura për autoritetet në kohën përkatëse, dhe jo duke i parë nga një distancë kohore. Më pas u zbulua se vlerësimi i rrezikut nga autoritetet, ndonëse nuk ndiqte asnjë procedurë të standardizuar të vlerësimit të rrezikut, përmbushi kërkesat për të qenë autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës. Veçanërisht:

Së pari, vlerësimi i policisë nuk ishte vetëm në bazë të tregimit faktik të dhënë nga kërkuesja, e cila ishte shoqëruar nga këshilltari i saj i vjetër ekspert nga Qendra për Mbrojtjen nga Dhuna, por edhe në disa faktorë të tjerë dhe artikujt e provave. Pikërisht ditën e raportimit të kërkueses, ato kishin marrë në pyetje të gjithë personat e përfshirë drejtpërdrejt, kishin hartuar shënime të hollësishme të deklarimeve të tyre dhe kishin marrë fotografi të plagëve të saj të dukshme. Kërkuesja gjithashtu i ishte nënshtruar një vizite mjekësore. Më tej, ata kishin kryer një kërkim në internet të të dhënave në lidhje me urdhrat e mëparshëm të ndalimit dhe mbrojtjes dhe urdhrat e ndalimit të përkohshëm dhe masat e përkohshme kundër E.-së. Ato kishin

qenë në dijeni të dënimit të tij të mëparshëm për dhunë në familje dhe sjellje të rrezikshme kërcënuese, dhe se atij i ishte lëshuar me një urdhër ndalimi dhe mbrojtjeje rreth dy vjet më parë. Për më tepër, dhe më e rëndësishmja në kontekst, ato kishin kontrolluar nëse ishte regjistruar ndonjë armë në emrin e E-së; kjo kishte prodhuar një rezultat negativ.

Së dyti, siç mund të shihet nga raporti i policisë, vlerësimi i rrezikut kishte identifikuar dhe konsideruar si duhet faktorët kryesorë të njohur të rrezikut në kontekstin e rastit të dhunës në familje. Në veçanti, rrethanat në të cilat ishte raportuar një përdhunim, shenjat e dukshme të dhunës në formën e hematomave tek kërkuesja, gjendja e saj e përlotur dhe shumë e frikësuar, se ajo u ishte nënshtruar kërcënimeve dhe fëmijët ndaj dhunës, aktet e mëparshme të raportuara dhe të paraportuara të dhunës, përshkallëzimi, faktorët faktikë të stresit si papunësia, divorci dhe/ose ndarja, tendenca e fortë e E-së për të marzhinalizuar dhunën, sjellja e tij kur ai kishte shoqëruar oficerët në rajon dhe fakti që ai nuk kishte armë zjarri të regjistruar në emrin e tij.

Së treti, kërcënimet me vdekje të shprehura nga E.-ja i ishin drejtuar të gjitha kërkueses, qofshin ato drejtpërdrejt ose tërthorazi duke e kërcënuar se do ta lëndonte ose vriste atë, të afërmit e saj ose të atij vetë. Në këtë kontekst, kërcënime të tilla duheshin marrë seriozisht dhe vlerësuar në lidhje me besueshmërinë e tyre. Rezultoi nga raporti i policisë dërguar zyrës së prokurorit publik se këto kërcënime dhe fakti që E. kishte kapur për fyti kërkuesen nuk ishin anashkaluar. Prokurori publik në detyrë kishte gjithashtu në dispozicion faktet më të rëndësishme kur duhej të vendoste për hapat e mëtejshëm t'u ndërmarrë: ai ishte informuar me telefon në të njëjtën ditë për akuzat kundër E.-së, rrethanat e lëshimit të urdhrit të ndalimit dhe mbrojtjes menjëherë pasi ishte lëshuar dhe kishte marrë raportet e kërkuara në të njëjtën mbrëmje. Në shënimin e tij për dosjen ai kishte përmbledhur elementët kryesorë të çështjes, kishte urdhëruar hapa të mëtejshëm hetimorë (marrja në pyetje e fëmijëve, paraqitja e raporteve mbi hetimet) dhe kishte filluar procedimin penal kundër E.-së për krimet për të cilat ai ishte dëshuar.

(c) Nëse autoritetet e dinin ose duhej ta dinin se kishte një rrezik real dhe të menjëhershëm për jetën e djalit të kërkueses- Autoritetet, në bazë të provave që ishin në dispozicion të tyre në momentin përkatës, kishin arritur në përfundimin se ankuesja ishte në rrezik për dhunë të mëtejshme dhe kishte

nxjerrë një urdhër ndalimi dhe mbrojtjeje kundër E.-së. Në bërjen e këtij vlerësimi ishin përfshirë oficerë të policisë me përvojë dhe trajnim përkatës të konsiderueshëm, të cilin Gjykata duhej të ishte e kujdesshme që të mos e vinte në pikëpyetje lehtë duke patur parasysh distancën kohore. Edhe pse nuk ishte kryer asnjë vlerësim i veçantë i rrezikut në mënyrë të shprehur për fëmijët, kjo nuk do ta ndryshonte situatën për arsyet e mëposhtme:

- Ndërsa fakti që fëmijët i ishin nënshtruar shpullave nga babai i tyre dhe tendosjes mendore duke qenë dëshmitarë të dhunës ndaj nënës së tyre nuk mund të nënvlerësohej në asnjë mënyrë, duke pasur parasysh informacionin që kishin autoritetet, fëmijët nuk kishin qenë objekti kryesor i dhunës ose kërcënimeve të E.-së. Objekti kryesor kishte qenë kërkuesja, goftë drejtpërdrejt apo tërthorazi.

- Arsyeja kryesore për raportimin e kërkueses në polici ishte përdhunimi dhe zënia për fyti e supozuar fundjavën e mëparshme dhe dhuna dhe kërcënimet e vazhdueshme në familje ndaj saj.

- Megjithëse raporti i policisë për lëshimin e urdhrit të ndalimit dhe mbrojtjes nuk i kishte listuar në mënyrë të shprehur fëmijët si persona të rrezikuar, ata ishin përmendur në mënyrë të shprehur si “viktima” të krimeve të treguara në raportin e hetimit penal të përcjellë prokurorit në të njëjtën ditë me deklaratat e tyre të dëshmitarëve të bashkangjitura.

- Autoritetet kishin prezumuar në mënyrë legjitime se fëmijët ishin mbrojtur në mjedisin shtëpiak nga format e mundshme jo-vdekjeprurëse të dhunës dhe ngacmimit nga babai i tyre në të njëjtën masë si kërkuesja, përmes urdhrit të ndalimit dhe mbrojtjes. Nuk kishte asnjë indicie për një rrezik për fëmijët në shkollën e tyre, dhe më konkretisht, një rrezik real dhe të menjëhershëm dhune të mëtejshme kundër djalit të kërkueses jashtë territorit për të cilin ishte lëshuar një urdhër ndalimi, e jo më një rrezik vdekjeprurës.

- Gjithashtu u duk – edhe pse jo në vetvete vendimtare – që kërkuesja dhe këshilltari i saj nga Qendra për Mbrojtjen nga Dhuna nuk e kishin konsideruar vetë që niveli i kërcënimit justifikonte kërkesën për ndalimin e plotë të kontaktit midis babait dhe fëmijëve.

- Kërcënimet e E.-së nuk ishin konsideruar mjaft serioze ose të besueshme nga autoritetet për të treguar një rrezik vdekjeprurës që do të kishte justifikuar paraburgimin ose masa të tjera më të rrepta parandaluese sesa

urdhri i ndalimit dhe mbrojtjes. Nuk kishte asnjë arsye për të vënë në dyshim vlerësimin e autoriteteve se, në bazë të informacionit në dispozicion të tyre në atë kohë, nuk ishte e mundshme që E.-ja të merrte një armë zjarri, të shkonte në shkollën e fëmijëve të tij dhe ti merrte jetën djalit të tij në një përshkallëzim kaq të shpejtë të ngjarjeve.

- Megjithëse autoritetet duket se kanë vënë njëfarë theksi në sjelljen e qetë të E.-së ndaj policisë – diçka potencialisht çorientuese në kontekstin e dhunës në familje dhe që nuk duhet të jetë vendimtare në vlerësimin e rrezikut – ky element nuk ishte i mjaftueshëm për të hedhur dyshime mbi përfundimin se në atë kohë nuk ishte i dallueshëm asnjë rrezik vdekjeprurës për fëmijët. Po ashtu, ndërsa në retrospektivë dhënia e informacionit të shpejtë shkollës së fëmijëve ose autoriteteve për mbrojtjen e fëmijëve do të ishte e dëshirueshme, nuk ishte e parashikueshme që një masë e tillë të ishte kërkuar për të parandaluar një sulm vdekjeprurës ndaj djalit të kërkueses. Kështu, mosdhënia e këtij informacioni, i cili nuk ishte parashikuar sipas ligjit të brendshëm në kohën e ngjarjeve, nuk mund të konsiderohet si shkelje e detyrimit të tyre për kujdes të veçantë në kontekstin e detyrimeve pozitive të autoriteteve sipas testit *Osman*.

Së fundmi, duke marrë parasysh kërkesat e së drejtës penale të brendshme dhe ato që rrjedhin nga Neni 5 i Konventës për garantimin e të drejtave të akuzuarve, nuk kishte asnjë arsye për të vënë në dyshim konstatimin e gjykatave të brendshme se autoritetet kishin vepruar në mënyrë të ligjshme në mosmarrjen e E.-së në paraburgim. Sipas Nenit 5, nuk lejohej asnjë ndalim nëse nuk ishte në përputhje me ligjin e brendshëm dhe kërkuësja nuk kishte ngritur asnjë ankesë në lidhje me kuadrin ligjor të brendshëm në lidhje me shkaqet e paraburgimit në lidhje me detyrimet pozitive sipas Nenit 2.

Duke pasur parasysh sa më sipër, masat e urdhëruara, në dritën e rezultatit të vlerësimit të rrezikut, dukeshin se ishin të përshtatshme për të shmangur çdo rrezik të dhunës së mëtejshme kundër fëmijëve. Autoritetet kishin treguar kujdesin e kërkuar të veçantë për të reaguar me shpejtësi ndaj pretendimeve të kërkueses për dhunën në familje dhe kishin marrë siç duhet parasysh kontekstin specifik të rastit të dhunës në familje. Ata kishin qenë shterues dhe të ndërgjegjshëm në marrjen e të gjitha masave të nevojshme mbrojtëse. Ata kishin kryer një vlerësim autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës të rrezikut, rezultati i të cilit i kishte shtyrë ata të nxirrnin

një urdhër ndalimi dhe mbrojtjeje; nga ky vlerësim, asnjë rrezik real dhe i menjëhershëm i një sulmi mbi jetën e fëmijëve nuk ishte dalluar nën testin *Osman* të aplikuar në kontekstin e dhunës në familje. Si pasojë, nuk kishte asnjë detyrim të autoriteteve për të marrë masa të mëtijshme parandaluese operationale veçanërisht në lidhje me fëmijët e kërkueses, qoftë në mjediset private apo ato publike, të tilla si nxjerrja e një urdhri ndaluespër në shkollën e fëmijëve.

Përfundimi: Nuk ka shkelje (dhjetë vota me shtatë).

(Shih gjithashtu *Osmani kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1998, [Përmbledhje Ligjore](#); *Bubbins kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 50196/99, 17 mars 2005, [Përmbledhje Ligjore](#); *Kontrová kundër Sllovakisë*, 7510/04, 31 maj 2007, [Përmbledhje Ligjore](#); *Branko Tomašić dhe të Tjerë Others kundër Kroacisë*, 46598/06, 15 janar 2009, [Përmbledhje Ligjore](#); *Opuz kundër Turqisë*, 33401/02, 9 Qershor 2009, [Përmbledhje Ligjore](#); *Talpis kundër Italisë*, 41237/14, 2 mars 2017, [Përmbledhje Ligjore](#))

II. AKTGJYKIME TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Boshkoski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut – 71034/13, Aktgjykimi nga data 4 qershor, 2020

Neni 6 paragrafi 1 dhe 3 (g), e drejta e procedurës së drejtë

Padrejtësia e procedurës penale për shkak të përkushtimit të besimit ndaj dëshmisë së dëshmitarit të rrezikuar nga gjykatat vendase dhe përjashtimit të publikut nga disa seanca gjyqësore

Faktet – Aplikanti u ankua në bazë të nenit 6 të Konventës në lidhje me padrejtësinë e përgjithshme të procedurës penale kundër tij në të cilën është pandehur për abuzimin e pozitës zyrtare dhe autorizimit dhe për abuzimin e mjeteve për financimin e fushatës zgjedhore, gjatë Zgjedhjeve parlamentare në vitin 2011, në kohën kur ishte kryetar i partisë politike Të Bashkuar për Maqedoninë. Ai ankohej se të drejtat e tij në përputhje me nenin 6 § 1 dhe 3 (g) janë shkelur si rezultat i mënyrës së veçantë të seancave dëgjimore të dëshmitarit 3-1. Në bazë të nenit të njëjtë, ai ankohej se i është shkelur e drejta e diskutimit publik për shkak të përjashtimit të publikut nga tri seanca gjyqësore.

E drejta – GJEDNJ gjatë vlerësimit të drejtësisë së përgjithshme të procedurës penale, në dritën e pretendimeve të aplikantit dhe parimeve të përgjithshme relevante të aplikuar në praktikën e GJEDNJ, në mënyrë të veçantë u fokusua në aspektet si vijon:

A) Pretendimi për shkeljen e të drejtave për mbrojtjen e aplikantit lidhur me seancën dëgjimore të dëshmitarit 3-1

-a ka pasur arsye të mira për kamuflimin e identitetit të dëshmitarit 3-1

Duke theksuar se mungesa e arsyes së mirë për mos zbulimin e identitetit të dëshmitarit vetvetiu nuk mund të jetë vendimtare për miratimin e konkluzionit se procedura ka qenë e padrejtë, ky është një faktor jashtëzakonisht i rëndësishëm i cili duhet të merret parasysh gjatë

balancimit kur vlerësohet drejtësia e përgjithshme e procedurës dhe një faktor i cili mund të anojë në favor të përcaktimit të shkeljes së nenit 6, Gjykata konstatoi se gjatë përcaktimit të dëshmitarit 3-1 statusi i dëshmitarit të rrezikuar, gjyqtari hetues nuk e ka shqyrtuar nëse i pandehuri apo ata që kanë vepruar në emër të tij kanë adresuar kërcënime ose veprime të tjera ndaj dëshmitarit; në mënyrë rrjedhëse, trupi gjykues kur i ka refuzuar kundërshtimet e mbrojtjes lidhur me statusin e dëshmitarit, i është referuar ekzistimit të vazhdueshëm të rrezikut ndaj jetës, shëndetit dhe integritetit fizik të dëshmitarit; dhe së këtejmi në asnjë fazë të procedurës nuk është nxjerrë ndonjë provë me të cilën do të mbështetej ekzistimi i kërcënimeve të ndryshme drejt dëshmitarit ose familjes së tij, ndërsa mbrojtjes nuk i është lejuar të parashtojë pyetje në lidhje me këtë, kështu që Gjykata konkludoi se gjykatat vendase nuk e kanë shqyrtuar aspektin se a ka pasur arsye objektive në mbështetje të frikës së manifestuar nga dëshmitari e që do ta arsyetonte statusin e tij të dëshmitarit të rrezikuar. Për më tepër, në kushte kur ka qenë e pakontestueshme se aplikanti dhe dëshmitari njihen midis tyre, Gjykata konstatoi se është e paqartë se si kamuflimi i identitetit të dëshmitarit të mbrojtjes, e ka zbutur frikën e dëshmitarit pavarësisht asaj se frika a ka qenë objektivist e arsyeshme ose jo.

-a ka qenë deklarimi i dëshmitarit bazë e vetme ose vendimtare për dënimin e aplikantit

Gjykata vlerësoi se edhe përkrah prezencës së provave të tjera, madje edhe nëse nuk mund të thuhet se deklarimi i dëshmitarit 3-1 ka qenë provë e “vetme” ose “vendimtare”, ai me siguri se ka pasur rëndësi të konsiderueshme për epilogun e procedurës meqë trupi gjykues “e ka konfirmuar pa dyshime” qëllimin për të cilin janë dhënë paratë në bazë të deklarimit të dëshmitarit 3-1, që është konsideruar se ka rëndësi të posaçme.

-a kanë ekzistuar faktorë të mjaftueshëm për kundërpeshë

Duke e pasur parasysh aplikimin e mënyrës së veçantë të dëgjësës së dëshmitarit 3-1, si dhe pohimin e aplikantit se aplikimi i tij ka rezultuar me prezantimin në ekran i cili është gjysmë i zi dhe gjysmë i bardhë, Gjykata konkludoi se shanca dëgjimore e dëshmitarit 3-1, në mënyrën se si është realizuar, e ka pamundësuar edhe trupin gjykues edhe mbrojtjen, në mënyrë efikase ta mbikëqyrin sjelljen e dëshmitarit gjatë dëgjësës dhe se gjykatat vendase nuk e kanë trajtuar deklarimin e dëshmitarit të rrezikuar me kujdes

të veçantë por përkundrazi e kanë theksuar rëndësinë e tij me konstatimin se ai padyshim se i ka konfirmuar faktet relevante.

(B) Pretendimi për shkeljen e të drejtave të mbrojtjes së aplikantit për shkak të përjashtimit të publikut nga tri seanca gjyqësore

Duke u nisur nga qëndrimi se gjykatat vendase doemos duhet të japin arsye konkrete pse përjashtimi i publikut është i domosdoshëm që të mbrohet interesi publik ose të kufizohet fshehtësia deri në shkallën që është e nevojshme për ruajtjen e interesit të tillë, Gjykata e mori në konsideratë se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, me iniciativë të vet, e përjashtoi publikun dhe konkludoi se nuk janë ndërmarrë kurrfarë masash të kundërpeshës në lidhje me efektin e dëmshëm që mund ta shkaktojë vendimi për mbajtjen e seancës gjyqësore nga e cila është përjashtuar publiku sa i përket besimit të publikut në zbatimin e drejt të drejtësisë. Për më tepër, Gjykata, duke i pasur parasysh arsyet e gjykatës vendase për përjashtimin e publikut nga tri seanca gjyqësore, konstatoi se në rrethanat e rastit, objektivisht nuk ka qenë e arsyeshme që publiku të përjashtohet nga të njëjtat, meqë në audio dhe video regjistrimet, si edhe gjatë dëshmisë, personi dhe zëri i dëshmitarit 3-1 janë ndryshuar.

Konkluzion: shkelje (unanimisht)

Neni 41: Gjykata e ngarkoi shtetin në afat prej 3 muajsh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit aplikantit t’ia paguajë shumën prej 4.500 euro për dëmin jomaterial dhe 1.220 euro për shpenzime.

J.M. dhe A.T. kundër Maqedonisë së Veriut – 9783/13, Aktgjykim nga data 22 tetor 2020

Neni 8, e drejta e jetës private

Përpunimi i pabazuar i të dhënave personale të aplikantëve dhe ekspozimi i informacioneve për gjendjen e tyre shëndetësore

Faktet – Aplikantit J.M. dhe A.T. të cilët kanë qenë pacientë në Qendrën për mjekimin e vartësve “S.E.” pranë ISHP Strumicë pohonin se iu është shkelur e drejta e respektimit të privatësisë së tyre meqë inspektorët e SPB Strumicë kanë pasur qasje në dosjet e tyre mjekësore. Në të vërtetë, sipas

rastit paraprakisht të paraqitur nga ana e spitalit për shkak të mungesës dhe keqpërdorimit eventual të tretësit *sol.metadon*, në muajin prill të vitit 2010 dy inspektorëve të SPB Strumicë, pa bazë ligjore dhe pa urdhër gjyqësor, u janë dhënë në këqyrje dhe u janë dorëzuar lista mjekësore të cilat e përmbajnë emrin dhe mbiemrin e plotë, si dhe sasinë e terapisë me metadon të cilën e kanë pranuar pacientët, përfshirë këtu edhe dy aplikantit. Në muajin qershor të vitit 2010, me kërkesë të policisë spitali u dërgoi kopje nga listat e lartpërmendura për shpërndarjen ditore të metadonit, por të njëjtat nuk i përmbanin emrat dhe mbiemrat e pacientëve. Policia e vazhdoi hetimin për rastin e denoncuar dhe në gusht të vitit 2010 e njoftoi Prokurorinë Publike në Strumicë se kanë konstatuar se nuk ka elemente të veprës penale në lidhje me metadonin e zhdukur dhe se bëhet fjalë për gabim të cilin e ka bërë i punësuar, ndërsa listat mjekësore që i përmbanin të dhënat personale të të dy aplikantëve, i janë kthyer spitalit.

Në ndërkohë, në qershor të vitit 2010, aplikantit paraqitën kërkesë në Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (aktualisht Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) për zbatimin e mbikëqyrjes mbi punën e spitalit dhe për përcaktimin e shkeljes së të drejtës së privatësisë. Drejtoria në raportin e saj ka konstatuar se policia ka bërë këqyrje në listat e shpërndarjes ditore të metadonit të cilat i përmbanin emrat dhe mbiemrat e pacientëve, përfshirë këtu edhe aplikantit, dhe dozën e dhënë të metadonit dhe se i është dhënë në këqyrje fletorja për raportim me qëllim të përcaktimit të sasisë së saktë të metadonit të dhënë. Sipas Drejtorisë, policia ka vepruar në përputhje me ligjin, përkatësisht në përputhje me nenin 144 të LPP dhe nenet 14 dhe 68 të Ligjit për polici (shih: paragrafin 7 të aktgjykimit). Të pakënaqur nga aktvendimi i Drejtorisë aplikantit ngritën kontest administrativ. Gjykata Administrative, ndërsa pastaj edhe Gjykata e Lartë Administrative e refuzuan kërkesëpadinë e tyre si të pabazuar.

Nga ana tjetër, aplikantit paraqitën edhe padi civile kundër MPB – SPB Strumicë dhe kundër spitalit për përcaktimin e shkeljes së të drejtës së privatësisë dhe për përcaktimin e kompensimit të drejt për shkaktimin e dëmit jomaterial, përkatësisht dhimbjes shpirtërore. Gjykata Themelore në Strumicë e refuzoi kërkesëpadinë si të pabazë, dhe mes tjerash konstatoi se listat në të cilat ka pasur këqyrje policia kanë qenë të anonimizuara dhe se nuk është bërë shkelje ose ndonjë parregullsi gjatë procedimit të përpunimit të të dhënave personale. Gjykata e Apelit Shtip e konfirmoi aktgjykimin e shkallës së parë.

E drejta – GJEDNJ gjatë vendimmarrjes për çështjen konkrete e vlerësoi veprimin e autoriteteve vendase, përkatësisht këqyrjen e lejuar në dosjet mjekësore të aplikantëve, me ç'rast konstatoi se bëhet fjalë për ndërhyrje në të drejtën e privatësisë së aplikantëve. Gjykata vlerësoi nëse ndërhyrja në të drejtën e privatësisë ka qenë e arsyeshme, përkatësisht se a ka qenë e ligjshme, se a ka qenë e nevojshme për realizimin e qëllimit legjitim dhe a ka qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike, përkatësisht a ka qenë proporcionale.

Gjykata konstatoi se është e pakontestueshme se policia ka pasur këqyrje në listat e pa anonimizuara për shpërndarjen ditore të metadonit të cilat i përmbanin të dhënat personale të pacientëve, përfshirë këtu edhe të aplikantëve. Gjykata, veç tjerash, konstatoi se e drejta e qasjes së policisë në të dhënat personale mjekësore pa urdhër gjyqësor është e ligjshme meqë është paraparë në Ligjin për policinë, Ligjin për procedurë penale dhe në Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve. Pastaj, Gjykata e pranoi se ndërhyrja në të drejtën e privatësisë përmes qasjes në të dhënat personale të aplikantëve është bërë për shkak të realizimit të qëllimit legjitim për zbulimin, si dhe për parandalimin e kryerjes së veprës penale.

Megjithatë, gjatë vlerësimit të asaj se a ka qenë e nevojshme, në rrethanat e rastit policia të ketë qasje dhe këqyrje në të dhënat personale mjekësore të pacientëve të spitalit, Gjykata konstatoi se nuk ka qenë e nevojshme dhe se policia ka pasur në dispozicion veprime të tjera gjatë zbatimit të hetimit në lidhje me kallëzimin penal. Sipas Gjykatës, policia ka pasur mundësi ta dëgjojë personelin mjekësorë para se të bëjë këqyrje në listat mjekësore të pa anonimizuara. Në lidhje me këtë, Gjykata vërejti se në të vërtetë policia në bazë të dëgjësës së njërit nga mjekët konstatoi se nuk ekziston vepër penale.

Gjykata po ashtu konstatoi se gjykatat vendase nuk kanë vendosur balancë të drejt midis mbrojtjes së të drejtave të pacientëve dhe të drejtave të policisë që të ketë qasje në të dhënat sensitive mjekësore pa urdhër gjyqësor.

Konkluzion: shkelje (unanimisht)

Neni 41: Gjykata me aktgjykimin e saj e ngarkoi shtetin në afat prej tre muajsh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit aplikantëve tua paguajë shumën prej 900 euro për shpenzimet gjyqësore.

X dhe Y kundër Maqedonisë së Veriut – 173/17, Aktgjykim nga data 5 nëntor 2020

Neni 3, ndalimi i torturës, trajtimit apo dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

Faktet – Në ankesën e tyre, aplikantit u ankuan në lidhje me brutalitetin me motive racore të policisë ndaj tyre meqë janë romë dhe se kanë qenë të mitur kur ndodhi rasti kontestues. Aplikantit u ankuan edhe sa i përket moszbatimit të hetimit efikas nga ana e shtetit në lidhje me pretendimet e tyre për veprimin jopërkates të policisë. Aplikantit pohonin se me veprimin e këtyllë u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara në nenin 3 (ndalimi i torturës), nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 3 (ndalimi i torturës) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 (ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Për më tepër, më 19 maj të vitit 2014 personi E.R. u sulmua nga dy persona me ç'rast ia kanë vjedhur çantën e shpinës, dhe pastaj ngjarja është denoncuar në polici. Një kohë të shkurtër pas denoncimit të rastit, katër pjesëtarë të njësisë speciale “Alfa” e kanë takuar aplikantin X në afërsi të vendit në të cilin ndodhi ngjarja meqë i është përgjigjur përshkrimit të dhënë nga E.R. më vonë aplikanti është identifikuar nga E.R. si njëri nga personat që e kanë sulmuar. Në raportin e hartuar nga Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB është theksuar se nuk është përdorur forcë gjatë privimit nga liria të aplikantit X. Sipas shënimeve të policisë nga dita konkrete tek aplikanti nuk janë gjetur sende që kanë të bëjnë me vjedhjen, aplikanti i është dorëzuar stacionit policor në “gjendje të mirë fizike dhe psikologjike”, babai i tij është thirrur në stacionin policor, ku në prezencë të avokatit sipas detyrës zyrtare nënshkruan deklaratatë se nuk ankohen për sjelljen e policisë dhe se nuk kërkojnë ndihmë juridike dhe mjekësore. Aplikantin e lëshuan në liri rreth mesnate, disa orë pas privimit nga liria, ndërsa për aplikantin e dytë Y, nuk ka shënime policore.

Të nesërmen, më 20 maj të vitit 2014, aplikanti i parë është pranuar në spital në Shkup dhe sipas raportit të të njëjtës datë dhe vërtetimit mjekësor nga 4 qershori i vitit 2014 aplikantit X i është diagnostifikuar shtypje në kokë, në qafë dhe në kraharor (dhe gërvishtje në kraharor). Në vërtetimin mjekësor

është shënuar se siç e ka shpjeguar X, ai është sulmuar fizikisht nga policia dhe e kanë goditur në kokë, në qafë, në krahë dhe në stomak.

Më 18 qershor të vitit 2014, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, me kërkesë të Z. M. dhe R. U. paraqiti parashtresë deri te Sektori se më 19 maj të vitit 2014, aplikantit i kanë rrahur dhe i kanë trajtuar keq nëpunësit policorë. Sipas deklaratës së dëshmitarit, më 19 maj të vitit 2014 policia ka qenë fizikisht e dhunshme ndaj aplikantëve. Sipas pretendimeve të aplikantëve, X është marrë në pyetje në stacionin policor dy orë pa prezencën e babait dhe avokatit të tij, dhe me pretendimin se është rrahur nga nëpunësit policorë. Aplikantit, veç tjerash, pohuan se nuk u është siguruar përkthyes meqë në nivel të kufizuar e zotërojnë gjuhën maqedonase. Sektori për Kontroll të Brendshëm e refuzoi parashtresën duke konstatuar se nëpunësit policor nuk i kanë tejkaluar autorizimet e tyre. Kjo është konstatuar edhe nga Avokatit e Popullit.

Më 3 shtator të vitit 2014, aplikantit paraqitën kallëzim penal deri te prokurori publik kundër katër nëpunësve të paignifikuar policorë për shkak të veprimeve të këqija, torturës dhe trajtimit apo dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës, dhunës dhe diskriminimit racor në lidhje me ngjarjen nga data 19 maj 2014, duke pohuar se i kanë takuar në rrugë dhe janë rrahur nga nëpunësit policorë sepse janë romë. Kallëzimit penal ia kanë bashkëngjitur vërtetimin mjekësor për aplikantin X, parashtresën e paraqitur në Sektor dhe përgjigjen e tyre dhe kanë propozuar dëshmitarë. Në muajin gusht të vitit 2015 aplikantit paraqitën kërkesë pranë Prokurorisë së Lartë Publike për mbikëqyrjen e punës së Prokurorisë Themelore Publike në mungesë të cilitdo qoftë veprimi nga ana e saj, prej ku u njoftuan se do të ndërmerren masa përkatëse. Në muajin mars të vitit 2016 aplikantit paraqitën kërkesë deri te Prokurori i Lartë Publik që ta ndërmarrë ndjekjen penale për shkak të mosndërmarrjes së veprimeve nga ana e Prokurorit Themelor Publik, dhe pas kësaj u njoftuan se Prokurori i Lartë Publik ka kërkuar informacione nga PTHP kompetente. Aplikantit paraqitën kërkesë të ngjashme më 21 tetor të vitit 2016.

Në muajin dhjetor të vitit 2016 Prokurori Themelor Publik e njoftoi Prokurorin e Lartë Publik se kanë kërkuar nga MPB t'i identifikojë nëpunësit policorë të cilët kanë qenë të përfshirë në këtë ngjarje. Një kërkesë e këtillë përsëri është paraqitur më 6 nëntor të vitit 2017. Sipas shkresës nga PTHP deri në

muajin maj të vitit 2018 në pyetje është marrë Y, në prezencë të avokatit, nëpunësve policorë, ndërsa X nuk iu përgjigj thirrjes nga PTHP.

Në muajin dhjetor të vitit 2016 aplikantit paraqitën dy padi civile për shkak të diskriminimit nga MPB dhe PTHP. Në paditë e tyre i kanë theksuar ngjarjet e lartpërmendura. Sa i përket padisë kundër PTHP, Gjykata Themelore e refuzoi kërkesëpadinë si të pabazë nga Y dhe konstatoi se X në ndërkohë (më datë 21 shtator të vitit 2017) e ka tërhequr padinë e tij dhe ka konstatuar se nuk ka pasur prova se Y është diskriminuar sepse është rom. Gjykata Themelore ka konsideruar se, duke e pasur parasysh kompleksitetin e lëndës, koha e nevojshme për prokurorin publik që t'i ndërmerr veprimet e nevojshme nuk ka qenë tej mase dhe nuk mund të implikojë ekzistim të diskriminimit. Gjykata e Apelit e konfirmoi aktgjykimin e këtillë. Sa i përket padisë kundër MPB, gjatë kohës së vendimmarrjes së GJEDNJ nuk është dërguar informacion se a ka përfunduar procedura.

Më datë 23 maj të vitit 2014 MPB ngriti kallëzim penal kundër X, sipas akuzës për vjedhje. Gjykata Themelore në Prilep mbajti disa seanca sipas kërkesës së Prokurorit Publik për shqiptimin e masës edukative, megjithatë X ishte i paakseshëm, kështu që më 15 mars të vitit 2016 Gjykata e ndërpreu procedurën. Më 16 qershor të vitit 2016 Gjykata Themelore në Prilep nxori aktgjykim me të cilin është shqiptuar masa edukative “mbikëqyrje e përforcuar nga prindërit”. Gjatë kohës së vendimmarrjes së GJEDNJ nuk janë dërguar informacione nëse aplikanti X ka ngritur ankesë ndaj aktgjykimit të këtillë të Gjykatës Themelore.

E drejta – GJEDNJ me aktgjykimin e saj përkujttoi në detyrimin e shteteve të zbatojnë hetim efikas për pretendimet në lidhje me veprimin e nëpunësve shtetërorë me të cilin pretendohet se është shkelur neni 3 i Konventës si dhe të parimeve themelore të përcaktuara në këtë kontekst. Në përputhje me praktikën e Gjykatës, që hetimi të jetë efikas, para së gjithash hetimi duhet të jetë adekuat, që nënkupton ta mundësojë përcaktimin e fakteve, si dhe përcaktimin se forca e përdorur a ka qenë ose nuk ka qenë e arsyeshme në rrethanat konkrete, si dhe identifikimin dhe – nëse është përkatës – dënimin e personave përgjegjës. Nga ana tjetër, hetimi duhet të jetë i shpejtë dhe rrënjësor, që do të thotë se autoritetet shtetërore çdoherë duhet të bëjnë përpjekje serioze që të zbulojnë çka ka ndodhur dhe t'i ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshëm që i kanë në dispozicion në mënyrë që të sigurojnë prova

për incidentin. Pastaj, hetimi duhet të jetë i pavarur, si dhe t'i mundësojë viktimës pjesëmarrje efektive në të njëjtin, (paragrafi 50).

Në dritën e rastit konkret, Gjykata konstatoi se kallëzimi penal i paraqitur nga aplikantit ka qenë mjaftueshëm i argumentuar me ç'rast autoritetet shtetërore e kanë pasur për detyrë të zbatojnë hetim efikas në lidhje me pretendimet e tyre. Pastaj, Gjykata përcaktoi se PTHP ka qenë jo aktive dhe nuk ka ndërmarrë kurrfarë masa hetuese plot dy vjet nga paraqitja e kallëzimit penal nga ana e aplikantëve, dhe për këtë shkak aplikantit ishin të detyruar tre herë t'i drejtohen Prokurorisë së Lartë Publike. Gjykata, mes tjerash, vërejt se në takimin e parë me përfaqësuesin ligjor të aplikantëve i cili u mbajt më 25 nëntor të vitit 2016, Prokurori Publik nuk e ka shqyrtuar kallëzimin penal të aplikantëve por ka biseduar për mospasjes akses deri te X në procedurën kundër tij. Pastaj Gjykata përcaktoi se PTHP madje në muajin dhjetor të vitit 2016, dy vjet pas ngjarjes kontestuese, për herë të parë i është drejtuar MPB me qëllim të përcaktimit të identitetit të nëpunësve policorë të përfshirë në ngjarjen nga viti 2014. Meqë nuk kanë pranuar përgjigje ndaj kësaj kërkesë, PTHP pas pothuajse një viti, më 6 nëntor të vitit 2017 paraqiti kërkesë të re deri në MPB. Gjykata, po ashtu, konstatoi se pas tre vitesh nga paraqitja e kallëzimit penal PTHP e ka dëgjuar aplikantin dhe nëpunësit policorë, pa dhënë ndonjë arsytim për prolongimin e këtitillë. Prokuroria po ashtu nuk ka mbajtur seancë dëgjimore me dëshmitarët e propozuar nga aplikantit, madje nuk ka marrë as hapa të tjerë për zbulimin e provave në lidhje me incidentin. Gjykata, po ashtu, ka vërejtur se autoritetet vendase kanë ndërmarrë hapa në procedurën penale kundër X e cila krahas vështirësive që të sigurohet prezenca e tij ka përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm. Gjykata konstatoi se pas gjashtë viteve nga data e paraqitjes së kallëzimit penal nga ana e aplikantëve hetimi akoma nuk ka përfunduar. Duke e pasur parasysh këtë, Gjykata konstatoi se autoritetet kompetente nuk i kanë procesuar me kujdes të mjaftueshëm pretendimet e aplikantëve për pretendimin e veprimit nga ana e nëpunësve policorë ndaj tyre, dhe së këtejmi Gjykata është e mendimit se hetimi i zbatuar në këtë mënyrë nuk i plotëson standardet e hetimit efikas dhe për këtë shkak konstatoi shkelje të aspektit procedural të nenit 3 nga GJEDNJ (paragrafi 52-54).

Në lidhje me pretendimin për shkeljen e aspektit material të nenit 3 nga GJEDNJ, Gjykata është e mendimit se gjashtë vjet pas ngjarjes kontestuese, ndërsa në masë të madhe për shkak të mosazhurnitetit të autoriteteve

vendase për zbatimin e hetimit në lidhje me pretendimet e aplikantëve, Gjykata, në bazë të provave që i janë dërguar asaj, me siguri nuk mund të përcaktojë nëse nëpunësit policorë i kanë keqtrajtuar aplikantët, dhe së këtejmi nuk konstatoi shkelje të aspektit material të nenit 3.

Aplikantit, veç tjerash u ankuan se edhe keqtrajtimi nga ana e nëpunësve policorë dhe hetimi joefektiv nga prokuroria publike vënë në dukje se aplikantit janë diskriminuar në bazë të përkatësisë së tyre etnike (racore). Sa u përket këtyre pretendimeve Gjykata është e mendimit se, as para institucioneve vendase as në procedurën para GJEDNJ nuk janë paraqitur prova të mjaftueshme në bazë të të cilave do të konstatohej se moszbatimi i hetimit efikas ka të bëjë me përkatësinë etnike të aplikantëve dhe prandaj i hodhi poshtë këto pretendime dhe konstatoi se nuk ka shkelje të nenit 14 v.v., me nenin 3 të Konventës.

Konkluzion: shkelje (unanimisht)

Neni 41: Për shkeljen e konstatuar Gjykata aplikantëve ua përcaktoi shumën nga 7 500 euro në lidhje me dëmin material.

Janevski kundër Maqedonisë së Veriut – 30259/15, Aktgjykim nga data 19 nëntor 2020

Neni 6 paragrafi 1 dhe 3 (g), e drejta e procedurës së drejtë

Aplikantit si i pandehur i është pamundësuar dëgjesa e dëshmitarëve deklarimet e të cilave janë përdorur si prova kundër tij.

Faktet – Në rastin konkret kundër aplikantit është hapur hetim për shkak të dyshimeve se ka kryer vepër penale – mashtrim, përkatësisht se katër personave u ka premtuar punësim në MPB, me kompensimin e caktuar monetar të cilin të njëjtit ia kanë paguar, me ç’rast aplikanti është pandehur. Aplikanti është ankuar se personat të cilët pretendojnë se janë mashtruar, janë dëgjuar si dëshmitarë nga ana e gjyqtarit hetues dhe pastaj në seancë gjyqësore në gjykatën penale, por pa prezencën e aplikantit dhe për këtë shkak ai nuk ka pasur mundësi tu parashtrijë pyetje, pavarësisht propozimeve dhe kërkesave të tij që dëshmitarët të dëgjohen në prezencë të tij.

E drejta – Gjatë shqyrtimit se a është shkelur Konventa, Gjykata u përqendrua në tri çështje (testi standard i zhvilluar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ i cili zbatohet për pretendime të këtilla lidhur me shkeljen e KEDNJ – pretendime në lidhje me nenin 6 § 3 (g)): së pari, a kanë ekzistuar arsye të mira për mos prezencën e dëshmitarëve në seancat gjyqësore; së dyti deklaratat e tyre në mungesë të aplikantit të pandehur, a kanë qenë bazë e vetme ose vendimtare për dënimin e tij; dhe së treti, a kanë ekzistuar faktorë të mjaftueshëm të kundërpeshës që t’i kompensojnë rrethanat rënduese në të cilat ka punuar mbrojtja.

(a) A kanë ekzistuar arsye të mira për mos prezencën e dëshmitarëve në procesin gjyqësor

Gjykata është e mendimit se në rastin konkret nuk ka pasur arsye të dukshme për mos suksesin e autoriteteve kompetente që ta sigurojnë prezencën e aplikantit në seancat gjyqësore në të cilat dëshmitarët janë dëgjuar meqë aplikanti në atë kohë e ka vuajtur dënimin me burgim për një vepër tjetër penale. Mes tjerash, Gjykata konkludoi se refuzimi i kërkesës së aplikantit që dëshmitarët të dëgjohen në prezencë të tij, me arsyetimin se ata tanimë janë dëgjuar në fazën e procedurës hetimore (gjatë së cilës ai nuk është njoftuar për dëgjuesën e tyre) dhe gjatë kohës së gjyimit, por në mungesë të tij dhe në mungesën e avokatit të tij, nuk mund të konsiderohet se është arsye e mirë për mos prezencën e dëshmitarëve të cilët paraprakisht janë dëgjuar në mungesë të aplikantit. Edhe pse mungesa e arsyes së mirë për mos prezencën e dëshmitarit, vetvetiu nuk mund të jetë vendimtare për miratimin e konkluzionit se procedura ka qenë e padrejtë, megjithatë bëhet fjalë për një faktor jashtëzakonisht të rëndësishëm i cili duhet të merret në konsideratë gjatë balancimit kur vlerësohet drejtësia e përgjithshme e procedurës dhe faktorë i cili mund të anojë në favor të përcaktimit të shkeljes së nenit 6 § § 1 dhe 3 (g).

(b) A ishin deklaratat e dëshmitarëve në mungesë provë e vetme ose vendimtare për dënimin e aplikantit

Gjykata konstatoi edhe pse deklaratat e dhëna nga katër dëshmitarët nuk kanë qenë prova të vetme mbi të cilat gjykatat vendase e mbështetën aktgjykimin dënues ndaj aplikantit dhe nuk gjeti arsye të vlerësojë se a kanë qenë deklaratat e tyre prova vendimtare për dënimin e tij, duke e pasur

parasysh konkluzionin e saj se provat kontestuese me sa duket kanë pasur rëndësi të konsiderueshme për miratimin e aktgjykimit dënues, ndërsa kjo ka qenë rrethanë rënduese për mbrojtjen në procedurën penale. Në lidhje me këtë, Gjykata përcaktoi se gjykata e shkallës së parë është mbështetur në këto deklarime duke konsideruar se aplikanti i ka “vënë në lajthitje” dëshmitarët. Në këtë kontekst duhet të merren parasysh qëndrimet e zhvilluara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ sipas të cilave vëllimi i faktorëve të kundërpeshës të nevojshëm që gjykimi të konsiderohet si i drejtë, do të varet nga rëndësia e deklarimeve të dëshmitarëve në mungesë si prova. Sa më të rëndësishme të jenë këto prova, rëndësi më të madhe duhet të kenë faktorët e kundërpeshës.

(v) A kanë ekzistuar faktorë të mjaftueshëm të kundërpeshës që t’i kompensojnë rrethanat rënduese në të cilat ka punuar mbrojtja

Gjykata konstatoi se kanë ekzistuar disa faktorë të kundërpeshës me të cilët ka pasur mundësi të kompensohen rrethanat rënduese të shkaktuara nga pranimi i deklarimeve të dëshmitarëve si prova nga gjykatat vendase, pa pasur mundësi aplikanti t’u parashtrojë pyetje. Me fjalë të tjera, gjatë procedurës penale, krahas deklarimeve të dëshmitarëve, janë vlerësuar edhe si vijon:

1. provat materiale të gjetura në automjetin e aplikantit (kontratë për hua të mjeteve monetare dhe dokumente personale të disa nga dëshmitarët) me të cilat konfirmohen deklarimet e pa verifikuara të dëshmitarëve;
2. deklarimet e dëshmitarëve ishin konsekuente dhe konsistente njëra me tjetrën; dhe
3. aplikanti ka pasur mundësi ta prezantojë versionin e tij të ngjarjeve dhe të shpreh dyshim sa i përket besueshmërisë së dëshmitarëve.

Konkluzion: shkelje (unanimisht)

Neni 41: GJEDNJ me aktgjykimin e saj e ngarkoi shtetin në afat prej tre muajsh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit aplikantit t’ia paguaj shumën prej 1.720 euro për shpenzimet e përcaktuara gjyqësore.

Trandafilovski kundër Maqedonisë së Veriut – 59119/15, Aktgjykim nga data 17 dhjetor 2020

Neni 3, ndalimi i torturës, trajtimit apo dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues

Shkelja e aspektit procedural të nenit 3 për shkak të mungesës së hetimit efikas në lidhje me pretendimet e aplikantit sa i përket brutalitetit policor.

Faktet – Në ankesën pranë GJEDNJ aplikanti ankohej se është keqtrajtuar nga ana e nëpunësve policorë gjatë privimit të tij nga liria, gjatë transportit deri në stacionin policor dhe gjatë qëndrimit në stacionin policor. Aplikanti, mes tjerash, ankohej edhe për atë se shteti nuk zbatoi hetim efektiv sa u përket pretendimeve të tij për brutalitetin policor e që është në kundërshtim me nenin 3 të Konventës.

Rasti konkret ka të bëjë me ngjarjen nga data 3 dhjetor të vitit 2014, kur aplikanti ka marrë pjesë në një aheng familjar në banesën e babait të tij në Kumanovë. Pas denoncimit për muzikë me zë të lartë dhe për sjellje të pahijshme nga ana e mysafirëve në banesë arritën tre nëpunës policorë, me ç’rast ka ardhur deri në mosmarrëveshje ndërmjet aplikantit dhe nëpunësve policorë dhe si rezultat i kësaj njëri nga nëpunësit policor ia ka përdredhur krahun pas shpine. Aplikanti ka pohuar se është tërhequr zvarrë nëpër shkallët e ndërtesës ndërkohë vazhdimisht është ofenduar dhe e kanë goditur në kokë dhe trup nëpunësit policorë. Këmbëzbathur dhe me fanellë me krahë të shkurtër aplikantin e kanë dërguar në stacionin lokal të policisë, ku e kanë mbajtur 4 orë dhe i është bërë test për prezencën e alkoolit në gjak. Gjatë kohës së kaluar në paraburgim, aplikantin e kanë ofenduar dhe kinse nuk i është siguruar kurrfarë ndihme mjekësore, përkrah kërkesës së tij.

Në dhjetor të vitit 2014 aplikanti paraqiti parashtrësë pranë MPB-Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale. Duke vepruar në këtë drejtim Sektori konstatoi se nuk ekzistojnë prova me të cilat do të konfirmoheshin pretendimet e tij për trajtim të keq. Aplikanti në muajin shkurt të vitit 2015 paraqiti kërkesë në Stacionin e policisë në Kumanovë për përcaktimin e identitetit të nëpunësve policorë të cilët kanë qenë të pranishëm dhe kanë vepruar në ngjarjen kontestuese. Nga stacioni policor e kanë informuar se gjatë ngjarjes ka qenë në gjendje të alkoolizuar, ka reaguar vullshëm, ka refuzuar të identifikohet dhe ta ulë zërin e muzikës

dhe se për këto shkaqe kundër tij është ngritur procedurë për kundërvajtje për prishjen e rendit publik. Identiteti i nëpunësve policorë nuk u zbulua.

Më 3 mars të vitit 2015 aplikanti paraqiti kallëzim penal në Prokurorinë Themelore Publike në Kumanovë duke e pandehur nëpunësin policor me identitet të panjohur për privimin e kundërligjshëm nga liria, për torturë dhe për trajtim tjetër çnjerëzor. Bashkëngjitur e ka dërguar edhe kopjen e raportit mjekësor dhe së këtejmi i ka propozuar prokurorit publik t'i dëgjojë dëshmitarët e propozuar okularë të dhënat për kontakt të të cilëve ia ka dërguar.

Më 9 qershor të vitit 2015 aplikanti u informua se sa i përket kallëzimit të tij penal prokurori publik ka miratuar “rezolutë” sipas të cilës nuk janë përcaktuar elemente të veprës penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare. Rezoluta nuk i është dërguar aplikantit.

E drejta – Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për shkeljen e aspekteve procedurale të nenit 3, Gjykata konstatoi se aplikanti ka ndërmarrë veprime urgjente pas ngjarjes, ka paraqitur parashtrësë në Sektorin, i ka kërkuar emrat e nëpunësve policorë, ka paraqitur kallëzim penal pranë Prokurorit Publik të cilit ia ka bashkëngjitur raportin mjekësor dhe propozimin që të thirren në seancë dëgjimore katër dëshmitarë okularë. Gjykata, mes tjerash, konstatoi se prokurori publik nuk i ka parashtruar pyetje aplikantit, nuk i ka marrë parasysh provat e propozuara nga ai dhe nuk ka ndërmarrë kurrfarë masash që të sigurojë prova të tjera, ndërsa konkluzionet e tij i ka mbështetur vetëm në bazë të provave të prodhuara nga MPB. Nga ana tjetër, kallëzimi penal në vend që të hidhet poshtë me aktvendim një gjë e këtillë është bërë me “rezolutë”, e cila nuk i është dërguar aplikantit. GJEDNJ përcaktoi se prokurori publik nuk i ka komentuar provat mjekësore të paraqitura nga aplikanti.

Gjykata konsideron se raportet mjekësore sa i përket lëndimeve të aplikantit, bashkë me pretendimet se në stacionin policor e kanë ofenduar dhe keqtrajtuar psikikisht ka qenë e mjaftueshme që ta aktivizojë detyrimin e shtetit që të zbatojë hetim efektiv. Në bazë të gjendjes së këtillë faktike, Gjykata konstatoi se masat hetimore të ndërmarra nga prokuroria themelore publike në lidhje me pretendimet e aplikantit për brutalitetin policor nuk i kënaqin standardet e hetimit efektiv dhe me këtë shteti nuk e ka plotësuar

detyrimin e vet, dhe për këtë shkak Gjykata konstatoi se në rastin në fjalë ka shkelje të aspektit procedural të nenit 3 nga Konventa.

Sa u përket pretendimeve të aplikantit se gjatë privimit të tij nga liria e kanë rrahur ndërsa nëpunësit policorë e kanë trajtuar në mënyrë çnjerëzore, Gjykata konkludoi se provat e paraqitura janë të pamjaftueshme për t'u dëshmuar jashtë prej dyshimit të arsyeshëm se përdorimi i forcës kundër aplikantit nuk ka qenë ekstremisht e nevojshme dhe as që ka qenë proporcionale konform sjelljes së tij, por vlerësimi i këtillë pjesërisht ka të bëjë me mungesën e hetimit efikas sa u përket pretendimeve të aplikantit për trajtimin joadekuat nga ana e policisë. Për këtë shkak Gjykata i hodhi poshtë pretendimet ankimore të aplikantit për shkeljen e aspektit material të nenit 3 nga Konventa.

Konkluzion: shkelje (unanimisht)

Neni 41: Për shkeljen e konstatuar Gjykata aplikantit i përcaktoi shumë prej 3.000 euro sa i përket dëmit jomaterial.

Stojmenoviq dhe Millosheviq kundër Maqedonisë së Veriut – 59842/14, Aktgjykim nga data 25 mars viti 2021

Neni 6 paragrafi 1, e drejta e procedurës së drejtë (aspekti civil)

Mungesë e paanshmërisë së gjyqtares të Gjykatës Supreme e cila paraprakisht ishte pjesë e kolegjit prej pesë gjyqtarëve në procedurën penale, ndërsa më vonë edhe pjesë e kolegjit i cili ka vendosur në procedurën e radhës civile e cila ka qenë ngushtë e lidhur me procedurën penale

Faktet – Ankesa është paraqitur pranë GJEDNJ pas vdekjes së znj. B.S. e cila ishte palë në procedurat në lidhje me të cilat është paraqitur ankesa, nga ana e djalit dhe nipit të saj. Gjykata vendosi që ankesa të vazhdojë vetëm në lidhje me aplikantin e parë N.S. (djalin e të ndjerës), ndërsa sa i përket aplikantit të dytë M.M. (nipin e të ndjerës), Gjykata konstatoi se ankesa është jo kompatible *ratione personae* konform nenit 35 paragrafi 3 (a) të Konventës meqë nipi nuk është trashëgimtar i drejtpërdrejtë i të ndjerës. Për më tepër, më 12 prill të vitit 2007 u miratua aktgjykimi penal kundër aplikantit dhe nënës së tij znj. B.S., i cili më 26 shkurt të vitit 2008 u

konfirmua nga Gjykata e Apelit Shkup e cila ka vendosur në kolegji anëtare e të cilit ishte gjyqtarja M.S. Më datë 3 dhjetor të vitit 2009 Gjykata Supreme e konfirmoi aktgjykimin e shkallës së parë dhe të shkallës së dytë.

Në ndërkohë, më 17 korrik të vitit 2008, znj. B.S. paraqiti kërkesëpadi pranë Gjykatës Themelore Civile Shkup për kthimin e huas që u është dhënë disa personave konform dy kontratave të verifikuara nga aplikanti në cilësinë e noterit. Më 1 korrik të vitit 2010, u paraqit padi civile kundër znj. B.S. me kërkesën që kontratat e huas të shpallen si të pavlefshme, me arsyetimin se janë të ngjashme me kontratat të cilat paraprakisht ishin objekt i vlerësimit në procedurën e lartpërmendur penale kundër znj. B.S. dhe djalit të saj. Lëndët janë bashkuar. Më 12 shtator të vitit 2011, Gjykata Themelore Civile Shkup miratoi vendim me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e znj. B.S.; duke u mbështetur, mes tjerash, në gjetjet e gjykatave penale dhe në deklaratimet e dëshmitarëve në atë procedurë penale, ndërsa kontratat e huas në bazë të të cilave znj. B.S. e kërkonte kthimin e parave, i anuloi. Në bazë të ankesës së paraqitur nga znj. B.S., më 25 prill të vitit 2012, Gjykata e Apelit e konfirmoi aktgjykimin e shkallës së parë po ashtu duke i shfrytëzuar gjetjet sa i përket përgjegjësisë penale të znj. B.S. si provë kryesore për shkaqet e vendimit të miratuar, pavarësisht faktit se bëhet fjalë për kontrata të ngjashme por jo identike për hua. Meqë në ndërkohë znj. B.S. ndërroi jetë, përfaqësuesi i saj ligjor pranë Gjykatës Supreme deklamoi revizion në emër të saj. Më 26 dhjetor të vitit 2013, Gjykata Supreme në seancë të mbyllur ka vendosur në kolegji prej 5 gjyqtarëve në mesin e të cilëve edhe gjyqtarja M.S. (e cila paraprakisht ishte pjesë e përbërjes së gjyqtarëve të cilët kanë vendosur në procedurë penale të shkallës së dytë kundër znj. B.S. dhe aplikantit të parë), e refuzoi deklamacionin e revizionit kundër aktgjykimin të shkallës së dytë. Në këtë periudhë, gjyqtarja M.S. ishte gjyqtare në Departamentin për gjykim në afat të arsyeshëm, ndërsa vetëm për procedurën kundër znj. B.S. u transferua në Kolegjin e Departamentit për vepra civile.

E drejta: Gjykata konstatoi duke e pasur parasysh faktin se aplikanti nuk ka mundur ta dijë se gjyqtari në fjalë do të veproj ndaj lëndës, dhe së këtejmi të kërkojë përjashtim, ndërsa në mënyrë të pakontestueshme edhe në procedurën penale të shkallës së dytë edhe në procedurën civile sipas deklamacionit të revizionit para Gjykatës Supreme ka vendosur gjyqtarja M.S., ajo e ka pasur për obligim ta njoftojë kryetarin e Gjykatës Supreme lidhur me rrethanat ekzistuese për shkak të të cilave është dashur të kërkojë

përrjashtim në përputhje me dispozitat ligjore vendase. Duke e pasur parasysh sekretin e këshillimit, nuk mund të dihet ndikimi të cilin gjyqtarja madje mund ta ketë pasur mbi anëtarët e tjerë të kolegjit, ndërsa mbeti e paqartë pse ka qenë e nevojshme pikërisht ajo të jetë pjesë e kolegjit i cili ka vendosur në procedurën kontestuese civile, meqë ajo ka qenë e sistematizuar si gjyqtare në Departamentin për gjykim në afat të arsyeshëm.

Konkluzion: shkelje (unanimisht)

Neni 41: Duke i pasur parasysh konstatimet e specifikuara, forma më përkatëse e kompensimit të dëmit do të ishte përsëritja e procedurës civile, nëse një gjë e këtillë kërkohet nga ana e aplikantit. Duke i pasur parasysh rrethanat, Gjykata në pjesën e dëmshpërblimit të drejtë konstatoi ekzistim të dëmit jomaterial dhe vendosi se shteti duhet aplikantit ti paguaj shumë prej 2.500 euro për dëmin e pësuar jomaterial dhe 250 euro për shpenzime.

Transkop SHA Manastir kundër Maqedonisë së Veriut – 48057/12, Aktgjykim nga data 1 prill 2021

Neni 6 paragrafi 1 – e drejta e procedurës së drejtë (procedura penale)

Faktet—Kompania—ankimuese është kompania e specializuar për transportin e udhëtarëve me autobusë, e regjistruar në Manastir, Maqedonia e Veriut.

Kompania-ankimuese para GJEDNJ u ankua për shkeljen e të drejtës së saj për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 6 të Konventës, meqë në procedurën e cila ka rezultuar me konfiskimin e autobusit të saj, nuk është mbajtur asnjë seancë gjyqësore verbale para gjykatave vendase si dhe për shkak të asaj se ekspertiza nga viti 2011 nuk i është dërguar kompanisë – ankimuese.

Më 27 qershor të vitit 2008, njëri nga autobusët e kompanisë – ankimuese përkohësisht i është sekuestruar nga Ministria e Punëve të Brendshme për shkak të pretendimit për dokument të falsifikuar (shasia). Në dhjetor të vitit 2008 u ngrit hetimi ndaj kompanisë – ankimuese dhe ndaj shoferit të autobusit për dyshimin e falsifikimit të dokumentit. Nga gjyqtari hetues u lëshua urdhër të përpilohen dy ekspertiza në lidhje me numrin e shasisë

(një ekspertizë nga Byroja për ekspertiza gjyqësore dhe ekspertiza tjetër nga Njësia për Teknikë Kriminallistike pranë MPB).

Më 17 maj të vitit 2010, gjyqtari hetues e ndërpreu hetimin për shkak të mungesës së provave se kompania – ankimuese e ka ndryshuar numrin e shasisë së autobusit. Paraprakisht, më 14 maj të vitit 2010, prokurori publik parashtriu propozim deri te Gjykata Themelore Manastir për konfiskimin e autobusit, meqë numri i shasisë është ndryshuar dhe për këtë shkak autobusi nuk mund të inkuadrohet në qarkullimin juridik.

Krahas faktit se procedura u ndërpre, Gjykata Themelore Manastir (gjykatë e shkallës së parë) e miratoi propozimin e prokurorit publikë. Gjykata e Apelit Manastir (gjykatë e shkallës së dytë) tre herë e ka kthyer lëndën për rishikim, çdo herë duke i urdhëruar gjykatës më të ulët të kërkojë ekspertizë të re në lidhje me numrin e shasisë, duke e pasur parasysh atë se ka marrë qëndrim se nuk mund të vendoset në bazë të ekspertizave të bëra gjatë hetimit (shih paragrafin 10 të aktgjykimit).

Seancë gjyqësore nuk është mbajtur as para gjykatës së shkallës së parë dhe as para gjykatës së shkallës së dytë edhe përkrah kërkesave me shkrim të kompanisë – ankimuese.

Më 6 dhjetor të vitit 2011, Njësia për Teknikë Kriminallistike përpiloi ekspertizë të re (“ekspertiza nga viti 2011”) në të cilën është konstatuar se numri i shasisë është ndryshuar. Në seancën jo publike të mbajtur më datë 26 dhjetor të vitit 2011 gjykata e shkallës së parë, mes tjerash, në bazë të kësaj ekspertize përsëri vendosi se autobusi duhet të konfiskohet. Vendimi është bazuar në nenin 100-A paragrafi 1 dhe 4 të Kodit Penal. Ndaj këtij vendimi kompania – ankimuese paraqiti ankesë. Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën dhe e konfirmoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

E drejta – GJEDNJ në aktgjykimin në fjalë përcaktoi se përveç rastit të ekzistimit të rrethanave të jashtëzakonshme të cilat e arsyetojnë mos mbajtjen e seancës gjyqësore, e drejta e “seancës publike” nga neni 6 § 1 të Konventës, e përfshinë edhe të drejtën e “seancës verbale” para së paku një instance.

Në lidhje me mungesën e seancës verbale, Gjykata nuk është e bindur se fakti kontestues – numri i shasisë së autobusit a është falsifikuar – si çështje thelbësore e rastit, ka pasur mundësi të zgjidhet më mirë në formë të

shkruar sesa me seancë verbale. Këtë çështje nuk e ka konsideruar as si çështje teknike dhe as si çështje të pastër juridike dhe sipas kësaj, konkludoi se nuk ka pasur rrethana të jashtëzakonshme në rastin konkret të cilat do ta arsyetonin mos mbajtjen e seancës verbale.

Pastaj, GJEDNJ theksoi se koncepti i procedurës së drejtë e nënkupton të drejtën e procedurës kontradiktore, në përputhje me të cilën palët duhet të kenë mundësi jo vetëm të paraqesin prova në mbrojtje të pohimeve të tyre por edhe të njoftohen me ose të prononcohen për të gjitha provat e paraqitura dhe për prononcimet të cilët do të ndikonin mbi vendimin gjyqësor.

Sa i përket mos dërgesës së ekspertizës nga viti 2011 deri te kompania – ankimuese, GJEDNJ përcaktoi se ekspertiza nga viti 2011 kishte rëndësi jashtëzakonisht të madhe dhe ishte provë e vetme nga eksperti mjeko – ligjor mbi të cilën janë mbështetur gjykatat vendase gjatë përcaktimit të asaj se numri i shasisë së autobusit është falsifikuar gjatë miratimit të vendimit për konfiskimin e automjetit. Vendimi për konfiskimin e automjetit i konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit (shih: paragrafët 14-18) janë miratuar nga gjykatat vendase, pavarësisht informacioneve që i kanë pasur në dispozicion se hetimi është ndërprerë për shkak të mungesës së provave kundër kompanisë-ankimuese.

Konkluzion: shkelje (unanimisht) e nenit 6 paragrafi 1, për shkak të shkarjes së gjykatave vendase që të mbajnë seancë verbale, shkelje e nenit 6 paragrafi 1 lidhur me parimin e kontradiktës së procedurës.

Prodanov kundër Maqedonisë së Veriut – 73087/12, Aktgjykim nga data 10 qershor 2021

Neni 6 paragrafi 1, e drejta e procedurës së drejtë

Aplikanti nuk ka pasur qasje deri te Gjykata Supreme për shkak të mënyrës së zbatimit nga kjo gjykatë të dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore dhe e ka hedhur poshtë deklamacionin e revizionit të tij si të palejueshëm *ratione valoris*

Faktet – Në vitin 2000 G.P. paraqiti padi civile kundër aplikantit në Gjykatën Themelore të Gjevgjeliës, duke kërkuar njohjen e të drejtës së pronësisë të

një pjese të shtëpisë e cila ka qenë në pronësi të aplikantit në periudhën në fjalë dhe së këtejmi e ka përcaktuar vlerën e kontestit në 40.000 denarë. Sipas Ligjit për procedurë kontestimore, i cili në atë kohë ka qenë në fuqi, deklamacionin e revizionit në Gjykatën Supreme ka pasur mundësi ta bëjë vetëm nëse vlera e kontestit është mbi shumën prej 1.000.000 denarë. Në vitin 2002 Gjykata Themelore në Gjevgjeli e pranoi kërkesëpadinë e G.P. dhe aktgjykimi ka qenë kundër aplikantit, dhe në vitin 2003 u konfirmua nga Gjykata e Apelit Shkup. Në vitin 2003, duke e proceduar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga prokurori publik, ndërsa me propozim të aplikantit, Gjykata Supreme i shfuqizoi aktgjykimet e gjykatave më të ulëta dhe rastin e ktheu në rishikim. Në procedurën e përsëritur, në vitin 2005 aplikanti paraqiti kundërpadi në gjykatën e shkallës së parë kundër G.P., duke kërkuar të konstatohet pavlefshmëria e marrëveshjes për dhuratë në bazë të së cilës paditësi e ka mbështetur kërkesën pronësore të tij në procedurën paraprake. Në kundërpadinë, aplikanti e ka përcaktuar vlerën e kontestit në 40.000 denarë kështu që të dyja procedurat u bashkuan dhe gjatë rrjedhës së mëtutjeshme është zhvilluar një procedurë.

Më 29 dhjetor të vitit 2005 hyri në fuqi Ligji i ri për procedurë civile i cili ka qenë i aplikueshëm mbi lëndët që kanë qenë në procedurë të shkallës së parë. Në përputhje me ligjin e ri, deklamacioni i revizionit në Gjykatën Supreme mund të bëhet vetëm nëse vlera e kontestit është mbi shumën prej 500.000 denarë. Sipas dispozitave kalimtare të këtij ligji, procedurat është dashur të përfundojnë konform ligjit që ka qenë në fuqi para përfundimit të procedurës në shkallë të parë. Më 24 janar të vitit 2006, Departamenti civil i Gjykatës së Apelit Shkup nxori konkluzion në lidhje me të gjitha lëndët që kanë qenë në rrjedhë e sipër për të cilat kishte të bëjë Ligji nga viti 2005, me instruksione që gjykatat më të ulëta t'u bëjnë me dije palëve dhe t'i shtyjnë seancat e ardhshme që t'u mundësohet t'i ndërmarrin të gjitha aktivitetet e nevojshme në lidhje me kërkesat e tyre. Në konkluzionin është specifikuar se palëve në të gjitha procedurat rrjedhëse të shkallës së parë, do t'u ofrohet mundësi që t'i përgatisin shkresat e tyre në përputhje me Ligjin nga viti 2005.

Në seancën gjyqësore të mbajtur më 15 shkurt të vitit 2006, gjykata e shkallës së parë i njoftoi palët e çështjes se seanca e konvokuar për 20 mars të vitit 2006 do të konsiderohet si seancë përgatitore në përputhje me nenin 33 të ligjit nga viti 2005. Aplikanti në seancën përgatitore kërkoi

që vlera e kontestit të rritet në 500.100 denarë, ndërsa me kërkesë të gjyqtarit, para seancës kryesore ka paguar taksa plotësuese gjyqësore të cilat korrespondojnë me rritjen e vlerës së kontestit.

Gjykata e shkallës së parë në vitin 2009 miratoi aktgjykim në favor të G.P. dhe e ka refuzuar kërkesën e kundërpadsisë së aplikantit. Në pjesën hyrëse të aktgjykimit si vlerë e kontestit është caktuar shuma prej 40.000 denarë, por më vonë, me kërkesë të aplikantit, u korrigjua pjesa hyrëse e aktgjykimit, në pjesën e vlerës së kontestit në 501.000 denarë, me arsyetimin se shuma paraprakisht e caktuar ka qenë e gabuar. Me aktgjykimin nga data 2 shtator të vitit 2010, në pjesën hyrëse të së cilit vlera e kontestit është caktuar në 40.000 denarë, Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën e aplikantit, ndërsa me kërkesë të aplikantit, më 9 dhjetor të vitit 2010 e korrigjoi pjesën hyrëse të aktgjykimit të vet, me atë që e ka cekur vlerën e rritur të kontestit.

Aplikanti paraqiti kërkesë për revizion deri te Gjykata Supreme, e cila më 17 maj të vitit 2012 e hodhi poshtë si të palejueshme *ratione valoris*. Gjykata Supreme konkludoi se vlera e kontestit në aktgjykimet e gjykatave më të ulëta ishte përcaktuar në 40.000 denarë, dhe ka qenë nën pragun ligjor prej 500.000 denarë të përcaktuar me Ligjin nga viti 2005. Fakti se vlera e kontestit u ndryshua nga ana e Gjykatës së Apelit ishte irelevant, meqë rritja është bërë në fazën e gabueshme të procedurës dhe nuk kishte të bëjë me gabim evident gjatë përpilimit.

E drejta – Gjatë vendimit të tij Gjykata konstatoi se gjetja e Gjykatës Supreme se vlera e kontestit është rritur në procedurën para Gjykatës së Apelit, e që nuk është faza përkatëse procedurale për ndryshim të këtillë, është në kundërshtim me faktet e rastit, veçanërisht meqë ndryshimi i vlerës së kontestit ka ndodhur në seancën përgatitore para gjykatës së shkallës së parë. Gjykata Supreme nuk e ka theksuar këtë fakt në aktvendimin e saj. Gjykata, mes tjerash, konstatoi se Gjykata Supreme nuk e ka theksuar qëndrimin e saj se ky ndryshim në këtë fazë të procedurës a ka qenë në përputhje me ligjin apo me praktikën e tyre të vendosur. Prandaj Gjykata konstatoi se ekziston shkelje e të drejtës së qasjes deri te gjykata të garantuar me nenin 6 të Konventës.

Konkluzion: Gjatë vendimit të saj në lidhje me kompensimin përkatës për shkeljen e konstatuar, Gjykata ishte e mendimit se duke e pasur parasysh

shkeljen e konstatuar të nenit 6, masa më përkatëse është përsëritja e procedurës kontestuese konform standardeve të Konventës.

Neni 41: Gjykata, aplikantit, përkatësisht trashëgimtarëve të tij, iu përcaktoi shumë të përgjithshme prej 1 500 euro në lidhje me shpenzimet.

Neni 6

Çështje civile

Neni 6-1, Gjykata e paanshme

Mungesa e paanësisë e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë i cili ishte pjesë e një trupi gjykues me pesë anëtarë në një çështje penale dhe një çështje pasuese civile të lidhur ngushtë me të: shkelje

Stoimenovikj dhe Miloshevikj kundër Maqedonisë së Veriut – 59842/14
Vendimi i datës 25.3.2021 (Seksioni V)

Fakte – Kërkuesi i parë u dënua, së bashku me nënën e tij (B.S.) dhe të tjerët, për pastrim parash përmes marrëveshjeve fiktive të huasë, të cilat kërkuesi i parë i kishte vërtetuar në cilësinë e noterit. Në bazë të këtyre marrëveshjeve, palët e treta kishin bërë transferime në llogarinë e B.S.-së me anë të shlyerjes së huave fiktive. Ata u ankuan pa sukses kundër vendimit në Gjykatën e Apelit në Shkup, e cila gjykoj me një panel prej pesë gjyqtarësh dhe përfshinte gjyqtarin M.S.-ë. Gjykata e Lartë e la vendimin në fuqi.

B.S.-ja po ashtu ngriti një padi civile, duke kërkuar një urdhër që disa nga të njëjtët palë të treta të shlyenin një hua që ajo u kishte dhënë atyre, në përputhje me një marrëveshje huaje të vërtetuar nga kërkuesi i parë. Këto palë ngritën një padi civile kundër B.S.-së, duke kërkuar që këto marrëveshje kredie të anuloheshin për shkak se ishin fiktive. Pretendimi i B.S.-së u rrëzua dhe marrëveshjet e huasë u anuluan. B.S.-ja, dhe pas vdekjes së saj, avokati i B.S.-së në emër të saj, bëri ankim pa sukses në Gjykatën e Lartë për çështje të ligjit. Gjykata e Lartë gjykoj si trup gjykues prej pesë gjyqtarësh dhe përfshinte gjyqtarin M.S.-ë.

Një muaj para se të njoftohej vendimi i Gjykatës së Lartë, kërkuesja e parë filloi procedimin e trashëgimisë në lidhje me B.S.-në, e cila përfshinte, *ndër të tjera*, pretendimin e saj civil.

Kërkuesit u ankuan për mungesën e paanësisë së kolegjit të Gjykatës së Lartë e cila kishte gjykuar kërkesën civile të B.S.-së, duke pasur parasysh pjesëmarrjen e gjyqtarit M.S. si në atë trup gjykues ashtu edhe në Gjykatën e Apelit që kishte vendosur çështjen penale kundër saj.

Ligji – Neni 6 § 1: Gjykata e kufizoi shqyrtimin e saj në testin objektiv në lidhje me mungesën e paanësisë gjyqësore.

Ndërsa marrëveshjet e huasë në procesin civile të kundërshtuar nuk kishin qenë saktësisht të njëjta me marrëveshjet e huasë që kishin qenë objekt i procedimit penal, duke pasur parasysh identitetin e palëve, përfshirjen e kërkuesit të parë si noter publik dhe kontekstin në të cilin ai ishte përfunduar, ato kishin qenë të një natyre shumë të ngjashme, nëse jo të njëjtë. Natyra e tyre pothuajse identike kishte qenë gjithashtu një nga argumentet ku ishin mbështetur paditësit në kërkimin e anulimit të tyre në procedimin civil. Gjykatat civile, duke konstatuar se marrëveshjet në fjalë ishin fiktive, ishin mbështetur shprehimisht, *ndër të tjera*, në konstatimet e gjykatave penale në lidhje me përgjegjësinë penale të B.S.-së dhe individëve të tjerë përkatës, si dhe kërkuesit. Ato e kishin bërë këtë pavarësisht se procedimi penal kishte të bënte me marrëveshje të ndryshme huaje dhe për këtë arsye nuk mund të konsideroheshin *res judicata* për çështjet e ngritura në procedimin e kundërshtuar civil. Duhet përmendur që shqyrtimi i kryer nga trupat gjykues në të dyja procedimet kishte të bënte me bazueshmërinë e ankesimeve të B.S.-së.

Duke pasur parasysh vlerësimin gjithëpërfshirës dhe fushën e gjerë të shqyrtimit nga Gjykata e Apelit, e shoqëruar me profilin e lartë të çështjes penale në atë kohë, nuk mund të supozohet se gjyqtarja M.S. nuk do të kishte qenë në dijeni të pjesëmarrjes së saj në atë çështje kur të gjykonte ankimin e B.S.-së në procedimin civil të kundërshtuar. Megjithatë, asgjë nuk tregonte se ajo kishte marrë parasysh mundësinë e tërheqjes nga çështja apo se kishte informuar Kryetarin e Gjykatës së Lartë për faktin se ajo kishte qenë pjesë në procedimin e mëparshëm penal. Në lidhje me këtë, ligji i brendshëm i detyronte shprehimisht gjyqtarët që merrnin pjesë në një çështje që të informonin menjëherë kryetarin e gjykatës për rrethanat që justifikonin largimin e tij ose të saj. Kishte qenë e pamundur për B.S.-në të kërkonte përjashtimin e gjyqtarës M.S. nga marrja pjesë në çështjen e saj civile. Në të vërtetë, nuk kishte pasur asnjë mundësi reale që avokati i B.S.-së të mësonte se gjyqtarja M.S.-ë do të ishte anëtare e trupit gjykues

të Gjykatës së Lartë, aq më tepër duke pasur parasysh që një seancë gojore nuk ishte mbajtur para asaj gjykate. Rrjedhimisht, kishte qenë përgjegjësi e gjyqtarës M.S.-ë t'ia sillte çështjen në vëmendje Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Ndërsa është e vërtetë se gjyqtarja M.S.-ë kishte qenë vetëm një anëtare e një trupi gjykues prej pesë gjyqtarësh të Gjykatës së Lartë, duke pasur parasysh fshehtësinë e diskutimeve, ishte e pamundur të konstatohej ndikimi i saj aktual në atë rast. Megjithatë, nuk ishte kontestuar që gjyqtarja M.S.-ë kishte qenë ushtruese detyre e kryetarit të Gjykatës së Lartë në kohën kur ankesa për çështje ligjore ishte bërë në emër të B.S.-së dhe ishte caktuar në trupin gjykues të asaj gjykate. Gjithashtu nuk ishte shpjeguar pse ishte e nevojshme të caktohej që ajo të ishte pjesë e trupit gjykues së Departamentit të së Drejtës Civile të Gjykatës së Lartë që kishte gjykuar ankimin e B.S.-së, e cila pretendonte se ishte rasti i vetëm në atë Departament gjatë karrierës së saj në Gjykatën e Lartë.

Në dritën e sa më sipër, në rrethanat specifike të çështjes, frika e ankuesit të parë se gjyqtarja M.S.-ë tashmë kishte formuar një pikëpamje për bazueshmërinë e çështjes civile para se ajo të vinte në Gjykatën e Lartë, e cila mund të konsiderohej e justifikuar në mënyrë objektive. Përbërja e trupit gjykues të Gjykatës e Lartë nuk kishte arritur të përmbushte standardin e kërkuar të Konventës sipas testit objektiv.

Përfundimi: shkelje (unanimisht).

Gjykata gjithashtu vendosi, njëzëri, se kërkesa në lidhje me ankuesin e dytë ishte e papranueshme (papajtueshmëria *ratione personae*) pasi, si nip i B.S.-së, ai nuk ishte një trashëgimtar i drejtpërdrejtë dhe nuk mund të merrte statusin e viktimës nga trashëgimia ose ndonjë formë tjetër të të drejtave.

Neni 41: 2 500 Euro kërkuarit të parë në lidhje me dëmin jo-financiar. Pretendimi për dëmin financiar rrëzohet.

IRZ



Makavej, 2021